

ENVER HYSA

## NDAJFOLJA NË GJUHËN E SOTME SHQIPE

Shtruarja dhe zgjidhja e problemeve të një teme të tillë për gjuhën shqipe, mbështetur në materiale të gjëra, është me një interes të madh në thellimin e studimit të kësaj kategorie. Ky studim besojmë se do të ndihmojë në qartësimin e mëtejshëm të problemeve, të cilat kanë mbetur ende të pazgjidhura në një mënyrë të kënaqshme.

Ndajfolja është bërë objekt studimi sintetik në çdo gramatikë shkollore e joshkollore. Nuk kemi veç një artikull<sup>1</sup>, që merret me problemin e ndajfoljeve në veçanti, në të cilin autori trajton origjinën dhe formimin e tyre.

Problemet që dalin në studimin e kësaj teme jemi munduar t'i vështojme jo shkëputurazi po në bashkësynim me kategoritë, me të cilat ajo ka afëri. Duke u thelluar në materialet e shumta të nxjerra nga letërsia artistike e gjinive të ndryshme si dhe nga folklori, të tërheqin vëmendjen mjaft çështje të rëndësishme për t'u trajtuar rreth ndajfoljeve. Të tilla janë: problemi i klasifikimit të ndajfoljeve në klasa të veçanta e përcaktimi i kufijve të këtyre klasave, problemi i shkallëve të ndajfoljeve, përcaktimi i ndajfoljeve të thjeshta dhe lokucioneve ndajfoljore që përdoren në shkallë të ndryshme dhe i atyre që nuk formojnë shkallë, duke mos lënë jashtë këtu edhe afëritë që vihen re në këtë pikë me mbiemrat. Problemet që lidhen me origjinën dhe formimin e ndajfoljeve janë të shumta dhe të ndryshme, me çështje mjaft herë të vështira për t'u dhënë një zgjidhje të prerë. Mund të përmenden këtu ndajfoljet që vijnë nga rasat e ndryshme të emrit, ndajfoljet përemërore, lidhëzore, ndajfoljet e ndërtuara me formante të ndryshme e, në mënyrë të veçantë, lokucionet ndajfoljore.

### I. Vështrim kritik mbi trajtimet e mëparshme të ndajfoljeve nëpër gramatika

Nëpër gramatikat e ndryshme,<sup>2</sup> që janë shkruar nga autorë vendës e të huaj, janë trajtuar, ku më shumë e ku më pak, këto çështje rreth ndajfoljeve: a) përkufizimi i ndajfoljeve, b) klasifikimi dhe c) formimi i tyre.

1) A. Xhuvani, *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në gjuhën shqipe*, botuar së pari në BISH, III, 2, 1949, ribotuar pastaj në përmbledhjen: A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, Tiranë 1956, mbledhur e gaditur nga M. Domi (citimet e mëposhtme do të bëhen sipas ribotimit).

2) Fr. M. Da Lecce, *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, Roma 1716; J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Heft, II — 1 — *Beitrag zur einer gramma-*

1. Lidhur me përkufizimin e ndajfoljeve duhet thënë se nëpër gramatikat tona ka mbizotëruar trajtimi i huaj tradicional. S. Frashëri, i pari autor vendës që hartoi një gramatikë të shqipes në gjuhën shqipe, ka dhënë këtë përkufizim të ndajfoljes: «Mbifoljeja është një fjalë e papërkthyerë me të cilën mbarohetë shënimi' i një foljeje, i një mbiemëri a i një mifoljeje tjetërë, si: *mirë* thua, *më* trimi, *fort mirë*».<sup>3</sup> Megjithëse ky përkufizim nuk e përfshin gjithë përmbajtjen e kategorisë së ndajfoljeve, autori ka dhënë veçorinë dalluese të saj: karakterin e pandryshueshëm. Në hullinë e tij ka ecur më vonë A. Xanoni, i cili e ka shtjelluar më hollësisht përkufizimin e Samiut. Ai e ka përcaktuar ndajfoljen si një «fjalë sndrojtse me t'cilën rritet a ulet a sosit domethania e nji verbit, e nji adjektivit a t'ndonji adverbit tjetër; jose i skajon me rrethana vendit, kohet, mëndyret e ksodoret si kuer: kush flet *tepër*, kush *pak*, kush *aspak*»<sup>4</sup>.

Në gramatikat tona janë dhënë ndonjëherë edhe përkufizime të paplota e të pasakta. Kështu tek gramatika e O. Myderrizit kur flitet për përkufizimin e ndajfoljes thuhet: «Ndajfolje quhet fjala që *shërben me ndryshue pak a shumë* kuptimin e nji foljeje, e nji mbiemni, a të nji ndajfolje tjetër»<sup>5</sup>. Një përcaktim i tillë i brendisë së ndajfoljeve si dhe tek I. D. Sheperi<sup>6</sup>, është i paplotë. Aty nuk është vënë në dukje veçoria karakteristike dalluese e ndajfoljeve, karakteri i saj i pandryshueshëm, që e dallon atë nga pjesët e tjera të ndryshueshme të ligjëratës. Nga ana tjetër, ky përkufizim është i pasaktë sepse ndajfolja nuk mund të shërbejë «me ndryshue pak a shumë kuptimin e një foljeje etj...» po për ta përcaktuar atë kuptim.

I njëjti gabim haset edhe në përkufizimin e dhënë nga K. Cipo, ku ndajfoljet përcaktohen si «fjalë që nuk lakohen. Pun' e tyre është që të plotësojnë apo të *ndryshojnë këtu pakë e atje pakë*, sipas *rrethanave, domethanën e foljeve, të mbiemrave dhe të vetë ndajfoljeve*».<sup>7</sup> Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, që kryejnë funksionin e ndajfoljeve ose që kanë kaluar përfundimisht në këtë klasë, fitojnë tiparin dallues të kësaj klase, karakterin e pandryshueshëm dhe përdoren kështu në një formë të ngurosur, prandaj nuk lind nevoja për cilësimin e ndajfoljeve si fjalë që nuk lakohen.

Duke u mbështetur në një kategori emrash që përdoren në raste të caktuara, po jo gjithmonë, edhe si ndajfolje S. Shuteriqi<sup>8</sup> e ka cilë-

*tik der Toskischen Dialektes*, Jena 1854; A. Dozoni, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris, 1879; K. Kristoforidhi, *Gramatiki albanikis glossis kata tin toskikin dialekton*. Konstantinopolis, 1882; S. Frashëri, *Shkronjëtoje e gjuhës shqip*, Bukuresht 1886; Gj. Pekmezi, *Grammatik der Albanesischen Sprache*, Wien 1908; A. Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër 1909; G. Weigand, *Albanesische grammatik in sudgeigischen Dialekt*, Leipzig, 1913; I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë 1927; F. Cordignano, *Lingua albanese*, Milano 1931; A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe*, Tiranë 1942; O. Myderrizi, *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë 1944; K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë 1949; Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (Dispensë pj. II), Tiranë 1963.

3) S. Frashëri, *vep. cit.*, f. 130.

4) A. Xanoni, *vep. cit.*, f. 158.

5) O. Myderrizi, *vep. cit.*, f. 271.

6) I. D. Sheperi jep këtë përkufizim për ndajfoljen: «Ndajfolje (adverbe) quhen fjalët që plotësojnë kuptimin e foljevet p.sh. këtu, sot, shumë, mirë» *vep. cit.*, f. 26.

7) K. Cipo, *vep. cit.*, f. 180.

8) S. Shuteriqi, *Mendime e vërejtje rreth gramatikës shqipe*, në BISH N. 2, 1951, f. 58.

suar ndajfoljen si pjesë të lakueshme. Fjalët e tipit: *bukuri, mrekuili, copë e grimë* etj., të sjella nga autori, kur përdoren si ndajfolje nuk marrin forma të ndryshme gramatikore e përdoren kështu të ngurosurat. Ato kalojnë në përdorim ndajfoljor vetëm në kuptim figurativ, po kurrë në kuptim direkt.

Përkufizimin më të plotë për ndajfoljen e ka dhënë Sh. Demiraj: «Është quajtur kështu ajo pjesë e pandryshueshme e ligjëratës që tregon a) një tipar të veprimit a të gjendjes b) rrethanat në të cilat kryhet veprimi c) shkallën e cilësisë ose të rrethanës»<sup>9</sup>.

Në këtë përkufizim autorit i ka shpëtuar çështja e shprehjes së intensitetit të veprimit, çka është kryesore për ndajfoljet e sasisë.

2. Në gramatikat e shqipes ka mbizotëruar përgjithësisht një vijë shtrirje përsa i përket kriterit nga janë nisur autorët në klasifikimin e ndajfoljeve. Po kjo vijë ka ndryshuar nga një gramatikë në tjetrën lidhur me numrin e grupeve të veçanta. S. Frashëri<sup>10</sup> e A. Xanoni<sup>11</sup> kanë dalluar 6 grupe ndajfoljesh, O. Myderrizi<sup>12</sup> 8, I. D. Sheperi<sup>13</sup> e K. Cipo<sup>14</sup> nga 5 grupe.

Një trajtim të kujdesshëm të grupimit të ndajfoljeve ka bërë Sh. Demiraj<sup>15</sup>, i cili merr si kriter bazë në klasifikimin e ndajfoljeve kuptimin dhe mbi këtë kriter ka paraqitur këtë ndarje dy grupesh kryesore:

I. Ndajfolje përcaktonjëse dhe II. Ndajfolje rrethane.

Duke e çuar më tej klasifikimin, autori ka bërë nëndarje të veçanta për secilin grup: I. a) ndajfolje mënyre, b) ndajfolje sasi; II. a) ndajfolje kohe, b) ndajfolje vendi, duke dalluar kështu 4 grupe gjithsejt. Duhet shënuar këtu se edhe autorët që puqen në numrin e grupeve nuk puqen në përmbajtjen e secilit grup. Duke qënë se autorët e gramatikave tona kanë ndjekur përgjithësisht traditën gramatikore të huaj, tek ndajfoljet me përjashtim të gramatikës së Sh. Demirajt, është përfshirë edhe kategoria leksiko-gramatikore e pjesëzave, të cilat ose janë grupuar si kategori të veçanta të ndajfoljeve ose janë përzier herë-herë me ndonjë nga grupet kryesore të ndajfoljeve.

I. D. Sheperi i ndan ndajfoljet edhe në pyetëse, të pakufishme, dëftore e lidhore «sipas marrëdhënjes që kanë me njërajtë»<sup>16</sup>. Autori përmend tek ndajfoljet dëftore të shkakut ose të qëllimit fjalët *andaj (ndaj)* e *prandaj*, të cilat sot përdoren edhe si ndajfolje shkak por kryesisht si lidhëza, si dhe fjalët *se* e *pse*, nga të cilat *se* sot përdoret vetëm si lidhëz, ndërsa *pse* përdoret si ndajfolje shkak vetëm në fjalitë pyetëse të drejta. Në fjalitë pyetëse të zhdrejta ajo merr shpesh edhe funksion lidhëzor.

3. Përgjithësisht formimi i ndajfoljeve ose nuk është prekur fare nëpër gramatikat e shqipes, ose vetëm është përmendur kalimthi me ndonjë shembull. Kështu janë lënë jashtë vështrimit një pjesë e mirë e tipave fjalëformues të ndajfoljeve. Megjithatë edhe në këtë drejtim janë bërë përpjekje për thellimin e çështjeve të ndryshme. Kështu

9) Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 255.

10) S. Frashëri, *vep. cit.*, f. 130.

11) A. Xanoni, *vep. cit.*, f. 159.

12) O. Myderrizi, *vep. cit.*, f. 271.

13) I. D. Sheperi, *vep. cit.*, f. 120 v.

14) K. Cipo, *vep. cit.*, f. 180.

15) Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 257.

16) I. D. Sheperi, *vep. cit.*, f. 122.

I. D. Sheperi në gramatikën e tij te kapitulli «*Ndajfolja*» flet për ndajfolje të *thjeshta* dhe të *përngjitura*, ndërsa te kapitulli «*Prejardhja*» bën fjalë për ndajfoljet e prejardhura dhe i ndan këto sipas «*prapashtimeve*»: — *isht*, — *azi*, — *thi* dhe — *zë*, —*et*<sup>17</sup>. O Myderrizi<sup>18</sup> dhe K. Cipo<sup>19</sup> kanë dalluar edhe lokucione ndajfoljore. Në kategoritë e ndryshme të strukturës së ndajfoljeve herë-herë nuk ka pasur kritere të qarta për të dalluar ç'hyn në një grup e ç'hyn në një tjetër.

Më gjerësisht dhe më në thellësi janë marrë me formimin e ndajfoljeve A. Xhuvani<sup>20</sup>, Sh. Demiraj<sup>21</sup> dhe A. Xhuvani — E. Çabej<sup>22</sup>.

Sh. Demiraj, duke u nisur nga struktura e fjalës, dallon: a) *ndajfolje fjalë të para*, b) *ndajfolje fjalë të prejardhura*, c) *ndajfolje fjalë të përngjitura* dhe ç) *lokucione ndajfoljore*.

A. Xhuvani — E. Çabej në punimin e tyre, që është një sintezë pak a shumë e plotë e tipit fjalëformues prapashtesor në shqipe, trajtojnë vetëm këtë tip formimi nga kategoria e ndajfoljeve.

Si përfundim, mund të thuhet se nëpër gramatikat e shqipes janë prekur përgjithësisht problemet kryesore rreth ndajfoljeve, megjithëse herë-herë përciptazi, po kjo është e shpjgueshme, po të kemi parasysh qëllimet dhe synimet e hartuesve të këtyre gramatikave. Duke i parë këto probleme me një tjetër sy dhe në një plan më të gjerë, kuptohet, që ka ende çështje të rëndësishme që ose kanë mbetur fare jashtë vështrimit ose kanë nevojë për një thellim të mëtejshëm.

## II. Klasifikimi i ndajfoljeve.

Dihet se kriteret që merren si bazë në klasifikimin e pjesëve të ligjëratës nuk u takojnë në mënyrë të barabartë të gjitha fjalëve që hyjnë në grupe të ndryshme leksiko-gramatikore.

Autorët që janë marrë me ndajfoljet e kanë bërë ndarjen e tyre në grupe duke u mbështetur mbi kuptimin. Po, ana kuptimore e ndajfoljeve merret si bazë klasifikimi në ndarjen brenda dy grupeve më të mëdha.

Ndarja e ndajfoljeve në *përcaktuese* e në *rrethanore*, e zbatuar nga Sh. Demiraj<sup>23</sup> në dispensën e tij, nuk është mbështetur thjesht mbi kuptimin që shprehin ndajfoljet e veçanta. Vetë termat e përdorur këtu tregojnë se kemi të bëjmë me një bazë më të gjërë klasifikimi, ku merret parasysh jo vetëm kuptimi, që mund të kenë ato, por edhe funksioni i tyre, d.m.th. fakti në se ato përcaktojnë veprimin e shprehur nga folja apo tregojnë rrethanat e kryerjes së tij.

Ne, duke u nisur pikërisht nga ana funksionale e duke mos lënë jashtë vështrimit edhe anën kuptimore, do t'i ndajmë ndajfoljet në dy grupe apo klasa themelore:

I. Ndajfolje cilësore, ato që tregojnë një cilësi të veprimit foljor ose shkallën e intensitetit të veprimit.

II. Ndajfolje rrethanore, ato që tregojnë rrethanat në të cilat kryhet veprimi.

17) Po ai, po aty, f. 138 v.

18) O. Myderrizi, *vep. cit.*, f. 272, 273.

19) K. Cipo, *vep. cit.*, f. 180.

20) A. Xhuvani, *art. cit.* f. 193 v.

21) Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 262.

22) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*.

23) Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 257.

## I. Ndajfoljet cilësore

Ky është njëri nga dy grupet, që gjen një përdorim mjaft të dendur dhe që paraqet interes në studimin e mbarë ndajfoljes. Në këtë grup hyjnë edhe ndajfoljet e sasisë, të cilat kanë një natyrë pak a shumë të ndryshme nga ato që quhen ndajfolje cilësore e me të cilat kihen parasysh ndajfoljet e mënyrës. Këto ndajfolje shënojnë, në përdorimet e tyre më të zakonshme, intensitetin e veprimit. Një pjesë prej tyre shërbejnë si mjet për formimin e kategorisë së shkallës, si të mbiemrave ashtu dhe të ndajfoljeve.

Fjalët që shërbejnë si ndajfolje sasi paraqiten në përdorim edhe si përemra. Sigurisht, kur përdoren si përemra, ato kanë një natyrë të ndryshme nga ndajfoljet, qoftë nga ana kuptimore, qoftë nga ana e lidhjes me fjalë të tjera. Duke u nisur nga kjo anë ne e përfshijmë grupin e këtyre ndajfoljeve tek ndajfoljet cilësore. Në këtë kuptim nocioni «ndajfolje cilësore» ka një kuptim më të gjerë.

Sfera e përdorimit të këtyre ndajfoljeve është mjaft e gjerë. Ndajfoljet thjesht cilësore a ndajfoljet e mënyrës përdoren për të shprehur një tipar të veprimit a të gjendjes, pa u kufizuar në grupe të caktuara semantike foljesh; ndërsa ndajfoljet e sasisë tregojnë shkallën a intensitetin e veprimit, po ndryshe nga të parat përdoren më rrallë pranë foljeve që tregojnë gjendjen, duke qenë kështu më të kufizuara nga lidhjet leksikore.

Tek ndajfoljet e sasisë vërehet një veçori tjetër që s'e kanë ndajfoljet thjesht cilësore. Ato përdoren për formimin e kategorisë së shkallës si tek mbiemrat ashtu edhe tek vetë ndajfoljet. Ka dhe raste, sidomos nëpër dialekte, kur një ndajfolje mënyre shërben për të formuar shkallët; në ato raste këto ndajfolje nga ana kuptimore kanë kaluar në grupin e ndajfoljeve të sasisë. Krahaso p.sh.: *bukur mirë* e *bukur i mirë*.

Ndajfolja *bukur* në këto raste do të jetë baras nga forca e shprehjes afërsisht me ndajfoljen *shumë*, megjithëse nga pikëpamja e të shprehurit të shkallës së intensitetit të veprimit ose nga pikëpamja e të shprehurit të shkallës së cilësisë ajo nuk barazohet plotësisht me të. Në të dy shembujt e mësipërm karakteri i shkallës së asaj cilësie të shprehur respektivisht nga ndajfolja *mirë* e mbiemri *i mirë* është më i theksuar, më i dukshëm se sa kur të njëjtat raste ndërtohen me ndajfoljen *shumë*. Ndryshimi qëndron në rrethanën që shkalla e shprehur me fjalën *bukur* merr në këto raste një vlerë emocionale. Megjithëkëtë duhet thënë se deri më sot përdorimi i ndajfoljeve të mënyrës në këtë funksion nuk është i përhapur dhe s'është bërë fakt i gjuhës letrare në të gjitha sferat e përdorimit të saj.

## II. Ndajfoljet rrethanore.

Edhe grupi i ndajfoljeve rrethanore është mjaft i përdorur. Dihet se veprimet ndodhin në kohë dhe në hapësirë dhe, si të tilla, ato kanë nevojë të përcaktohen në mënyrë sa më të plotë. Ky fakt shpjegon dhe dendurinë e përdorimit të këtyre ndajfoljeve. Kështu veprimet përcaktohen në kohë e në hapësirë jo vetëm me bashkimet *parafjalë* +

+ *emër*, nga të cilët kemi mjaft raste kalimi në ndajfolje, por edhe me ndajfolje të thjeshta e lokucione ndajfoljore.

Brenda këtij grupi dallohen këto nëngrupe:

a — Ndajfolje vendi.

b — Ndajfolje kohe.

c — Ndajfolje shkak.

Këto të fundit, ndonëse të pakta në numër, përdoren vetëm nëpër fjalitë pyetëse të drejta e të zhdrejta. Ndajfoljet e shkakut kthehen edhe në mjete lidhëse, nëse në fjalinë e dhënë mungon lidhëza e ver-tetë që do ta kryente atë funksion. Nga ana tjetër, kuptimi i shkakut shpeshherë te ky grup ndajfoljesh gërshetohet me nuancën e qëllimit, kështuqë ato pak fjalë që përbëjnë këtë grup, me një përdorim shumë të shpeshtë, mund t'i quanin ndajfolje shkakore-qëllimore.

Nga sa thamë, vërehet se në mes të dy grupeve të mëdha të ndajfoljeve ka ndryshime të rëndësishme të karakterit semantik dhe gramatikor.

Ndajfoljet rrethanore tregojnë rrethanat, në të cilat kryhet veprimi, pa përcaktuar karakterin e cilësinë e tij, ndërsa ndajfoljet cilësore emërtojnë cilësinë e veprimit. Edhe nga roli sintaksor të dy grupet gjithashtu ndryshojnë njëri nga tjetri. Kështu ndajfoljet rrethanore dalin në fjali si plotësorë vendi, kohe etj. Prandaj në plan sintaktik ato afrohen me togfjalëshat emërorë me përmbajtje rrethanore<sup>24</sup>. Krahaso, p.sh. ai punon *këtu*, dhe ai punon *në këtë uzinë*.

Edhe lidhja e ndajfoljeve rrethanore me foljet që përcaktojnë është mjaft dobët, gjë që shpjegon dhe lëvizjen e shpeshtë të tyre, përse i përket vendit që zënë ato në fjali, ndryshe nga ndajfoljet e cilësisë, të cilat kanë një lidhje më të ngushtë me foljet që përcaktojnë, «duke formuar me to një lloj togfjalëshi atributiv, me pak ndryshime nga togfjalëshi atributiv *emër + mbiemër*, dhe duke u ndodhur në po ato marrëdhënje me foljen si mbiemri me emrin e përcaktuar prej tij»<sup>25</sup>.

Por dy grupet e mësipërme ndryshojnë edhe nga ana e formimit të tyre. Dihet se për ndajfoljet ka disa prapashtesa karakteristike; por tipi i formimit me prapashtesë është karakteristik vetëm për ndajfoljet e cilësisë, ndërsa pothuajse nuk shfaqet tek ndajfoljet e rrethanës.

### I. a) Ndajfoljet e mënyrës.

Veprimet e ndryshme të shprehura nëpërmjet foljeve karakterizohen në mënyra të ndryshme. Ndajfoljet që hyjnë në këtë nëngrup janë të shumëllojshme. Së pari, hyjnë këtu ato ndajfolje që përputhen me trupin e disa mbiemrave dhe që shprehin thjesht një cilësi të veprimit, duke e karakterizuar këtë në anët më të ndryshme të shfaqjes së vet. Kështu:

a — Disa ndajfolje mënyre mund të tregojnë se si e kryen sendi i shprehur nga kryefjala një veprim, pra thjesht mënyrën e kryerjes së tij. Të tilla janë ndajfoljet: *kaluar, lehtë, litar-litar, mekanikisht, nga-*

24) A.U. Smirnickij, *Morfologia anglijskovo jazyka*, Moskva, 1959, f. 171.

25) Po ai, *po aty*, f. 171 v.

*dalë, shkurt, shpejt, ulët* etj. «Insekte të ndryshme fluturonin *ulët*; rrafsh me tokën me një zukatje të lehtë». (A. Abdihoqha, Vjeshtë, f. 59). «Ah, ç'bëra unë mizerja, që nuk ia preva *shkurt* që në mëngjez» (R. Brahimi, Katër, f. 17).

b — Të tjera ndajfolje mund të përcaktojnë një fakt, ose të shënojnë përshtypjen që krijon ai, si: *butë-butë, gjatë e gjerë, habitshëm, keq, mirë, shtrembër, urtë e butë* etj. «... duke i kërkuar të falur për fjalët e saj të papeshuara kundër djaloshit, i foli *urt' e butë*» (Sh. Musaraj, Para, I, f. 110). «Dhe fësht rregullonte dyshen me ojme që i kish vajtur *shtrembër*» (V. Kokona, Me valët, f. 25)

c — Të tjera ndajfolje mënyre mund të përcaktojnë gjendjen fizike e shpirtërore të subjektit që kryen një veprim të caktuar, si: *gëzueshëm, idhnueshëm, mërziushëm, trishtueshëm, ngushtë* etj. Rrethi i këtyrë ndajfoljeve mund të zgjerohet me ndajfolje të kategorive të tjera leksikore, në mvarësi nga semantika e foljeve që përcaktojnë. «Qamili e ndjeu vehten *ngushtë* aq ma tepër kur pa pranë ish mësuesin e vet» (A. Abdihoqha, Vjeshtë, f. 58). «Cimi, ajo vajza e vetme e Xhemal Lkundës, që kish dalë partizane për të mos u martuar me plakun Karafil Ago, rrinte *mendusshëm* te pragu i portës» (F. Gjata, Përmbysja 343).

ç — Dhe së fundi, disa ndajfolje të tjera mund të shprehin karakterin intensiv të veprimit. Nga kuptimi këto ndajfolje lidhen me ato të sasisë dhe të kohës duke shprehur shpeshherë në të njëjtën kohë disa kuptime. Të tilla janë: *flakë për flakë, menjëherë, pak nga pak, papritmas, shpesh, vazhdimisht*. «Ti, Rrapi, s'e ke kuptuar djallëzinë që përdor armiku dhe në vend që t'u përgjigjeshe *flakë për flakë* intrigave e ndihmove dhe kështu fitove vetëm urrejtjen e fshatarëve...» (R. T. Nepravishta, Fusha, f. 101).

Ndajfoljet e mënyrës përcaktojnë kryesisht foljet e ndryshme si dhe atë kategori mbiemrash që vijnë nga pjesoret e foljeve, gjë që lidhet me faktin se te këta është ruajtur në shkallë të ndryshme aftësia e foljes për të shprehur proces veprimi. «Si Napoleoni, ishte modest nga uniforma, dhe vishej pa llusë dhe pa madhështi, po ushtarët i deshte të stolisur, me ar dhe mëndafsh, të *ushqyer mirë* dhe të *paguar pasurisht*» (F. Noli, Historia, f. 123). «Zonja Agllai ish një grua jo shumë e shkuar nga mosha, me flokët që sapo kishin filluar t'i zbardheshin, të *krehur e të mbështjellur kokorreth* nga mbrapa» (Sh. Musaraj, Para, I, f. 383). «Asnjeri prej tyre s'ia mbante këngës i pari, që të ndiqej pastaj nga kori i *vendosur shkallë-shkallë* nëpër fiqt e oborrit» (J. Xoxa, Lumi, III, f. 7).

Po ndonjëherë mbiemri foljor që përcaktohet, mund të mos jetë i shprehur, si në shembullin: «Të dy, *dorë për dorë*, u futën në ujë» (J. Xoxa, Lumi, III, f. 307), ku nënkuptohet mbiemri: *të kapur*.

Fjalët që dalin në rolin e ndajfoljeve të mënyrës, mund të përcaktojnë edhe një pjesore të përdorur si mbiemër. «Një gurth, si një hojëzë mjalti, i lëmuar i lëmuar në faqe dhe në perimetrin e tij vezak qëndronte mbi kupën e dorës së saj, mbi vizat e ngastrat e lëkurës *prerë kryq e tërthuer*, e frytur si tul buke nga ai stërmadhim i çuditshëm» (J. Xoxa, Lumi, I, f. 149). «Hipi ujët, o burrë dhe e kapërceu policën e vogël... foli përsëri gruaja, duke dëgjuar se si po përpiqeshin

kusitë prej bakri marrë nga valët dhe sjellë *varaving* nëpër dhomë» (J. Xoxa, Lumi, II, f. 105).

Një vend të veçantë zënë brenda ndajfoljeve të mënyrës disa ndajfolje të formuara me prapashtesën — *isht*, si: *politikisht*, *shpirtërisht*, *historikisht*, *fizikisht* etj. Këto ndajfolje nga forma nuk kanë asnjë dallim nga ndajfoljet e tjera të këtij tipi, të formuara me të njëjtën prapashtesë, po nga kuptimi ndryshojnë pak a shumë nga të tjerat. Krahaso shembujt: «Ata dinë të paktën si mbahet pushka — tha pas pakësh si i vrarë *shpirtërisht*. (Sh. Musaraj, Para, I, f. 222). «... në luftën e përditëshme për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, janë kalitur *ideologjikisht* njerëzit tanë». (E. Hoxha, Raport në kongr. IV, f. 135). «Po të ishin likuidatorët njerëz *politikisht* të ndershëm dhe po të respektonin pikëpamjet e veta, — ata do t'i kishin hequr kandidatët e tyre, ...» (Stalin, Vepra, II. Përkth, shqip, f. 256):

Nga shembujt e sipërm duket se ndajfolje të tilla kanë pak a shumë një kuptim kufizues; ato janë të barabarta me togjet: parafjalë + emër + mbiemëri përkatës i tyre. Kështu, *shpirtërisht* = në *shpirt* a nga *shpirti* a nga *pikëpamja shpirtërore*; *ideologjikisht* = nga *pikëpamja ideologjike*; *politikisht* = nga *pikëpamja politike* dhe jo me togjet: në mënyrë *shpirtërore*, në mënyrë *ideologjike*, në mënyrë *politike* etj.

Disa ndajfolje të tjera si *burrërisht*, *pleqërisht*, *trimërisht*, *vëllazërisht* që janë formuar me të njëjtën prapashtesë, kanë vlerën e një krahasimi dhe duan të thonë: si *burrat*, si *trimat* etj.

Veçori karakteristike e ndajfoljeve që përcaktojnë mbiemrat foljorë dhe pjesoret e përdorura si mbiemra është fakti se ato vendosen përgjithësisht pas tyre, ndryshe nga ndajfoljet që përcaktojnë foljet. Kjo renditje vihet re edhe në raste kur ato përcaktojnë a cilësojnë emrat foljorë asnjandës: të folurit *haptas*, të mësuarit *përmendësh*, të shkruarit *bukur* etj.

Ndajfoljet vihen pas emrave dhe kur përcaktojnë emra foljorë, (që formohen me prapashtesën — *im*, e — *je*) të cilët tregojnë procesin ose rezultatin e veprimit. Këto përdorime vihen re në ndërtime të tilla si: në përkthimin *shqip*, *rusisht*, *frëngjisht* etj. sa herë që citohet një vepër dhe shënohet përkthimi nga është bërë.

Përdorimi i ndajfoljeve në të tilla raste dëshmon për faktin se ato përcaktojnë jo vetëm foljet, por edhe derivatet e tyre të formuara me mjete të ndryshme, të cilat, në fund të fundit, s'kanë humbur çdo gjë nga natyra e tyre foljore.

Disa ndajfolje mënyre, që kanë një kuptim përfundues a përmbyllës, nuk përcaktojnë një gjymtyrë të veçantë të fjalisë, po mund t'i përkasin gjithë përmbajtjes së saj në tërësi. «*Ashtu*, ujem si ish kënga e dytë gjysmë-toske, gjysmë-gege, i dukej m'e mallëngjyeshme e që të dy Shëmërtitë e dëgjonin dyke mbajtur veshnë». (M. Kuteli, Netë, f. 33).

Këto ndajfolje në shumicën e rasteve shprehin një krahasim. «Të qe vërtet *ashtu* siç thoshnin? (D. Shaplo, Përtëritje, f. 74).

Të njëjtin kuptim kanë edhe formimet ndajfoljore *kësilloj*, *kësisoj*, *njësoj* etj.; por duhet shënuar këtu se kuptimi i tyre varet shumë nga konteksti. «*Kësilloj* pyetej e mendohej Sefedini dyke u rënë përmezi grynjave të Shëmërtive» (M. Kuteli, Netë, f. 33).

## Ndajfolje sasië, intensiteti e shkallë

Përgjithësisht, ato fjalë që janë futur në këtë nëndarje, janë cilësuar nëpër gramatikat që vështruam, si fjalë që përcaktojnë së pari foljet e pastaj mbiemrat dhe ndajfoljet. Po natyra e tyre nuk është e tillë. Këto ndajfolje, për ne përcaktojnë jo mbiemrat në tërësi dhe kategoritë e tjera të ndajfoljeve, po vetëm kuptimin e foljeve. Ky nëngrup përcakton ashtu si dhe ndajfoljet e mënyrës, vetëm mbiemrat foljorë po kurrësi mbiemrat e tjerë dhe vetë ndajfoljet.

Ndërkaq, rastet kur kjo kategori ndajfoljesh përdoret afër mbiemrave jofoljorë dhe ndajfoljeve të tjera, duhen vështruar, sipas nesh, në një mënyrë tjetër. Në këto raste ato luajnë rolin e fjalëve shërbyese, në funksionin e një mjeti gramatikor, për të shprehur shkallët e ndryshme, si të mbiemrave ashtu dhe të ndajfoljeve. Vetë fakti që të tilla ndajfolje nuk shoqërojnë mbiemrat dhe ndajfoljet që nuk e kanë kategorinë e shkallës, na detyron të pohojmë se ato përdoren kryesisht si mjet gramatikor, duke treguar kështu se ky ose ai mbiemër, kjo ose ajo ndajfolje është përdorur në këtë ose atë shkallë. Ndonjëra prej tyre po përdoret gjithnjë e më tepër vetëm në këtë funksion, duke përcaktuar kështu gjithnjë e më rrallë veprimin e shprehur nga një folje. P.sh. ndajfoljen e sasisë *më* në shumicën e rasteve e gjejmë vetëm si të tillë. Si përcaktuese e veprimit foljor ajo del zakonisht vetëm në konstruktet mohuese të tipit: s'po punoj *më* sot, si dhe nëpër fjalitë pyetëse të tipit: Do të punosh *më* sot?. Nëqoftëse, përgjegjja në të tilla fjali do të ishte pozitive, atëhere ndajfolja *më* përdoret me kuptimin e ndajfoljes kohore *ende*.

Edhe ndajfolja *fare*, me origjinë emërore, përta i përket përdorimit qëndron në një plan me ndajfoljen *më* dhe shërben kështu vetëm si mjet ndihmës për formimin e shkallës sipërore; ndërsa si përcaktuese e veprimit foljor, ashtu si *më*, përdoret vetëm në konstruktet mohuese. Në të tilla ndërtime mohuese ato duhen parë më së fortë si përforcime të mohimit, të shprehur nëpërmjet pjesëzave mohuese: janë të rralla ndërtimet me fjalët *më*, *fare*, pa pjesëzat e mohimit. Krahaso shembujt: «Këto ditë jemi rehat, italianët *nuk* veprojnë *fare*.» (A. Abdihoxha, Vjeshhtë, f. 3). «Nazmiu i tundi grushtin para hundës, Petriti s'foli *fare* (Po ai, po aty, f. 10). «Lumtën e dashuroj unë. Këtë duhet ta dish *fare mirë* — foli Qamili që e kishte zakon të mos mbetej kurrë prapa shokëvet». (Po ai, po aty, f. 10).

Si mjete shprehëse të shkallës përdoren edhe ndajfolje të tjera të sasisë, që gjenden shpesh edhe si përcaktuese të veprimit foljor. Të tilla raste do të shihen si kalimtare me mundësi për të kaluar më vonë në mjete shprehëse të shkallës.

Ndajfoljet e sasisë mund të shprehin:

1. Intensitetin a shkallën e veprimit si: *fort*, *fort e më fort*, *shumë*, *tepër*, *së tepërmi* etj. «Mihali, djali im i madh, e donte tokën *shumë*, e punonte me dashuri, dhe ia kishte ënda të rrinte gjithëmonë përjashta. (N. R. Prifti, Tregime, f. 59). «... duke u shtrënguar *fort e më fort*, po edhe duke u kujdesur të mos i shkaktonte ndonjë çrregullim në veshjen e saj elegante, e kundroi një copë herë në sytë e saj të zes...» (Sh. Musaraj, Para, I, f. 117). «Dëborë ra jo me pllaska, por shtëllunga me fërtymë sa i rëndoi *së tepërmi* malet e lartë që nisën të gjëmojnë nga tufanet...» (S. Andoni, Maleve, f. 102).

2. Disa ndajfolje a lokucione ndajfoljore edhe me prejardhje emërore, që kanë një kuptim kohor, në mvarësi nga konteksti tregojnë sasinë e kohës, që është dashur për realizimin e veprimit të shprehur nga folja, ose sasinë e kohës që ka kaluar që nga realizimi i veprimit si: *njëcopëherë, pak* etj. «Ai e këndonte këtë këngë me gaz sepse Tirana, qyteti ku banonte ai, kish *motmot* që qe bërë kryeqitet' i Shqipërisë» (V. Kokona, Me valët, I, f. 5). «Unë jam një punëto, /*Motëmot* një palë brekë, / As ato s'i qepa vetë / Po i qepa ndëpër shoqe». (Mbledhës, III, f. 176). «... kulloti sytë *një copëherë* duke shikuar me ëndje ylberin që ngrihej përmbi qytet me njërën këmbë në Krastë, dhe tjetrën në Krrabë». (A. Abdihoxxha, Vjeshtë, f. 66).

Ndajfoljet e sasisë *aq* dhe *kaq* shërbejnë zakonisht njëherazi edhe si mjet shprehës i kategorisë së shkallës edhe si korrelatë për një lidhëz krahasore e rrjedhore. Por ato mund të gjenden në përdorim edhe vetëm si shprehëse të shkallës. «Gjithë ato që kishte endur natën dhe lidhur ditën, iu dukën *aq foshnjara*, kur u gjend përpara *derës* së Tafilajve, sa mend u kthye.» (J. Xoxa, Lumi, III, f. 219). «Po ahëre, ç'dëshën këta dyqind vetë të mardhur në atë sallë të akulltë? pyesnin tani vehten mysafirët dhe s'i përgjigjeshin më dot *kaq lehtë*» (Dh. Shuteriqi, Kënga, f. 270).

Si ndajfolje sasië është përdorur më të rrallë edhe ndonjë ndajfolje mënyre. Por, përdorimi i ndajfoljeve të mënyrës si ndajfolje sasië është i kushtëzuar nga foljet pranë të cilave qëndrojnë «... është biri i em, e due *mirë*, do të vdisësha e dishprueme». (Zemra, përkth. shq., f. 99).

Përdorimi i ndajfoljes së mënyrës *mirë* në këtë funksion, si shprehëse e intensitetit a shkallës së veprimit a të gjendjes është në të vërtetë shumë i kufizuar. Rrallë herë e kemi ndeshur në letërsinë artistike të dialektit gegë, sidomos në përkthime, gjë që na lejon të themi se ai përdorim nuk duhet të jetë i gjuhës popullore po ndonjë ndikim, ndryshe nga ndajfolja *bukur*, që është pak a shumë e përhapur në dialektin e gegërishtes së folur, në funksionin e saj si shprehëse e shkallës. Megjithatë përdorimet e tipit: pasi e rrahu *mirë e mirë*, janë popullore.

Po, kalimin e ndajfoljeve të mënyrës në ato të sasisë e shkakton shpesh edhe përdorimi stilistikor i tyre. Në disa raste një ndajfolje mënyre e përdorur si ndajfolje sasië, mund të mos e humbasë fare kuptimin e saj mënyror, por në përdorim e sipër ajo mund të marrë përveç atij, edhe kuptimin e ndajfoljes së sasisë. Krahaso shembujt këtu poshtë: «Po Kozmai, që e dashuronte *keq* natyrën s'kishte fare qejf të rrinte me kokën poshtë, ...» (J. Xoxa, Lumi, I, f. 109) dhe «E rrahu *keq*».

Në shembullin e dytë ndajfolja *keq* është përdorur me një kuptim të gërshetuar mënyror e sasior. Kjo varet edhe nga kuptimi i foljes që përcaktohet nga këto ndajfolje, me kuptime të gërshetuara. Krh. edhe: «*keq* zemrohet djali i shkretë /kur shikon çfarë e ka gjetë,/ nuk i dhimbset pra kjo jetë / po s'ka vend ku t'depërtojë. (K. Jakova, Garda, f. 83).

3. Ndajfoljet e sasisë, të ndërtuara me numërorët *një, dy, tre* etj. dhe emrin *herë*, përdoren si shprehje numërore të shkallës. «Mos bir, dëgjomë mua se kam jetuar *tri herë më shumë* se ti. ...» (A. Abdihoxxha, Vjeshtë, f. 72).

Kalimi i pjesëve të ndryshme të ligjëratës në njëra-tjetrën është një proces i vazhdueshëm dhe ka arësye të ndryshme. Është i njohur si tip formimi në kategorinë e ndajfoljeve edhe procesi i ndajfoljësimit të pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Kështu disa emra që ngërthejnë në vet-

vete një cilësi në një shkallë shumë të lartë, nëpërmjet një krahasimi kalojnë pastaj në grupin e ndajfoljeve, duke u përdorur edhe si shprehëse të intensitetit të veprimit, por edhe si mjete shprehëse të shkallës. Në këtë kategori hyjnë emrat: *akull* (shumë i ftohtë), *borë* (shumë i bardhë), *flakë* (shumë i kuq), *ujë* (shumë i lagur) e disa të tjerë. «Pelat qullur *ujë* kishin marrë ngjyrë llullaqi të errët». (J. Xoxa, Lumi II, f. 92).

Ndajfoljet e sasisë nuk mund të kenë kuptim përforsues e dobësues<sup>26</sup>. Pa dyshim, në mes dy grupeve të ndara nga Sh. Demiraj në dispençën e tij, vihet re një farë dallimi në kuptim. Grupi i parë i këtyre ndajfoljeve shpreh një shkallë më të lartë ose shumë më të lartë të intensitetit të veprimit në krahasim me grupin e dytë që shpreh një shkallë më të ulët. Kjo shihet edhe nga krahasimi i të dhënave të mëposhtme: Punoj *shumë* e punoj *pak*. Këtu ndajfoljet e sasisë *shumë* e *pak* nuk shprehin ndonjë kuptim përforsues a dobësues, por vetëm tregojnë që veprimi ka këtë ose atë shkallë realizimi.

Si ndajfolje sasive përdoren edhe disa emra, të cilëve u është dobësuar kuptimi emëror. Sot në shumicën e rasteve ato përdoren për të treguar sasinë e kohës a kohën sa zgjat një veprim. Të tilla janë: *një çikë*, *një grimë*, si dhe *një copë herë*. Vetë fakti që këto ndajfolje përdoren edhe pranë mbiemrave, tregon se ato kanë kaluar a janë duke kaluar në klasën e ndajfoljeve: «Piloja pushonte *një grimë* dhe pastaj fillonte më me tërbim». (J. Xoxa, Lumi, III, f. 255). «Shtrihu Rifat, flij dhe ti *një çikë*, iu lut ajo». (A. Abdihoxha, Vjeshtë, f. 69). «E pashë që e shkela dhe mbeta *një çikëz* si i turpëruar» (Sh. Musaraj, Të shkuara, f. 34).

Edhe nga ana e lidhjes me emrin që e pason, mund të vihet re që emri nuk përdoret në formën e rrjedhës, siç ndodh rregullisht, kur emri i parë është në trajtë të pashquar, por merr formën e rasës në mvarësi nga folja që e prin në atë rast. Krh. p.sh. *Një çikë bukë*, *një çikë ujë* etj. që shkojnë paralel me *pak bukë*, *pak ujë*.

Si ndajfolje sasive përdoren ndonjëherë edhe disa ndajfolje mënyre të formuara me prapashtesën *-(i)sht*. Këto ndajfolje janë përdorur së pari si fjalë me vlerë të plotë ndajfoljore duke ngërthyer në vetëvete edhe nuanca shkalle. Po, gjenden sot raste, sidomos në letërsinë artistike, ku të tilla ndajfolje shërbejnë si mjete shprehëse të shkallës qoftë të mbiemrave, qoftë të vetë ndajfoljeve. Të tilla janë ndajfoljet: *jashtëzakonisht*, e cila shumë rrallë haset në përdorim me funksion thjesht ndajfoljor, *plotësisht*, *egërsisht*, *çuditërisht*, *mrekullisht* etj. «E si ia tregoi e ndjeu vehten *jashtëzakonisht* të qetë e të lumtur.» (F. Gjata, Përmbysja, 47). «Hamleti fshin e shuan nga zemra çdo ideal tjetër dhe sakrifikon edhe të dashurën e tij Ofelinë, nga frika se mos kjo dashuri i sjell ndonjë ndalim dhe kjo tregon një njeri *egërsisht* praktik». (F. Shakespeare, F. Noli, Hamleti, Introdiktë f. 6) «... gracka e dramës së vëlla-vrasjes..., tregon që Hamleti është *çuditërisht* i zoti të bënjë një plan aqë hollë e aqë thellë nga pikëpamja psikologjike sa gjykatësi kri-

26) Sh. Demiraj mendon që «Ndajfoljet e sasisë mund të kenë kuptim përforsues e dobësues». Kanë kuptim përforsues ndajfolje sasive të tilla si: *shumë*, *tepër*, *fare*, *aqë*, *kaqë*, *mjaft*, *më*, *jashtëzakonisht* si dhe lokucionet ndajfoljore *njëherë*, *dy herë*, *tri herë* etj. dhe ndajfoljet e përngjitura *njëfish*, *dyfish*, *trefish* etj. P.sh. Ai punon *shumë* sepse është *jashtëzakonisht* i ndërgjegjshëm etj. Kurse ndajfolje të tilla si: *pak*, *më pak*, *aspak* etj. kanë kuptim dobësues: P.sh. Ai ha *pak* e flet *pak*; Tashti po lodhem *më pak* se më përpara» (vep. cit. f. 259).

minalist më praktik e më modern.» (Po ai, po aty, f. 6). Në këto përdorime që nuk janë të shpeshta, kemi të bëjmë, me sa duket, me ndikime gjuhësh të huaja, sidomos të gjuhëve neolatine. Meqë shqipja zotëron mjete të tjera e të shumta leksikore për formimin e shkallëve, kjo mënyrë formimi nuk duhet përkrahur e duhet mënjeluar nga përdorimi.

Si përfundim, mund të themi që ndajfoljet e sasisë nuk formojnë një klasë homogjene. Fjalët që hyjnë këtu janë me funksione të dyfishta. Edhe në gjuhët e huaja vihet re ky karakter i këtij nëngrupi ndajfoljesh. Kështu R. L. Wagner, J. Pinchon pohojnë: «Është mirë, pra, të bëhet një dallim në mes të ndajfoljeve që janë thjesht gjymtyrë dhe të atyre që janë shenja (marques). Po duhet shënuar gjithashtu që e njëjta ndajfolje, kur e lejon kuptimi, mund të jetë herë si gjymtyrë e herë si shenjë, sipas përdorimit të saj në frazë»<sup>27</sup>.

Edhe N. Steinberg, duke folur për klasifikimin semantik të ndajfoljeve, dallon si grup të pestë «ndajfoljet e intensitetit dhe të shkallës që shënojnë intensitetin e një veprimi ose të një cilësie. Disa nga këto ndajfolje janë lloje *fjalësh-vegla*, pjesëzash»<sup>28</sup>.

### B. 1. Ndajfoljet e kohës.

Grupi i ndajfoljeve rrethanore është mjaft i përdorur. Roli kryesor i tyre është që të tregojnë rrethanat në të cilat kryhet veprimi i shprehur nga folja. Edhe ndajfoljet e kohës përcaktojnë kryesisht kategorinë e foljeve. Megjithkëtë edhe këtu gjenden shpesh raste kur një ndajfolje kohe mund të përcaktojë edhe një emër foljor asnjëherë. Kjo lidhet gjithnjë me faktin se këta emra ruajnë ende diçka nga rënja e tyre foljore. Këto ndajfolje mund të përcaktojnë edhe një mbiemër foljor ose një pjesore të përdorur si mbiemër, gjë që lidhet po me të njëjtën arsye. Po sjellim disa shembuj: «E ç'të them, o bujer, unë mezi i sjell nër ment, si nëpër mjegull ç'pata dëgjuar *njëherë e njëherë* për Bendo Shapërdanë.» (M. Kuteli, Netë, f. 48). «Si stoli në një nga muret që varur një dhimisqi, ardhur nga Damasku, trashëguar *brez pas brezi*, e kthyer, me miell të ergjëndë, zbukuruar me telish.» (V. Kokona, Me valët, f. 189). «Traga e gjërë e thelluar *vit për vit* nga rrotat e qerreve, nga patkonjtë e kafshëve..., sot ishte bërë lumë i vërtetë». (J. Xoxa, Lumi II, f. 104).

Ndajfoljet e kohës mund të shprehin raporte të ndryshme kohore të veprimit foljor:

a — kohën e saktë të kryerjes së një veprimi lidhur me çastin e ligjërisht si: *ditën, dje, mot, natën, ndajnate, nesër, pardje, pasdreke, pasnesër, sot, tani, vjet* etj. «Ç'kishin këta kaurët e Çukasit që i binin përzishëm, kambanës *ndajnate*?» (Dh. Shuteriqi, Kënga, f. 184). «Mos hajde *ditën*, po haj *natënë*, të shohën burrat, pa të vrasënë. (Mbledhës, II, f. 207).

b — kohën sa zgjat një veprim si: *gjatë, gjithmonë, gjithnjë, kurdo, kurdoherë, ngaditë, ngaherë, përditë, përngaherë, përvit, së gjalli, tërmonë* etj. «Shqipëria *kurdoherë* /ka genë shumë e lëvduar.» (N. Fra-

27) R. L. Wagner — J. Pinchon, *Grammaire du français classique et moderne*, Paris, 1962, f. 380.

28) N. Steinberg, *Grammaire française*, Pj. I, Moskë, 1966, f. 260.

shëri, Histori, f. 4). «... Unë do të vij për nga herë në shtëpinë tuaj, ty do të të dua veç së tjerëve...» (S. Andoni, Maleve, f. 17).

c — dendurinë e veprimit foljor si: *dendur, ndonjëherë, nganjëherë, rrallë, shpesh*. Ky tip fjalësh, siç është thënë dhe më sipër, është vështirë të dallohet në përdorim përsa i përket funksionit të tij. Shpesh këtu vihen re gërshetime nuancash kohe e sasie, gjë që e vështirëson të dalluarit e tyre.

ç — Disa ndajfolje kohe ose lokucione ndajfoljore mund të përcaktojnë veprime që janë kryer në të kaluarën ose që do të kryhen në të ardhmen, por pa qenë në gjendje të përcaktojnë kohën e saktë të realizimit të tyre, si: *dikur, një herë, një viti, një ndajnate, një ditë prejditësh, njëditëzaj, njëherë e një natë, një herë e një kohë, një herë e një herë, njënatëz, një vere, një moti, së lashti* etj. «Një vere, kur gjeti punë për të vizatuar në një fshat të humbur të Alpeve, tek ishte sulur një ekip etnografësh u zhduk disa muaj bashkë me Poletën e u kthye «i pasur» si thosh». (Dh. Shuteriqi, Kënga, f. 291). «Një herë e një herë, sot e s'di sa mot më parë na ish një vashëzë e mbetur e varfërë pa mëmë, pa tatë.» (M. Kuteli, Kapllan Aga, f. 55). «Po fyelli i Tanës duhej të shetiste buzë më buzë dhe shtëpi më shtëpi, që t'u binte brez pas brezi këngëve të ra, për të cilat e kishte gdhendur Miri së lashti» (Dh. Shuteriqi, Kënga, f. 35).

Disa ndajfolje kohe si *kurrë, kurrën e kurrës, asnjëherë*, dalin përgjithësisht vetëm si gjymtyrë e dytë e mohimit, gjymtyra e parë e të cilit mund të jetë një pjesëz mohimi *nuk, s', mos, pa*. Përdorimi i tyre pa u shoqëruar me pjesëza, i cili del nëpër veprat e ndryshme goftë letrare, goftë shkencore a publicistike, shfrytëzohet me qëllim që të mohohet me më shumë forcë mendimi i shprehur. Ja disa shembuj. «— Lumtën e dashuroj unë. Këtë duhet ta dish fare mirë — foli Qamili që e kishte zakon të mos mbetej *kurrë* prapa shokëve» (A. Abdihojha, Vjeshtë, f. 10). «Po Qemalit vallë ashtu i sinqertë siç është si shkon *kurrë* ndërmend një djallëzi e tillë për shokët e tij, që ai i quan të gjithë si vehten e tij?» (Sh. Musaraj, Para, I, f. 161). «Më gjete *kurrë* fjalëngrënë e besë-shkelun?» (S. Pitarka, Trimi, f. 93). «Gabon *kurrë* Vasili të ta japë plot?» (S. Çomora, Syleshi, f. 134). «E pse të qaj? Sa e çuditshme që je, moj Sofikë! Qan *kurrë* njeriu nga dashuria?» (V. Kokona, Me valët, II, f. 137).

d — Gjithashtu disa ndajfolje e lokucione ndajfoljore kohe mund të tregojnë se veprimi i shprehur nga folja përsëritet rregullisht pas një periudhe të caktuar kohe. Këtu hyjnë lokucionet *ditë për ditë, javë për javë, natë për natë, mot për mot, herë pas here, kohë pas kohe, kohë më kohë* etj. «*Kohë pas kohe* shpërndareshin trakte të Partisë komuniste pa u marrë vesh kush i shpërndante, sikur të binin nga qielli». (F. Gjata, Përmbysja, 182). «E nga kjo punë zjarr sot e zjarr nesër, varr sot e varr nesër, fshati binte *mot me mot*, si nga njerëzia e nga pasuria.» (M. Kuteli, Netë, f. 51). «Po më çmendet çuni nga kjo luftë e mallkuar! murmuriste Sabrie hanmi duke zgjatur kokën *herë pas herë* në kanatin e portës me shpresë se mos shikonte të birin duke ardhur.» (A. Abdihojha, Vjeshtë, f. 117).

dh — Disa lokucione ndajfoljore tregojnë se veprimi i shprehur nga folja realizohet në çast; të tilla janë *aty për aty, menjëherë, në çast* etj. «Desha t'i përgjigjesha e t'i thosha se mikpritja legjendare shqiptare nuk është e njëlojtë për këdo; se shqiptari miqtë i pret me bukë, kripë e zemër dhe armiqtë me pushkë, po, *aty për aty* e mbajta këmbën në

yzengji; e gjeta më me vend t'i ruaj fishekët për në fund, ...» (N. Bulka, Legjenda, f. 56), «*Aty për aty* njësitë vendosi të mbliidhej në shtëpinë e Lumtës.» (A. Abdihoqha, Vjeshtë, f. 52). «*Në çast* nga zjarri erdhi një shushurimë e shurdhër, e gruaja e kuptoi se qe derdhur uji i kafesë...» (R. T. Nepravishita, Fusha, f. 70 v.) «Gjermanët *menjëherë* u tërhoqën dhe këtë rradhë lanë sheshit armët e çdo gjë.» (Z. Sako, Nga jeta, f. 7).

## B. 2. Ndajfoljet e vendit

Ndajfoljet e lokucionet ndajfoljore që hyjnë në këtë grup përcaktojnë veprimin e foljes ose gjendjen me rrethana të ndryshme vendi. Pra si rrjedhim, ato përcaktojnë kryesisht një folje në çdo kohë qoftë ajo; po, përveç kësaj, ato mund të përcaktojnë edhe emrat foljorë asnjans si dhe pjesoret e mbiemëruara. «Shigjetat si breshërimë / *I vinë ngado*, / *Ay* posi vetëtimë / *Ikën* nëpër to» / (N. Frashëri, Lulet, f. 23). «Po kënga ç'na sillte këngën — kush me të shtruar e me të fellë, kush me të *ngritur lart* e me të buçitur» (M. Kuteli, Netë, f. 40). «Dita ish e butë, me ca re të *shpërndara aty këtu* nëpër qiellin e kaltër» (Sh. Musaraj, Para, I, f. 213).

Ka raste kur ndajfoljet e vendit mund të përcaktojnë edhe kuptimin e një emri jofoljor dhe të një përemri<sup>29</sup>. Këto raste shpjegohen me mosshprehjen e foljes *jam* në kuptimin *ndodhem*, meqë ajo nënkuptohet lehtë, si dhe të foljeve të tjera që kanë kuptimin e të gjendurit a të ndodhurit në një vend të caktuar. Ja disa shembuj: «E ç'u ngulëm këtu si hunj gardhi?... u përmend i pari Llazi. Flamet e rasave do kenë marrë dhe arat *sipër*... O burra atje (J. Xoxa, Lumi, II, f. 8). «U drejtua te dera e dhomës *përkarshi*, ku flinin të zotët e shtëpisë». (Sh. Musaraj, Para, I, f. 344).

Po një ndajfolje vendi mund të përcaktojë një emër jofoljor në një renditje të tillë: *parafjalë + emër foljor + ndajfolje*. Ja dy shembuj për krahasim: «Ordinancë?... Ordinanca është ordinancë; iu përgjigj Nazmi beu *me mendjen gjetskë*» (A. Abdihoqha, Vjeshtë, f. 35). «Tre ballistët *me Muratin përpara* u futën në magaza» (po aty, f. 112).

Ndajfoljet e vendit mund të tregojnë: a — vendin ku kryhet një veprim ose ku ndodh një ngjarje lidhur me një pikë të hapësirës. Të tilla janë: *aty, këtu, atje, matanë, larg, afër, rreth, pranë, djathtas, majtas, përtej* etj. «Komunisti revolucionar duhet të punojë me një ndër-gjegje të lartë *atje* ku e ka caktuar dhe ku ka nevojë partia, duke vënë kurdoherë e mbi të gjitha interesin e përgjithshëm. (E. Hoxha, Raport në kongr. V të PPSH, f. 93). «Zotnia pa kthyer sytë *as djathtas as majtas*, hoqi kapelën kashtore nga varësja e rrobave pranë derës dhe, pa përshëndetur njeri, u nis të dalë» (Sh. Musaraj, Para, I, f. 443). «*Aty* në Peshkopi në kërcunë e një dushku kisha ngritur çerdhen time.» (N. Bulka, Skica, f. 21).

Nganjëherë ndajfoljet me origjinë përemërore përdoren me një kuptim mjaft të gjerë e të papërcaktuar mirë; si pasojë, që të saktësohet në mënyrë më të plotë vendi i kryerjes së veprimit ose gjendja, ato pasohen nga një ndajfolje tjetër. Krahaso shembujt e mëposhtëm: «*Aty pranë* punonte Qamili, që s'dihej pse i shikonte orë e çast me ngulmë lëvizjet e ngathat të gishtërinjvet të saj». (A. Abdihoqha, Vjeshtë, f. 6). «Ai u mat të pyeste për Lumtën, po atë çast u dëgjua e qeshura e saj

29) Shih për këtë edhe A. Xhuvani, *vep. cit.*, f. 193, Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 257.

*atje brenda*» (po aty. f. 5). «*Atje poshtë*, në mes të qytetit, herë herë ndriçonte ndonjë dritë e zbehtë, ia thoshte një gjel i përgjumur, ngrihej uturima e një motorri...» (po aty, f. 4).

Si pikë orientuese që shërben si nisje për të treguar me saktësi vendin ku kryhet veprimi, mund të shërbejë një objekt çfarëdo që shihet nga folësi e dëgjuesi ose që njihet nga të dy. Si pikë orientuese mund të shërbejë gjithashtu edhe vetë folësi ose bashkëbiseduesi.

b — Disa ndajfolje të tjera vendi tregojnë një vend të palokalizuar me saktësi, të tilla si: *vende-vende, diku-diku, diku, gjëkund, gjëkë, gjëtiu*. «Era kishte hedhur metale dhe *vende-vende* dëbora ngrihej përpjetë si mal» (Th. Kacori, Për mëmëdhenë, II, f. 41).

Ky tip ndajfoljesh që shpreh një vend të papërcaktuar, mund të jetë edhe një lokucion ndajfoljor i formuar nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet një parafjalë si: *mur më mur, qoshe më qoshe, odë në odë*. «bënim punë pa punë dyke rendur *mur më mur e qoshe më qoshe*, kur duke qarë e kur duke qeshur, ...» (M. Kuteli, Netë, f. 60).

c — Disa ndajfolje e lokucione ndajfoljore vendi janë të një kuptimi më të përgjithshëm dhe shprehin kështu vendin e kryerjes së veprimit e të ndodhjes së një sendi, pa dhënë njoftim për një lokalizim të tij me përafërsi. Si të tilla janë fjalët: *gjithkah, kudo, anëmbanë, anë e kënd, kënd e kënd* etj. «... dielli do të ndriçonte *anëmbanë*, pëllumbat do të çanin përsëri hapësirën, pemët s'do të thaheshin kurrë më...» (A. Abdihoxha, Vjeshtë, f. 19). «U hap fjala *fund e kënd* gjer sa i ra në vesh e një plaku të uruar nga Çermenik' e Madhe». (M. Kuteli, Netë, f. 153).

Ndajfoljet e vendit me origjinë përemërore përdoren shpesh edhe si korelatë në fjalitë prej të cilave varet një fjali vendore. Përdorimi i tyre është i lidhur me domosdoshmërinë e përdorjes së një lidhëze me kuptim vendor si: *ku, tek* etj. P.sh. «I zemruar së tepërmi, ai vra-poi me revole në dorë *atje* ku ishin kacafytur dy njerëz» (A. Abdihoxha, Vjeshtë, f. 23).

Ndajfoljet e vendit si dhe ato të kohës mund të shoqërohen me pjesëzën *që*, e cila tregon pikën e fillimit të lëvizjes a të fillimit të veprimit si dhe me pjesëzën *gjer*, që tregon pikën e mbarimit të lëvizjes a të veprimit në vend e në kohë. Kështu kemi: *atje: që atje, gjer atje; ahëre: që ahëre, gjer ahëre; aty: që aty, gjer aty; tani: që tani, gjer tani*, që tregojnë ndryshimin ndërmjet qëndrimit e lëvizjes për ndajfoljet e vendit si dhe ndryshimin në mes të një veprimi që zhvillohet në një kohë të caktuar dhe veprimit që nis ose përfundon në një kohë të caktuar. Krahaso: *tani* dhe *që tani* e *gjer tani*, ku ndajfolja *tani* e pashoqëruar me pjesëza tregon për një veprim që kryhet në momentin kur flasim, ndërsa, po kjo ndajfolje, e shoqëruar me pjesëzat e sipërpërmendura, tregon që veprimi fillon në këtë çast ose që ai merr fund në çastin e dhënë.

#### *Ndajfoljet e shkakat.*

Ky grup ndajfoljesh deri tani nuk është trajtuar pothuajse fare<sup>30</sup> si kategori më vete në gramatikat tona. Autorët e ndryshëm vendas të gramatikave kryesisht shkollore ose nuk i përmendin fare, ose kalimthi

30) I. D. Sheperi në gramatikën e tij i klasifikon në një kapitull të veçantë, po pa i shtjelluar.

japin ndonjë shënim duke i quajtur si ndajfolje pyetëse<sup>31</sup> e duke përcaktuar, gjithmonë kalimthi, edhe natyrën e tyre<sup>32</sup>.

Ndajfoljet e këtij tipi janë parë kryesisht vetëm në ato raste kur shërbejnë si mjet lidhës i një fjalie, qoftë kjo e varur a kryesore, me një fjali tjetër domosdo të varur<sup>33</sup>.

Ne do t'i grupojmë këto si një kategori më vete, megjithëse janë të një numri minimal. Ato përdoren për të pyetur për shkakun ose për qëllimin e veprimit; kërkojnë pra një pohim a mohim për shkakun që përcakton ose jo kryerjen e veprimit, ose tregojnë qëllimin e vërtetë të kryerjes së tij. Në këtë grup ndajfoljesh hyjnë fjalët *përse*, *pse* (një formë e reduktuar e së parës) dhe *prandaj*, *andaj*, *pa*. «Pse mban mëri? s'e marr dot vesh; / *Përse* s'më dot si njëherë? / *Pse* s'më shikon? *pse* nukë qesh? / Ç'rri kokunjur dhe e mjerë? / (N. Frashëri, Lulet, f. 38).

Ndajfoljet e shkakut mund të shërbejnë për të pyetur thjesht për shkakun që përcakton realizimin e veprimit, si në shembullin e mëposhtëm: «Sonte yjtë *pse* s'ndriçojnë? / Zoqtë *pse* nukë këndojnë? / *Pse* lulet, *pse* janë tharë? / *Pse*, *pse* më vjen për të qarë?» (Çajupi, Vepra, f. 241).

Po ato mund të shërbejnë për të pyetur edhe thjesht për qëllimin e kryerjes së veprimit: «Po ajo duart *përse* i kishte» (F. Gjata, Në prangun, f. 9).

Ndërsa në raste të tjera ndajfolja e shkakut mund të ketë të gërshtuar njëkohësisht si pyetjen për shkakun ashtu dhe për qëllimin e kryerjes së veprimit si në shembujt: «Dana shtangu. — *Pse* mor bir?... Dal, po si thashë qarkorit të partisë. Ai ta ndreq samarin ty.» (A. Abdihoxha, Vjeshtë, f. 84). «Po Qamili *përse* e shikonte Lumtën me aq ngulmë?» (Po aty, f. 9).

Ndajfoljet e shkakut pyesin kryesisht vetëm për veprimet, shprehëse të të cilavet gjuhësisht janë foljet, si rrjedhim, mund të themi se ato gjenden rregullisht vetëm pranë foljevet, ndryshe nga të gjitha grupet e tjera të ndajfoljeve.

Përsa u përket fjalëvet *andaj*, *prandaj*, *pa* mendimet nuk janë të njëjta tek autorët e ndryshëm. Këto fjalë janë marrë herë si ndajfolje e herë si lidhëza. Për këto fjalë është folur pothuajse rregullisht vetëm në tekstet e sintaksës. Kështu I. D. Sheperi në Gramatikën<sup>34</sup> e tij mendon se «Fjalja kryesore tregon përfundimin e rrjedhur prej fjalisë së shkakut dhe merr ndajfoljet *përandaj*, *andaj* (nënvizimet janë tonat E.H.) kur theksohet shkak». Si shembull sjell: «se punove shumë përandaj u lodhe».

Ndërsa J. Rrota në Sintaksën<sup>35</sup> e tij shprehet ndryshe: «Fjalitë e njmëndta ngiiten me kryefjalin (fjalinë kryesore — E. H.) nëpër lidhësat: ... *prandaj* — *pse*...», e pastaj vazhdon: «Për t'a theksuem ma fort shkakun, lidhësavet të fjalivet të dyta (*pse*, prejse) u përgjigjën lidhësat e kryefjalisë, (andej, prandej)». Si shembuj sjell: *Pse* je zemrëkeq prandej nuk të don kush; se ke hangrë shumë pemë, andej je

31) M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, pj. e dytë, Sintaksa. (Tekst për shkollat 7-vjeçare e shkollat e mesme), botim i tretë. T. 1957, f. 156 e 160).

32) Po ai, *po aty*, f. 95.

33) S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*; disp. I, Pj, II, T, 1962, f. 161, (Edhe ky autor i quan ndajfoljet e shkakut thjesht ndajfolje pyetëse në funksionin e tyre lidhës).

34) I. D. Sheperi, *vep. cit.*, f. 193.

35) J. Rrota, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Botim i dytë, Shkodër 1943, f. 84.

smundun». K. Cipo<sup>36</sup> dhe M. Domi<sup>37</sup> kthehen prap tek I. D. Sheperi duke i quajtur edhe këto së bashku me të parin si ndajfolje. Kështu Cipoja shkruan: «... në rasa të tilla fjalia kryesore shoqërohet me ndajfoljen pa (= andaj). Se hëngre e pive mirë pa t'ërth shëndeti». M. Domi mendon se «Kur fjalia shkajkore ndodhet përpara fjalisë kryesore, kjo e fundit mund të marrë në krye ndajfoljen pa ose *andaj*...». Se dolle pa pallto pa u ftohe».

Për mendimin tonë, këto fjalë që përdoren në krye të fjalisë kryesore, e cila paraqitet si rrjedhim i fjalisë shkakore, kryejnë në atë rast një funksion ndajfoljor për të përforcuar shkakun e shprehur nga fjalia shkakore<sup>38</sup>. Ato përdoren kryesisht kur fjalia shkakore ndërtohet me lidhëzat *pse*, *përse*, *se*, ndonëse ka dhe raste kur këto lidhëza mund të mungojnë. P.sh. Binte shi, *prandaj* s'erdha. Funksioni i këtyre fjalëve si ndajfolje duket më i qartë në ndërtime të tilla: kur jepet shkakun për mosrealizimin e një veprimi, nëpërmjet një fjalie shkakore i interesuari për mos kryerjen e veprimit pyet sërishmi: *Prandaj* e bëre këtë? *Prandaj* s'erdhe? *Prandaj* s'shkuat në punë? etj. Këtu pyetësi don të sqarojë më mirë shkakun e treguar në një fjali më sipër. Në të tilla raste këto ndajfolje janë baraz me togfjalëshet e tipit: *për këtë shkak* etj.

Sido që të jetë në këto raste mund të kemi të bëjmë me një gjendje të mesme në rrugën e kalimit nga ndajfolja në lidhëz, me pjerrje më fort te kjo e fundit.

### Shkallët e ndajfoljeve.

Afëria e ndajfoljeve me mbiemrat vihet re jo vetëm në kuptim. Një nga ato elemente që i bashkon këto dy kategori fjalësh, është kategoria gramatikore e shkallës që përgjithësisht është karakteristike vetëm për këto dy pjesë të ligjeratës. Ndajfoljet dhe mbiemrat përsa i përket këtij elementi që i afron, përputhen në mënyrën e formimit të shkallës deri në hollësira. Gjuha shqipe, ndryshe nga disa gjuhë të tjera, njeh vetëm mënyrën analitike të formimit të shkallës qoftë për ndajfoljet si pjesë të pandryshueshme, qoftë për mbiemrat. Megjithatë nuk mungojnë edhe rastet kur një ndajfolje e formuar kryesisht me prapashtesën — (*i*)sht të shprehë shkallën sipërore. Formime të tilla a, më mirë të themi, përdorime të tilla janë të reja dhe përhapja e tyre, sado e gjerë që të jetë, ka më tepër karakter stilistikor.

Jo të gjitha fjalët që hyjnë në grupet e ndryshme të ndajfoljeve e kanë kategorinë e shkallës. Edhe përsa i përket kësaj pike vëmë re një lidhje të ndajfoljeve me mbiemrat. Kryesisht përdoren në shkallën krahasore e sipërore ndajfoljet cilësore që afrojnë në kuptim me mbiemrat. Po nuk e përjashtojnë këtë kategori edhe disa ndajfolje rrethana, sidomos ato që shprehin rrethana vendore. Gjithashtu përdoren në shkallë krahasore a sipërore edhe disa nga formimet e ndryshme të tipit: parafjalë + emër, gjë që tregon se ato po marrin gjithnjë e më tepër vlerë ndajfoljore.

Brenda grupit të ndajfoljeve cilësore jo të gjitha ndajfoljet for-

36) K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti Shkencave, Tiranë 1952, f. 89.

37) M. Domi, *vep. cit.*, f. 182. Shih dhe «*Sintaksa e gjuhës shqipe*», dispensë, Tiranë 1968, f. 28 ku fjalët *prandaj*, *pra*, *andaj* (edhe *ndaj*) janë vështruar si ndajfolje a pjesëza që kanë marrë plotësisht ose në pjesë të mirë funksionin e një lidhëze a të një lokucioni lidhëzor».

38) Shih dhe S. Floqi, *Periudha me fjali të varur shkakore*, I, SF 3, 1966, f. 32.

mojnë shkallë. Pastaj të përdorurit në njëren nga shkallët e krahasimit s'do të thotë përdorje domosdo edhe në shkallët e tjera. Kështu kemi ndajfolje që përdoren në të dyja shkallët, po ka dhe asosh që përdoren ose vetëm në shkallën krahasore ose vetëm në shkallën sipërore.

Tek ndajfoljet e mënyrës hyjnë fjalë që ndryshojnë jo vetëm nga kuptimi, por edhe nga struktura. Ato paraqiten me ndryshime sipas prapashtesave me të cilat janë ndërtuar. Karakteri i ndryshëm i kuptimit të këtij grupi ndajfoljesh pasqyrohet edhe në aftësinë që kanë ato për t'u përdorur në njëren nga shkallët e krahasimit. Përmisht ndajfoljet e cilësisë janë pothuajse që të gjitha të shkallëzueshme, po një gjë të tillë nuk e pasqyrojnë faktet gjuhësore. Megjithatë ndryshimi në strukturë i ndajfoljeve të cilësisë nuk luan ndonjë rol me rëndësi në përdorjen e tyre në shkallë të ndryshme, ne për lehtësi pune po i ndajmë ndajfoljet, që përdoren në shkallët e krahasimit, sipas ndërtimit të tyre.

Përdoren në shkallë të ndryshme, së pari, ndajfoljet që përputhen me trupin e disa mbiemrave, si: *ashpër, bukur, butë, ëmbël, gjatë, gjërë, gjallë, hollë, keq, kthjellët, lehtë, mbarë, mirë, ngushtë; qartë; qetë, rrallë, rreptë, saktë, sëmurë, shpejt, ulët, urtë, thatë etj.* «Organet e drejtësisë, prokuroritë dhe gjykatat popullore, duhet të pastohen rrënjësisht nga shtrembërimet dhe rutina burokratike, të përmirësojnë tërë punën dhe të lidhen më ngushtë me masat». (E. Hoxha, Raport në Kong. e V, f. 120). «Kur ai u kthye me fytyrë dhe njohu tanë e Adilit, u trondit edhe më keq.» (J. Xoxa, Lumi, I, f. 212).

Së dyti, ndajfoljet që vijnë nga pjesoret e foljeve, si *dendur, hapur, mërguar, shkoqur, shtruar* etj. «... se yjtë janë shumë më mërguar se hëna» (N. Frashëri, Dituritë, f. 125). «Në djall puna që ju bëni... prej zilis të dy verbuar? / Po, më shkoqur, pse nuk thoni: ne të thirrëm sot me kast?» (L. Qafëzezi, Proletarët, f. 37). «Shefi i kuadrit — Uluni pak, ju lutem, t'a bisedojmë çështjen më shtruar (S. Çomora, Nga fshati, f. 33). «E mori shumë rrëmbyer dhe fytyra e tij desh u përplas me atë të Hasanit» (F. Gjata, Këneta, f. 309).

Së treti, disa ndajfolje të formuara me prapashtesën — (*i*)sht, megjithatë disa prej tyre kanë vetë kuptimin e shkallës sipërore si: *fuqimisht, hollësisht, konkretisht, lirisht, mrekullisht, ngushtësisht, rastësisht* etj. «Prandaj është e nevojshme që ju, nënë udhëheqjen e urtë të partisë sonë, të angazhoheni akoma më fuqimisht në luftë me këto «teorira» revizioniste, me këto shëmtira të kohës sonë...» (E. Hoxha, Fjala me inteligjencën, f. 45 v.). «Ajo që Mimosës i dukej e vështirë, bile ndonjëherë e pamundur, ngjau fare rastësisht» (N. Jorgaçi, Dashuria, f. 50). «Dhe kur Qemali urt' e butë i kërkoi, mikut të fliste më qartë dhe më konkretisht për të metat e zeshkanit, ai i nxori si të meta të mëdha...» (Sh. Musaraj, Para, I, f. 39).

Së katërti, shumica e ndajfoljeve që përputhen me trupin e mbiemrave më — *shëm*, si: *mendueshëm, mërzitshëm, gëzueshëm, kuptueshëm, natyrshëm, përmallshëm, përtueshëm*, etj. «Ajo kish veshur një fustan të kaltër; me lehtësi të madhe, fare natyrshëm, kish lidhur një plot hir e të hajthme». (D. Shaplo, Përtëritje, f. 103).

Së pesti, ndajfoljet që në origjinë janë rrjedhore të mbiemrave asnjans me ose pa parafjalë, të shoqëruara ose jo me ndonjë prapashtesë ndajfoljore, si: *për së afërmi, për së largu, së mbari, për së mbari, për*

së *mbrapshti*, së *fundi*, së *thelli* etj. «Mori kandilin dhe e pa me kujdes më për së afërmi». (Dh. Shuteriqi, Kënga, f. 132)

Së *gjashti*, ndajfoljet e sasisë: *shumë*, *pak*, *tepër*, *fort*.

Së *shtati*, ndajfoljet e vendit: *anash*, *andez*, *afër*, *brenda djathtas*, *këndej*, *lart*, *larg*, *thellë*, *sipër*, *poshtë*, *pranë*, *majtas*, *sipër*.

Së *teti*, formimet: parafjalë + emër me ose pa prapashtesë ose një emër asnjanes që përdoren shpesh në funksionin e ndajfoljeve, si: *me egërsi*, *me gëzim*, *me nxit*, *me nxitim*, *me tërbim*, *me zor*; *me vërtik*, *me vrull*, *me vrap*, *me të butë*, *me të egër*, *me të keq*, *me të ngutur*, *me të shpejtë*, *me të urtë*. «Balua lehte akoma më me tërbim dhe unë ndjeva si kërcitën lehtë shkallët e druja». (I. Kadare, Gjenerali, f. 69).

Vetëm disa ndajfolje kohe e njohin kategorinë e shkallës, të tilla janë fjalët: *para*, *përpara*, *prapa*, *herët*, *vonë*. Më parë përdoret si ndajfolje vetëm në formën e shkallës krahasore. «Oshëtima e luftës, — tha ai — nuk dëgjohet në spital; dhe është kjo oshëtimë që mua më shëron më përpara se çdo tjetër ilaç». (M. Shehu, Lufta, f. 75).

Edhe ndajfoljet, ashtu si mbiemrat, kanë shkallën e krahasimit me nëndarjet e saj dhe shkallën sipërore. Mjetet e shprehjes së shkallës janë po ato të mbiemrave. Si të tilla shërbejnë fjalët *më*, *aq(ë)*, *kaq(ë)*, *shumë*, *fare*, *tepër*, *fort*. Fjalët *më* e *fare* përgjithësisht, sikundër e kemi shënuar edhe më sipër, përdoren kryesisht vetëm në këtë funksion, ndryshe nga të tjerat që përdoren edhe për të shprehur intensitetin e veprimit jashtë çdo krahasimi.

Shkalla krahasore ndahet në: 1) shkallë krahasore të barazisë dhe 2) shkallë krahasore e pabarazisë. Shkalla krahasore e pabarazisë ndahet në 1) shkallë krahasore e sipërisë, 2) e ultësisë.

Ndajfoljet në shkallën krahasore të barazisë ndërtohen me fjalët *aq* e më rrallë *kaq*, duke supozuar pas tyre një gjymtyrë krahasimi qoftë kjo gjymtyrë fjalie qoftë një fjali krahasimi, që krahasohet me kryefjalën. «Asaj iu coptua shpirti kur pa të jatin të zbardhur të rruddhur sa asniëherë që e vështronte i përvuajtur... kur pa Marinë që kish ulur kokën dhe qante *aq pafajnisht* si t'ish vetë...» (N. Jorgaqi, Dashuria, f. 191). «Ai (dielli — E. H.) ndriçon, ashtu siç ka ndriçuar mijra, dhjetra mijra, miliona vjetë, *aq bukur* e *aq me madhësi*». (R. Brahim, Katër, f. 5).

Megjithatë, duhet thënë këtu se shkalla krahasore e barazisë nuk përdoret *aq* shpesh sa shkalla krahasore e pabarazisë dhe sa shkalla sipërore.

Shkalla krahasore e sipërisë shprehet vetëm me fjalën *më*. Ndajfolja e përdorur në shkallën krahasore të sipërisë mund të tregojë që një veprim realizohet në një shkallë më të lartë cilësore ose sasiore se një tjetër, ose që realizimi i tij ndodh më parë në kohë se sa realizimi i një veprimi tjetër; ndajfolja e përdorur në këtë shkallë mund të tregojë gjithashtu se një veprim ka një shkallë më të lartë intensiteti se një tjetër. Sikundër shihet, ndryshe nga shkalla e krahasimit të barazisë, të cilën e formojnë pothuajse vetëm ndajfoljet e lokucionet ndajfoljore të cilësisë, shkalla krahasore e sipërisë është karakteristike për një numër të madh ndajfoljesh si të cilësisë, të kohës, të sasisë dhe të vendit. «Që atje mund të shihte më mirë, në të ngrysurit e natës që tkur e ngushton horizontin, ardhjen e lundrës me të shoqin e të birin». (J. Xoxa, Lumi, II, f. 141). «Mos bir, dëgjomë mua se kam jetuar tri herë më shumë se ti». (A. Abdihoxha, Vjeshtë, f. 72).

Ndajfolja në shkallën krahasore të sipërisë mund të marrë para saj edhe fjalët *shumë* ose *pak* për të treguar që shkalla e intensitetit të veprimit a gjendjes të gjymtyrës së parë është *shumë* ose *pak* më e lartë se sa ajo e gjymtyrës së dytë. P.sh. «Pastaj ai vonoi shumë, *shumë më tepër* nga ç'duhej, po roja kishte urdhër të priste gjer në agim». (I. Kadare, Gjenerali, f. 121). «*Pakëz më vonë*, duke mbledhur litarët në kaptellin e samarit, e pyeti Stefanin pa e vështruar në sy...» (F. Gjata, Tana, f. 75).

Për të shprehur shkallën sipërore përdoren fjalët: *më, shumë, mjaft, fare, krejt, bukur, sa, aq*, etj. Shkallën sipërore e ndërtojnë me pjesëzën *më* vetëm dy ndajfolje cilësore që janë në origjinë mbiemra cilësues të rasës rrjedhore, si: *më së miri* e për analogji me të edhe *më së keqi*, të cilat përdoren pothuajse vetëm në formën e shkallës: «Kur erdhi djali, u çudit, kur pa se të gjitha gjërat në shtëpi ishin të rregulluara *më së miri*.» (I. Folklorit, Proza, IV, f. 533). «Ja shokë, një pasqyrë e qartë, e cila flet vetë, mbi epërsinë e sistemit socialist, e cila tregon *më së miri* se vetëm socializmi krijon mundësitë reale që punonjësit të bëjnë një jetë më të mirë e më të begatëshme» (E. Hoxha, Fjala me rastin e 15 vjet, të çlirimit, f. 24). «Franci: Cila prej tyre e prish lulen e jetës *më së keqi*.» (Shiler. Dramat, prkth. shq. i S. Luarasit, f. 50.). Në këtë konstrukt gjithë ndërtimi ka vlerën e sipërores.

Kur shkalla sipërore ndërtohet me fjalët *aq, kaq, sa*, ka zakonisht karakter afektiv; ajo shpreh qartë qëndrimin e folësit ndaj objektit të tij të bisedës, duke marrë kështu një vlerë emocionale. «Edhe gjithë gjë e gjallë ndjen në zemër një dëshirë. / Një gaz t'ëmbël e të shumë, o' *sa bukur e sa mirë!*» (N. Frashëri, Bagëti, f. 6). «Ah, me ta pse s'vamë? / Na lanë të shkretë! / Kur ishin të gjallë, / *sa shumë* i donim!» (N. Frashëri, Lulet, f. 31).

Sikundër shihet, në të tilla raste rregullisht pas shkallës sipërore as nuk përdoret as nuk nënkuptohet një fjali rrjedhore, gjë që vihet re herë-herë kur shkalla sipërore e ndërtuar në këtë mënyrë nuk ka karakter afektiv. Fjalët *aq e kaq* në këto ndërtime mund të shërbejnë në të njëjtën kohë edhe si korelate të lidhëzës rrjedhore *sa*. «Sekretari bisedonte *aqë thjeshtë*, sa Stavri e ndjeu vehten shumë të çlirët e sikur po bisedonte me i hypë gomarit në shpinë!» (Proza I, f. 41). «Mos m'leni martin' e rreth / M'ka marrë pushka *bukur keç*...», (Këngë historike, f. 235). «Andaj *bukur mirë* kanë thënë se, Madhështija është bijë e paditjesë edhe mëm' e prishjes.» (J. Vreto. Mirëvetija, f. 62). «Po ditë fare pak kaluan / Dhe *bukur mirë* e mora vesh se ç'do të thoshnin ato fjalë / kur vendi punës ju përvesh.» (A. Varfi, Në tingujt, f. 95).

Për t'i dhënë më shumë forcë shprehjes së shkallës ndonjëherë përdoret edhe përsëritja e fjalës që ndërton shkallën sipërore, si: *shumë shumë, fort fort* etj. «Lumtës, me gjithë armiqësinë e madhe që kishte ndaj Nazmiut, i erdhë *shumë-shumë keq*, aq më tepër kur u bind se ai fliste me singëritet.» (A. Abdihoxa, Vjeshtë, f. 148).

Në gjuhën shqipe, ashtu sikundër përsëritet mbiemri, përsëritet edhe ndajfolja, përsëritje që zakonisht nuk çon në formime të reja. Vlera e një përsëritjeje të tillë është më fort ajo e «intensifikimit të kuptimit të përgjithshëm».<sup>39</sup> Ashtu si dhe tek mbiemrat, ajo ka më shpesh «një vlerë afektive të fortë që mungon te sipërorja absolute e formuar me ndajfoljen shumë».<sup>40</sup>

Përsëritje të tilla si: *butë-butë, hollë-hollë, lehtë-lehtë, qetë-qetë, thellë-thellë, fort-fort, ngrehur-ngrehur, menduar-menduar, shtruar-shtruar, serbes-serbes* etj. është vështirë t'i barazosh me shkallën sipërore të formuar me fjalët shërbyese: *shumë, mjaft, tepër* etj. p.sh. «Veriu i hollë prekte *lehtë-lehtë* kallinjtë e artë të grurit» (R. T. Nepravishta, Fusha, f. 95). «Njëra prej tyre, më duket se Nastasija, filloi të na tregojë me zë të platur *shtruar-shtruar, urtë-urtë* një prallë të gjatë të gjatë sa një litar Vranje. . . » (M. Kuteli, Netë, f. 65). «Pastaj, duke u rënë mustaqeve të holla me majat e gishtërinjve, erdhi e i tha *ngrehur-ngrehur*.» (J. Xoxa, Novela, 1958, f. 73).

Të njëjta nga vlera janë dhe përsëritjet e ndajfoljeve nëpërmjet një lidhëze këpujore e; kjo duket edhe nga fakti se përdoren për disa ndajfolje të përsëritura forma paralele me dhe pa lidhëz. Kemi kështu: *shpejt e shpejt, mirë e mirë, larg e larg, fort e fort, vonë e vonë, pranë e pranë, fjet e fjet* etj.

Përdoren shpesh në shqipen edhe përsëritjet *ndajfolje + e + ndajfolje në shkallën krahasore* si: *dendur e më dendur, lart e më lart, larg e më larg, fort e më fort, keq e më keq, mirë e më mirë, poshtë e më poshtë, rrallë e më rrallë, shpesh e më shpesh, tej e më tej, tutje e më tutje, thellë e më thellë* etj. Në pajtim me E. Lafen ne mendojmë se «këto përsëritje tregojnë një rritje progresive shkallë-shkallë të cilësisë së një veprimi ose të një rrethane vendore».<sup>41</sup> Duhet shënuar se përsëritje të tilla nuk gjejnë korespondueset e tyre te mbiemrat.

Gjenden edhe raste të rralla në shqipen, kur një ndajfolje në formën e shkallës krahasore përdoret para një emri duke e drejtuar atë në një rasë të caktuar, gjë që shënon kalimin e saj në parafjalë. Ky fakt, sadoqë është pak i përhapur, tregon se kategoria e shkallës e ndërtuar analitikisht është menduar si një njësi, elementet përbërës të së cilës nuk mund të ndahen. Krahaso shembujt: «Më thuaj pse krise e ike te vjehri bash atëhere kur duhej të ishte *më pranë nesh?*» (V. Vinçani, Të rinjtë, f. 39). «Bashkë ishin sulur përpjetë, kush e kush t'ia kalojë, me kokën vërtitur lart e mbajtur, lart, sa më afër qiellit, sa më afër diellit» (J. Xoxa, Lumi, II, 94).

### *Kalime të ndajfoljeve në pjesë të tjera të ligjeratës.*

Ndër çështjet e rëndësishme të kësaj teme është dhe problemi i marrëdhënieve të ndajfoljeve me pjesët e tjera të ligjeratës: me parafjalët, lidhëzat e pjesëzat. Shumë ndajfolje përdoren në gjendjen e

39) R. A. Aganin, *Povtori i odnorodnije soçetaniija v sovremennom tureckom jazyke*, Moskva 1959, f. 104.

40) E. Lafe, *Përsëritja si mjet gramatikor i shprehjes së aspektit dhe shkallës sipërore në gjuhën shqipe e parë edhe në krahasim me rumanishten* «Studime filologjike», nr. 4, 1966, f. 131-132.

41) Po ai, po aty, f. 66.

sotme të gjuhës shqipe në disa funksione: herë si ndajfolje, herë si parafjalë, herë si lidhëza e herë-herë edhe në funksionin e pjesëzave.

E pandryshueshme nga pikëpamja formalo—gramatikore, e lëvizshme në funksionet e saj, ndajfolja afrohet në përdorim sa me pjesët e tjera kuptimplote aq edhe me fjalët sherbyese. Në gjuhën e sotme shqipe (qoftë në të shkruarën a në të folurën) gjenden një radhë fjalësh që përdoren edhe si ndajfolje edhe si parafjalë. Si të tilla mund të përmendim ndajfoljet e vendit e të kohës: *para, prapa, poshtë, pranë, afër, larg, matan, përpara, sipër, lart, përpetë, jashtë, tej, përtej, brenda, majtas, djathtas, rreth, rrotull, tutje, përkundrejt, përkarshi, përreth, anash*, etj. «... ktheu e ndrojtur kryet *anash* se mos e kish parë njeri dhe pëshpëriti nëpër buzë». (T. Laço, Rruga, 18). «Ganiu shkante *anash*, me një dorë mbante të vdekurin, me tjetrën fërkante mjekrën e zezë.» (S. Godo, Plaku, 131). Përdoren gjithashtu edhe si parafjalë lokucionet ndajfoljore të tipeve të ndryshme. Kështu kemi: *an e kënd, anës e anës, rrëzës e rrëzës, ballë për ballë, mës për mës, rreth e rreth* etj.

Kalimi i ndajfoljeve në parafjalë është i lidhur me disa veçori: Së pari, kur ndajfoljet kalojnë në parafjalë ato humbasin kuptimin e tyre për të shprehur rrethana të ndryshme të veprimit të foljes dhe fitojnë një kuptim të ri, atë të shprehjes së marrëdhënjeve në mes të fjalëve kuptimplote.

Së dyti, kalimi i ndajfoljeve në parafjalë është i lidhur dhe me dobësimin në maksimum të theksit. Ndajfolja është një fjalë e mvetësishme me theks si të gjitha fjalët kuptimplote, por kur kalon në parafjalë ajo mbetet pothuajse e patheksuar ose me theks mjaft të dobësuar. Krahaso: Ec *para* dhe ec *para meje*. Ecte *anës* dhe ecte *anës murit*. Fjalët *para* dhe *anës* në rolin e parafjalëve nuk e kanë theksin aq të fuqishëm sa kur përdoren si ndajfolje.

Siç e shënon dhe V. V. Vinogradov<sup>42</sup>, «kalimi i ndajfoljes në parafjalë, shkalla e afërsisë së saj me parafjalën kushtëzohen nga kuptimi leksikor dhe gramatikor i ndajfoljes. Ato varen nga afëria kuptimore që kanë ndajfoljet me parafjalët. Ndajfoljet *para, prapa, larg, afër, sipër* shprehin rregullisht rrethana vendore e kohore.

Dihet që parafjalët shërbejnë si shprehëse të marrëdhënieve të ndryshme në mes të gjymtyrëve të fjalisë. Kështu që afëria që paraqesin në kuptim ndajfoljet me parafjalët bëhet si favorizuese e kalimit të të paravet në parafjalë. Përsa i takon anës gramatikore, duhet thënë që ndajfoljen e parafjalën i bashkon i njëjti tipar: karakteri i pandryshueshëm i tyre; kështu që edhe nga pikëpamja morfologjike ndajfolja s'paraqet vështirësi për t'u shndërruar në parafjalë.

Nga këto që u thanë këtu, nuk duhet nxjerrë, përfundimi që çdo ndajfolje qenka e aftë të kalojë në parafjalë. Duhet thënë që jo të gjitha ndajfoljet afrohen me parafjalët nga ana kuptimore. Nga ana leksikore shumëllojshmëria kuptimore e parafjalëve mund të mos përputhet dhe nuk përputhet me kuptimet e shumta që kanë ndajfoljet. Si u tha këtu, kalojnë në parafjalë vetëm ato ndajfolje që janë të afërta në kuptim me parafjalët, d.m.th. vetëm ato ndajfolje që shprehin rrethana vendore e më rrallë, kohore.

42) V. V. Vinogradov. *Ruskij jazyk. Grammatičeskoje učenije o slove*, Moskva 1947. f. 395.

Ndajfolja shërben gjithashtu edhe si shkallë e ndërmjetme për kalimin e pjesëve të tjera të ndryshueshme të ligjeratës në parafjalë. Në këtë mënyrë kemi sot disa emra që përdoren si ndajfolje dhe si parafjalë. Më parë se të përdoreshin edhe si parafjalë, ato, duke u nisur nga emrat, janë përdorur një herë si ndajfolje e më vonë afëria leksikore e këtij tipi ndajfoljesh me parafjalët bëri që ato të përdoren edhe si parafjalë. Pra skema e kalimit nga emri në parafjalë për disa prej tyre është: emër → ndajfolje → parafjalë.

Ndajfolja ka shërbyer njëkohësisht edhe si bazë për krijimin e disa lidhëzave. Në këtë kategori kemi fjalë që, pa ndryshuar formën, përdoren edhe si ndajfolje edhe si lidhëza. Këtu mund të përmendim: *kur, ku, nga, si, qysh, prandaj, nga, sa* etj. Këto fjalë me origjinë përemërore përdoren si mjete lidhëse nëpër fjalitë e ndryshme të nënrenditura më shpesh sesa si ndajfolje. Përdorimi i tyre si ndajfolje të thjeshta është i kufizuar vetëm nëpër fjalitë pyetëse të drejta e të zhdrejta. Nëpër fjalitë pyetëse të zhdrejta mungesa e lidhëzës së vërtetë nuk ia ndryshon kategorinë ndajfoljesh si të tillë vetëm se i vesh asaj një funksion të dytë, atë të mjetit lidhës.

Dallojmë gjithashtu edhe një grup tjetër fjalësh që përdoren sot vetëm si lidhëza. Si të tilla shërbejnë fjalët: *parase, pasi, mbasi, qëkurse, kurdoqë, kudoqë, ngadoqë*, etj. Te këto fjalë që kryejnë vetëm funksione lidhëzore elementi i parë është një ndajfolje e cila është ngjitur me elementin e dytë, që në vetëvete, në gjendjen e sotme të gjuhës, mund të shërbejë, qoftë thjesht si lidhëz, p.sh. *që, se*, qoftë si ndajfolje *si, kur, kurdo, kudo, ngado*.

### Formimi i ndajfoljeve

Në vazhden e zhvillimit të gjuhës rrugët dhe mënyrat e formimit të ndajfoljeve, ashtu si dhe për pjesët e tjera të ligjeratës, kanë qenë të ndryshme. Nuk janë të rralla rastet e kalimit të pjesëve të ndryshme të ligjeratës tek njëra-tjetra. Rrugët e kalimit të tyre janë të ndryshme.

Si ndajfolje të thjeshta paraqiten ato që nuk kanë ndonjë element të dallueshëm produktiv në sistemin fjalëformues të shqipes së sotme. Përsa i përket burimit të tyre ato mund të jenë me origjinë të ndryshme. Kemi kështu ndajfolje me origjinë përemërore. Përdorimi me një kuptim që i afrohet me ndajfoljet, lehtësoi kalimin përfundimtar të përemrave në këtë klasë. Ka gjithashtu mjaft ndajfolje që përputhen me trupin e mbiemrave përkatës. Ajo që i dallon ndajfoljet e këtij tipi nga mbiemrat, në pikëpamje formale, është fakti i mosshfaqjes së nyjes tek këto të fundit. Një grup më vete tek ndajfoljet e thjeshta përbëjnë disa emra të rasave të ndryshme, të cilët në përdorimin e përditshëm, në kontekste të ndryshme takohen herë si ndajfolje pa ndonjë mjet fjalëformuese e herë si rase përkatëse të emrit. Këta emra që hyjnë në këtë grup janë të kushtëzuar edhe nga ana semantike. Së fundi, hyjnë këtu edhe disa fjalë me origjinë foljore, të përdorura në formën e pjesores, që si dhe grupi i mëparshëm hasen në kontekste të ndryshme edhe si ndajfolje, edhe si pjesore, në mvarësi nga kuptimi me të cilin janë përdorur, po kështu edhe format e tipit *papandehur* etj.

*Ndajfoljet e thjeshta, rrugët e formimit të tyre  
Ndajfolje përemërore*

Natyrë e ndajfoljeve përemërore është mjaft e afërt me atë të përemrave. Kuptimi i tyre, si është vënë re edhe para nesh<sup>43</sup>, afroh shumë me atë të përemrave. Ato përdoren me një kuptim të pacaktuar, i cili bëhet i qartë në kontekst. Kjo shprehet edhe në faktin se shpesh të tilla fjalë shoqërohen në përdorim me ndajfolje të tjera që e përcaktojnë në mënyrë më të saktë rrethanën e ndodhjes së ngjarjes a të kryerjes së veprimit. Këto fjalë mund të saktësohen edhe me një emër të shoqëruar me parafjalë ose me një fjali të tërë që e kryen këtë funksion. Krahaso shembujt e mëposhtëm: «Ki mendjen, o djal' i Josifit, mos e merr *kështu* rrëmbyer, se ti akoma i ke dhëmbët me qumësht». (S. Andoni, Maleve, f. 76). «Kur u kthye, Rifatin e kishte zënë gjumi *ashtu* ndenjor, me kokën që i kolovitej pas murit e me një të gërhitur si ata që vuajnë nga nefezi. (A. Abdihoxha, Vjeshtë, f. 70). «E shponin si tryela ndë zembër gozhdat e Gjatollinjve që shkonin aty mb'udhë, ...» (M. Kuteli, Netë, f. 31). «Mirë e ke ti momë, por ja që Lumtën e kam *këtu*, — dhe i ra zemrës me pëllëmbë.» (A. Abdihoxha, Vjeshtë, f. 34).

Këto fjalë, pra, ashtu si përemrat, zënë vendin e fjalëve a të grupeve të fjalëve që shprehin ato vetë rrethana, në kuptimin e gjerë të fjalës.

Ashtu si dhe përemrat, ndajfoljet përemërore mund t'i ndajmë sipas kuptimit dhe funksionit që kryejnë në:

1. Ndajfolje përemërore treguese a dëftore: *aty, këtu, ashtu, kështu, atje, tej, andej, atej, këtej, këndej, përtej*, që afrojnë në përdorim me përemrat dëftorë.

2. Ndajfolje përemërore pyetëse: *nga, kah, ku, kur, përse, pse, qysh*, si që afrojnë në përdorim me përemrat pyetës.

3. Ndajfolje përemërore sasiore: *aq, kaq, pak, shumë, ca*. Këto ndajfolje sot gjenden edhe në funksion përemëror a mbiemëror edhe në funksion ndajfoljor. Kur përdoren si ndajfolje ato dallohen nga përdorja e tyre në funksion përemri a mbiemri. Funksioni i tyre i vetëm si ndajfolje është që të shprehin intensitetin e veprimit në një shkallë më të lartë a më të ulët. Përveç kësaj, të gjitha këto fjalë përdoren edhe si mjete shprehëse të kategorisë së shkallës.

Përsa i përket strukturës, ndajfoljet përemërore janë të natyrave të ndryshme. Hyjnë këtu, së pari, fjalë që nuk kanë asnjë tregues formal që lidhet me ndajfoljet. Të tilla janë: *ku, kur, qysh, si, mjaft, pak, shumë, ca*.

Një grup më vete formojnë fjalët ku shquhet një element deiktik që është i dallueshëm etimologjikisht, si: *aty, këtu, atje, atej, këtej, andej, ashtu, kështu, aq, kaq*. Ashtu siç është vënë re nga prof. E. Çabej<sup>44</sup>, tek këto fjalë dallohen «elementet e njohura deiktike» «a» dhe «kë» si dhe rrënja e tyre. Në këtë mes vjen në konsideratë edhe një shënim tjetër i prof. Çabejt, «Disa lidhje si *sa për ashtu* «sa për atë gjë» duket të dëshmojnë vërtet se kemi të bëjmë me një përemër dëftor

43) Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 267.

44) E. Çabej, «BUSH. SSSH.» Nr. 4, 1960, f. 29.

që u bë ndajfolje»<sup>45</sup>. A. Xhuvani tek ndajfoljet përemërore ka shtënë edhe fjalët: *sot e sonte*<sup>46</sup>.

Së fundi, dallojmë edhe disa fjalë, struktura e të cilave nuk përkon me të parat. Këtu hyjnë: *përse, pse, përtej, prandaj, tutje* etj. Në përbërjen e fjalëve të para dallohet elementi *për*, si në formën e tij të plotë ashtu edhe në formën e tij të reduktuar; ndërsa te fjala e fundit vihet re «një kompozitë e vjetër e gjuhës shqipe» ashtu siç mendon prof. Çabej<sup>47</sup>, e përbërë nga elementet *tu-tje*; «*tu*- primitivi i *këtu*...», e *-tje* primitivi i *atje*.» Po në këtë grup duhen futur edhe ndajfolje të tjera që për nga struktura afrohen me të mësipërmet, kështu te ndajfolja: *pranë* në dallojmë si dhe në rastin e parë elementin *për*-. Këtu hyjnë edhe ndajfoljet *sot e sonte* që, nga pikëpamja e shqipes së sotme nuk mund të trajtohen ndryshe veç si fjalë të thjeshta. Në origjinë ato janë përngjitur të formuara nga një gjymtyrë përemërore dhe një gjymtyrë emërore. Format e ndryshme rasore të përemërave dalin jo rrallë si element i parë ose i dytë i një fjale të përbërë ose të përngjitur.

#### *Ndajfolje nga rasat e ndryshme të emrave.*

Në grupin e ndajfoljeve pa ndonjë formant karakteristik hyjnë, si e thamë, edhe disa forma rasore emrash. Në literaturën gjuhësore qëndrimet kanë qenë jo gjithherë të njëjta në lidhje me disa prej tyre. Brenda këtij grupi dallohen ato fjalë, karakterin ndajfoljor të të cilave nuk e vë njeri në dyshim. Këtu hyjnë fjalët: *jare, heret, krejt, mot, motit, vjet* e ndonjë tjetër. Tri të parat përdoren pothuajse vetëm si ndajfolje. Në cilësinë e tyre si të tilla ato janë diferencuar nga emrat *farë, herë, krye* etj., si kuptimisht edhe formalisht. Nga njëra anë ato kanë humbur krejt kuptimin e tyre të parë, ndërsa nga ana tjetër ato përdoren tashmë vetëm si forma të ngurosura rasore të cilat kanë humbur aftësinë fjalëndryshuese që karakterizon klasën prej nga kanë dalë. Në këtë kategori mund të shtinin edhe fjalët *rreth, rrotull, përdorjen* e të cilave edhe si ndajfolje nuk e mohan kush.

Për fjalët e tipit: *ditën, natën, dimrit, verës, rrugës, fushës, malit, anës* etj. janë mbajtur qëndrime të ndryshme. Shumica e gramatika-nëve vendës të tilla fjalë i pranojnë si ndajfolje. S. Frashëri<sup>48</sup> shënon si ndajfolje kohe fjalët *ditënë, natënë*. I. D. Sheperi, megjithëse në formën e një shënimi pranon edhe ai që «si ndajfolje përdoren edhe a) rrasa emrash: shkoj *udhës*»<sup>49</sup>. Ai nuk shprehet hapur në lidhje me fjalët e tipit *ditën, natën*. O. Myderrizi<sup>50</sup> përmend tek tipet e ndryshme të ndajfoljeve sipas strukturës, edhe fjalët: *fushës, kodrash, natën, ditën*,

45) Po ai. *po aty*. f. 29.

46) A. Xhuvani, *art. cit.*, f. 193. Fjalët *sot e sonte* «i kanë quejtë ndajfolje përemërore (adverbia pronominalia), pse dalin nga rranja përemnash indoeuropian...». Është e vërtetë se njërin element të këtyre fjalëve e përbën një rrënjë përemërore, po ky fakt nuk duhet të na bëjë që të tilla fjalë si *sot e sonte* t'i grupojmë në një vend me fjalët e sipërme. Natyra e formimit të tyre është e ndryshme nga ajo e të parave.

47) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* XXI, në SF, 2, 1966, f. 94.

48) S. Frashëri, *vep. cit.*, f. 130.

49) I. D. Sheperi, *vep. cit.*, f. 122.

50) O. Myderrizi, *vep. cit.*, f. 272.

të *djelën*, që shërbejnë si ndajfolje vendi a kohe. Edhe K. Cipoja<sup>51</sup> të tilla fjalë i rreshton si ndajfolje kohe a vendi. A. Xhuvani<sup>52</sup> e zgjeron shumë këtë tip. Së fundi, edhe Fjalori i Gjuhës Shqipe<sup>53</sup> fjalët *ditën*, *natën* i shënon si ndajfolje. Një mendim të kundërt me autorët e mësipërm kanë prof. M. Domi dhe Sh. Demiraj. M. Domi<sup>54</sup> mendon se si plotës vendi mund të jetë: «2) një emër e ndonjëherë edhe një mbiemër i rasës rrjedhore pa parafjalë: Luaj *vendit*. Eca *hijes*, Mos rri *rrugëve*»; dhe më poshtë: «Plotësi i kohës mund të jetë: a) një emër i rasës kallzore të shquar, vetëm. *Vitin* e kaluar.; b) një emër i rasës rrjedhore të shquar e të pashquar: *Verës* unë mbaj çorape pambuku, *Një vit* kam qenë në Dardhë.» Përsa i përket shprehjes së plotësit të kohës, shembulli i sjellë aty për rasën kallzore të shquar nuk është përfaqësues i tipit të fjalëve *natën*, *ditën*. Emrin *vit*, në formën e kallzores *vitin*, vështirë se mund ta gjejmë të përdorur të pashoqëruar me një përcaktor. i çfarëdolloji qoftë ky. Edhe për Sh. Demirajn<sup>55</sup> fjalët: *ditën*, *natën*, *verës*, *dimrit* etj. si dhe *rrugës*, *anës*, *rrzës* etj. «është më e arësyeshme që të mos merren si ndajfolje kohe a vendi, sepse ato nuk përdoren me ndonjë kuptim të ngushtuar ose të zgjeruar (*si vjet*, *mot* dhe *motit*) dhe, nga ana tjetër, mund të përcaktohen edhe me fjalë të tjera, që luajnë rolin e një cilësori, të një ndajshtimi a të një plotësi tjetër, kurse ndajfoljet nuk marrin pas tyre ndonjë cilësor ose plotës tjetër. Veç kësaj para emrave të këtij tipi, ashtu si para gjithë emrave të tjerë mund të vihen edhe parafjalë.»

Për përdorimin e këtyre fjalëve si ndajfolje a si emra, duhet pasur gjithmonë parasysh konteksti. Vetëm në kontekstin e dhënë mund të gjykohet për karakterin e tyre. Nga ana semantike, ato fjalë që përdoren në këtë funksion janë të kufizuara. Kryesisht në këtë funksion përdoren fjalë që shprehin fragmente kohe ose dhe ato që tregojnë vend në një mënyrë jo plotësisht të përcaktuar. Në të mirë të mendimit që fjalët *ditën*, *natën* të trajtohen si ndajfolje flet edhe fakti se, megjithëse janë në formën e rasës kallzore, ato përdoren me folje të tipeve të ndryshme kuptimore, ndër të tjera edhe me ato folje që shprehin lëvizje, pas të cilave nuk përdoret kurrë një emër në rasën kallzore pa parafjalë, e cila siç dihet ndërton zakonisht kundrinën e drejtë. Kështu ato gjinden shpesh pranë foljeve të tilla si: *dal*, *shkoj*, *vij*, *ec*, *nisem*, *iki*, *kthehem* etj. Përsa i përket përdorimit të tyre me parafjalë shembujt e sjellë nuk e ilustrjnë mendimin e autorit. Në vargjet e Çajupit fjalët *ditënë*, *natënë* nuk mund të shoqërohen me parafjalë: *Ditënë* mendohem / *natënë* rri pa gjumë.

Në shumicën dërrmuese të rasteve këta emra me funksion ndajfoljor përdoren pa parafjalë. Parafjala është e mundshme tek ato në rastet kur fjalë të tilla marrin ndonjë përcaktor. Këto raste ne do t'i trajtojmë si kalimtare që po priren nga ndajfoljet, po pa mundur të kalojnë plotësisht te këto të fundit. Më lehtë mund të shoqërohen me parafjalë rrjedhoret e tipit: *verës*, *dimrit*, *vjeshtës*, *udhës*, *anës* etj. Ajo që do të përdorej më tepër në të tilla raste është parafjala *gjatë*. Megjithatë materiali i gjurmuar tregon edhe për këto fjalë se në shumicë

51) K. Cipo, *vep. cit.*, f. 180.

52) A. Xhuvani, *art. cit.*, f. 194.

53) *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, Bot. i Inst. Shk. T. 1954, f. 87 dhe 332.

54) M. Domi, *vep. cit.*, f. 87 e 91.

55) Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 260 v.

cën dërrmuese mbizotërojnë rastet pa parafjalë. A. Xhuvani ka shprehur mendimin që «rasët e disa emrave kanë marrë vlerë ndajfoljore». Këtu duhet shënuar, së pari, se rasat mund të shprehin disa kuptime dhe njëri ndër to tregohet i aftë për t'u ndajfoljësuar. Sikundër e thamë edhe më lart, emrat që e kanë këtë aftësi janë kryesisht të asaj kategorie që shprehin fragmente kohore dhe hapësinore dhe, kur përdoren si ndajfolje, kuptimi i tyre i parë zbehet, duke bërë që ne të mos e mendojmë më sendin e nocionin por kohën e hapësirën që shpreh e njëjta fjalë.

Tri janë rasat kryesore që kanë shërbyer si bazë për ndajfoljëzimin e emrave: rasa emërore, kallëzore dhe rrjedhore.

Më prodhimitare në rasat e përmendura, si burim për ndajfoljet janë rasa kallëzore e rrjedhore. Rastet e kalimit të emrave në ndajfolje nga rasa emërore janë mjaft të rralla dhe të një përdorimi të veçantë që shpeshherë marrin vlerë stilistikore. Emrat e rasës kallëzore që marrin vlerë ndajfoljore, janë kryesisht në trajtë të shquar. Të tilla janë p.sh. *ditën, natën, si dhe të nesërmen, të pasnesërmen* etj.

« — Mirë, *ditën*, del për antike, po *natën* ç'kërkon këtej, t'i ruash nga rosat e egra, mos t'i gëlltisnin? . . . » (J. Xoxa, Lumi, II, f. 20). «Do shikonin se bashku dhe do t'i jepnin dorën e fundit një shkrimi të saj, që do të botohej të *nesërmen* a të *pasnesërmen*.» (Sh. Musaraj, Para, I, 43).

Emrat që marrin vlerë ndajfoljore mund të jenë edhe në rasën kallëzore të pashquar. Të tillë janë: *një herë, një ditë, një natë, një mbremje, një mëngjez, një kohë* etj. «*Një ditë*, në muhabet e sipër, farmacisti i kishte folur Hasanit për Sul Qenanin. . . » (V. Kokona, Me valët, I, f. 23). «*Një herë një mëngjez*, nuk mbaj mend mirë që e dje-lë apo ditë e shënuar, Sofa vjehra ime e gjyshja jote, po bëhej gati të shkonte. . . » (J. Xoxa, Lumi, I, f. 250). «Vetëm rrugët e gjëra e të drejta, të shtruara me kalldrëm, e kanë ruajtur gjer më ditët tona, formën dhe bukurinë që kanë pasur *një kohë*.» (N. Prifti, Çezma, f. 3).

Siç shihet, në formën e rasës kallëzore të pashquar emrat që marrin vlerë ndajfoljore janë të shoqëruar, pothuaj gjithnjë me nyjen joshquese *një*. Dhe nga ana kuptimore ato shprehin marrëdhënje kohore në mënyrë të pacaktuar. Kemi ndeshur vetëm një rast të përdorur në formën e kallëzores së pashquar të pashoqëruar me këtë nyjë. «Po pse kjo udhë, baba, unë kam bërë mend të nisem që *mëngjez* për rosa? . . . » (J. Xoxa, Lumi, I, f. 213). «*Mëngjez* herët dolla jashtë këmbëzbathur e fillova t'u kapardisem versnikëve». (S. Andoni, Maleve, f. 37). «E gjeti në oborr kur Peti po lante sytë *mëngjez* herët.» (F. Gjata, Në pragun, 25).

Siç shihet, në këtë rast ndihet mjaft mungesa e parafjalës, prandaj mendojmë se ky është një përdorim i gabuar dhe në vend të tij do të rekomandonim ndërtimin me parafjalë.

Emrat e rasës kallëzore, që ndajfoljëzohen, nga ana kuptimore shprehin vetëm marrëdhënje kohore.

Rasa rrjedhore është treguar shumë produktive dhe ndoshta më produktivja si bazë për ndajfoljëzimin e emrave. Edhe emrat në formën e rasës rrjedhore, që përdoren si ndajfolje mund të jenë të trajtës së shquar ose të pashquar. Kështu ndajfoljet: *dimrit, verës, vjeshtës, udhës, rrugës, sokakut, malit, fushës, zallit, sheshit* etj. rrjedhin nga format përkatëse të emrave në rasën rrjedhore të shquar. «Ma ka ba zoti nafakë: / *Verës* n'bjeshkë, *dimnit* n'çardak». (Këngë lirike, f. 104).

«Fluturojnë ndër male, fluturojnë ndër lule, / Fluturojnë ku çerdhen motit e ngule,» (N. Mjeda, Vjersha, f. 41). «Buzua lëshoi vetullat, vari hundën, si i penduar, po dukej sheshit se brenda përbrenda qeshte.» (M. Kuteli, Në një cep të Ilirisë së poshtme, rev. Nëndori, 6, 1965, f. 63). «Në ma prufshi trimin malit, / Hjek e u nap florit e ballit. Në ma prufshi trimin fushës, / Hjek e u nap florit e gushës.» (Këngë lirike, f. 195).

Ndajfoljet *një viti, një moti, një mëngjezi, një vere, një dite, një nate* etj. janë format përkatëse të emrave në rasën rrjedhore të pashquar. «Vjet kemi patur lugat të fortë Shaqon e Shabanit, *një viti* një tjetër që u bë dhe kanxhallos edhe simvjet Meron e Cutes.» (M. Kuteli, Netë, f. 133). «*Një vere* vajta nga Pogradeci në Elbasan për punë». (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, f. 160).

Rasa rrjedhore, ndryshe nga kallëzorja, në format e saj të shumësit shërben si bazë për disa formime që për ne janë në gjendje kalimtare, në rrugën e kapërcimit të tyre në ndajfolje. Arësyeja që ne i shohim këto raste si gjendje kalimtare është fakti që, megjithëse këto forma shprehin rrethana vendore e kohore, folësi ka parasysh me to pikërisht sendin e nocionin që shprehin ato. Të tilla janë për ne fjalët: *maleve, rrugëve, burimeve, krojeve, udhëve, brigjeve, fshatrave, rrëzave, kodrave, brinjave, hijeve, bjeshkëve, shesheve* etj. Në mes të këtyre fjalëve ka të tilla që përdoren me një kuptim më të gjerë se sa ai i zakonshmi dhe që janë më afër ndajfoljeve, si p.sh., *maleve, rrugëve, udhëve, rrëzave, hijeve* e ndonjë tjetër. Megjithkëtë s'mungon edhe ndonjë rast kur një emër i rrjedhores shumë të ketë kaluar plotësisht në ndajfolje. Krahaso shembullin e mëposhtëm: «...Kati i sipërm ku ngjiteshe me anë shkallësh të jashtme, ish rrethuar në tërë pjesën e përparme dhe *anash* nga një hajat i ngushtë në formë ballkoni me këmbë të drunjta.» (Sh. Musaraj, Para I, 248).

A. Xhuvani<sup>56</sup> i zgjeron shumë format e rrjedhores që përdoren në funksione ndajfoljore duke shtënë këtu edhe raste të tilla si (më duel) *hundëshit, lodhem kambësh, krihem flokësh, lahem shtetsh*.

Ndryshe nga ndajfoljet që vijnë nga kallëzorja, ato që dalin nga rrjedhorja janë treguar të afta për të shprehur disa kuptime. Kjo lidhet me vetë kuptimet e shumta që ka rrjedhorja. Ndajfoljet e këtij tipi shprehin: rrethana vendore si: *anës, udhës, rrugës, malit, fushës, hijes, anash* etj.; rrethana kohore si: *dimrit, verës, vjeshtës, motit, një viti, një moti, një vere, një dite, një nate* etj. dhe më rrallë përcaktojnë veprimin foljor në cilësi si: *sheshit*.

Një grup më vete përbëjnë disa emra, që vetëm në kontekste të caktuara përdoren si ndajfolje. Këto kanë kryesisht formën e rasës emërore të pashquar e ndonjë prej tyre mund të kuptohet edhe si formë e rasës kallëzore. Në të tilla raste mund të flitet për ndajfoljëzim kontekstual<sup>57</sup>. Kalimi në ndajfolje këtu bëhet nëpërmjet një krahasimi. Hyjnë këtu fjalë si: *lamsh, grumbull, fluturim, gardh, vrap, shesh, rrafsh* etj. «Po një meritë të madhe këtu kanë edhe kuadrat tona, kini dhe ju, shokë, që tok me partinë e popullin, qëndruat *grusht* dhe të patundur, kurdoherë në krye të detyrave tuaja...» (E. Hoxha, Fjala me inteligjencën, 49). «Në mos ia tha *copë*, ja solli rreth e rrotull...» (S. Çomora, Syleshi, f. 61). «Roja sa ma e madhe t'jenë aq ma e dobishme,

56) A. Xhuvani, *art. cit.*, f. 194.

57) A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në BUSHT.SSHSH III, 1962, f. 43.

m'ket farë kohet që jena t'mshilun *gardh* prejë anmikut!» (N. Nikaj, *Burbuqja*, f. 7).

Si përfundim, mund të thuhet se për të gjitha rastet e ndajfoljësimit të emrave forma e tyre lot rol kryesor po nuk është gjithshka në karakterizimin e tyre si ndajfolje a si emra. Një rol të rëndësishëm në përcaktimin e fjalëve të tilla si ndajfolje luan kuptimi dhe funksioni i tyre sintaksor. Sidoqoftë, ajo që s'duhet harruar në këtë mes dhe që do mbajtur parasysh gjithmonë e për çdo rast është konteksti, i cili këtu luan një rol jo të vogël, sepse për raste të veçanta mund të gjykohet vetëm në kontekstin e dhënë.

### *Ndajfolje nga mbiemrat.*

Gjenden tek ndajfoljet një grup fjalësh që ndryshojnë nga mbiemrat, përse i përket formës, kryesisht vetëm nga prania e nyjes të këta të fundit. Edhe për këtë tip ndajfoljesh qëndrimet, përse i takon origjinës së tyre, kanë qenë të ndryshme. S. Frashëri<sup>58</sup>, I. D. Sheperi<sup>59</sup> dhe O. Myderrizi<sup>60</sup> pranojnë në këtë mes mendimin që ndajfoljet kanë shërbyer si pikënisje për krijimin e mbiemrave, me fjalë të tjera. I shohim ndajfoljet si parësore ndaj formave të njëjta mbiemërore. Të mendimit të kundërt janë A. Xhuvani<sup>61</sup> e Sh. Demiraj<sup>62</sup> të cilët shohin, përkundrazi, mbiemrat si forma parësore pranë ndajfoljeve si forma dytësore. A. Xhuvani jep edhe arësyet që e shtojnë drejt një qëndrimi të tillë. Ndërkaq s'na duket se sjellin gjë në këtë drejtim faktet «që një kategori e madhe ndajfoljesh të greqishtes së vjetër e të latinishtes dalin nga mbiemrat me anë të prapashtesës *os* (ὄς) për greqishten, si kalos, agnos etj. dhe të prapashtesës *-ter* për latinishten, si *prudenter*, *sapienter* etj. Gjithashtu edhe në gjuhët frëngjishte e italishte një numër i madh ndajfoljesh rrjedhin nga mbiemrat me anë të prapashtesave *-ment* (fr.) e *-mente* (it.) si *pleinement*, *rapidement* (fr.), *pienamente*, *certamente* (it.)». Këto fakte nuk shtojnë gjë në këtë mes, se tipe të tilla ndajfoljesh nuk janë të njëjta me tipin në shqyrtim. Afëri të tilla vihen re me tipe të tjera të ndajfoljeve të shqipes të formuara me prapashtesa.

Argumenti tjetër i A. Xhuvanit se «Një provë tjetër që ndajfoljet në shqipet dalin nga mbiemrat asht edhe puna se prej disa mbiemrash nuk mund të dalin ndajfolje; *p.sh.* nga mbiemrat *i, e, të madh, i, e, të vogël, i, e të vorfën* etj. gjuha nuk ka formue ndajfolje, ...» nuk sjell gjithashtu gjë në këtë drejtim. Nuk është e domosdoshme që nga çdo mbiemër të lindë pa tjetër një ndajfolje. Atë mundësi cilësimi që kanë këta mbiemra gjuha e plotëson qoftë me ndajfolje të tjera të thjeshta qoftë me ndajfolje të prejardhura e me lokucione ndajfoljore. Nga ana tjetër, duhet thënë se ka gjithashtu ndajfolje që nuk kanë mbiemra korespondues, të cilët formalisht të jenë të dallueshëm nga ndajfoljet vetëm nëpërmjet nyjes, ose që të përdoren qoftë edhe si të panyjshëm. Hyjnë këtu fjalët: *brenda, dje, nesër, jashtë, mbrëmë, tashti, sot* etj.

Në formimet e mëvonshme vihet re se si temë prodhuese mund

58) S. Frashëri, *vep. cit.*, f. 37.

59) I. D. Sheperi, *vep. cit.*, f. 137.

60) O. Myderrizi, *vep. cit.*, f. 73.

61) A. Xhuvani, *vep. cit.*, f. 195.

62) Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 266.

të jetë si mbiemri për ndajfoljen ashtu edhe ndajfolja për mbiemrin, megjithëse kjo e fundit në raste më të rralla.

Në tekstin «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe», hartuar nga Sh. Demiraj vihet re një farë kontradikte në këtë pikë. Nuk kuptohet përse autori, të tilla fjalë si: *mirë, keq, i ka* quajtur «fjalë të para» (f. 262) dhe më poshtë (f. 266) i rendit ato tek ndajfoljet e formuara nga mbiemrat. Termi që mund të përdorej këtu do të ishte «ndajfolje jo të mirëfillta». Ne, sikundër jemi shprehur edhe më lart, bashkohemi me këtë mendim të dytë që i pranon format mbiemërore si të para. Në atë periudhë të hershme, kur në gjuhën shqipe nuk ekzistonte nyja, kanë bashkëjetuar sigurisht format paralele mbiemër-ndajfolje, dallimi në mes të të cilave kryhej ndoshta vetëm nga funksioni. Në këtë mes vjen në konsideratë mendimi i prof. Çabejt që «Arësyeu pse artikulli prepozitiv del te mbiemri e mungon m'anë tjetër te adverb, unë e gjej në rrethanën që mbiemri vinte pas emrit që ish i pajisur me artikullin postpozitiv, kurse adverb i pas verbit, që s'ka artikull»<sup>63</sup>.

Tek ndajfoljet e thjeshta mbiemërore që nga pikëpamja e sotme nuk i nënshtrohen asnjë analize hyjnë fjalë të tilla si: *mirë, keq, bukur, angësht ashpër, butë, dëlirë, drejt, ëmbël, thellë, thjesht, fort, gjallë, gjatë, gjërë, idhët, qartë, kot, kthjellët, lart, lehtë, lirë, mbarë, ngathët, imët, ngushtë, pastër, plogët, qetë, rëndë, rrallë, rreptë, urtë, trashë, turbull, shtrenjt, shëndoshë, shkathët, shkretë, shpejt, vrazhdë, vranët, vrerët, zi, e ndonjë tjetër. Shumica e këtyre fjalëve, sikundër e thamë, përputhen formalisht me mbiemrat, me ndryshimin e vetëm që ndajfoljet nuk kanë nyjen. Megjithatë, ka në mes të tyre edhe të tilla që ndryshojnë nga mbiemrat dhe përta i përket gjatësisë së zanores së theksuar<sup>64</sup>.*

Ndryshe nga mbiemrat, të cilët në gjendjen e sotme kanë një zanore të gjatë, disa ndajfolje, që përputhen me trupin e mbiemrave përkatës, kanë përkundrazi një zanore të shkurtër. Të tilla janë: *i drejtë: drejt; i fortë: fort; i kotë: kōt; i lartë: lart; i plōtë, plot; i shtrenjtë: shtrenjt; i shpëjtë: shpejt; i shkurtë: shkurt* etj. Ato shkruhen sot edhe pa ë në fund, gjë që shënon gjithashtu një dallim tjetër në formë midis tyre dhe mbiemrave.

Rasa rrjedhore ka shërbyer si bazë edhe për ndajfoljzimin e disa mbiemrave të substantivuar në formën e tyre të gjinisë asnjane. Të tilla janë ndajfoljet: *së mbari, së qeti, së gjëri, së gjati, së thelli*, si dhe mjaft të tjera të shoqëruara me parafjalë të ndryshme.

Por mbiemrat përdoren si ndajfolje edhe në formën e tyre me nyje. Një veçori karakteristike është këtu, së pari, se përdoren si ndajfolje kryesisht mbiemrat *i madh, i vogël*, në formën e kallëzores të *madhe, të vogël*; së dyti, këto mbiemra shoqërohen vetëm me foljet që lidhen me zërin, të tilla si: *them, përgjigjem, bërtas, flas, kollitem*. Duhet theksuar se kemi të bëjmë këtu me një përdorim me përhapje që i takon vetëm gegërishtes dhe më ngushtësisht gegërishtes veriore. Sipas një kumtimi gojor të të ndjerit A. Krajni, përdorime të tilla janë të shpeshta edhe në gojën e popullit. «Porsa hini, gjet shtatë roje kah flëjn e kah gërhasin të madhe.» (Prralla kombtare, II, 90). «O Col Gurka,

63) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, në BUSHT. SSSHSH., 3, 1963, f. 82.

64) W. Cimochoowski, *Le dialecte de Dushmani (Description de l'un des parlers de l'Albanie du Nord)*, Poznan, 1951, f. 104.

a je çue?» *t'madhe* Pali po i lshon za.» (S. Gera, Lugina e qetë, 40). «Po shka asht ai send i zi aty ngjat teje? pvetë dhelpra. Harusha i thotë katundarit të *vogël*: Thuej «cung, cung» (Prralla kombtare, I, 130).

### Ndajfolje nga foljet

Në grupin e ndajfoljeve të paanalizueshme për gjendjen e sotme hyjnë edhe disa forma foljore që dalin kryesisht nga pjesorja e më rrallë nga forma e pashtjellë mohore *pa + pjesore*. Vihen re raste të rralla ndajfoljézimi edhe të formave të mënyrës urdhërore, po kryesisht me vlerë stilistike dhe në formën e një lokucioni si *shkel e shko, çel e mbyll* etj. Edhe këto raste duhen trajtuar sipas nesh, si ndajfoljézime kontekstuale. Është për t'u vënë re fakti se A. Xhuvani në artikullin e tij<sup>65</sup>, që i kushtohet pikërisht këtij kapitulli të rëndësishëm të ndajfoljeve, e ku për më tepër ai merret kryesisht me ndajfoljet e mënyrës, ndryshe nga autorët e mëparshëm, nuk i përshkruan ndajfoljet që dalin nga foljet. Edhe K. Cipo në gramatikën e tij përmend në këtë grup vetëm «participet e vjetra mbë (-t): ftohtë, idhët, ngordhët, hapët, thatë etj.»<sup>66</sup>, të cilat në gjuhën e sotme nuk i gjen gjëkund si pjesore.

Kemi përshtypjen se sot po zgjerohet rrethi i pjesoreve që përdoren edhe si ndajfolje, kështuqë për ne nuk është shumë i saktë pohimi: «Në gjuhën shqipe ka edhe një numër të kufizuar ndajfoljesh të formuara nga forma të pashtjelluara të foljevet, kryesisht nga pjesoret<sup>67</sup>. Zbehja kuptimore dhe përdorja pranë foljes kanë bërë të mundshëm kalimin e këtyre pjesoreve në ndajfolje, dhe është pikërisht përdorimi në funksion kallëzuesori që lehtëson këtë kapërcim. Këtu po përmendim: *shpenguar, mbytur, zgjeshur, trembur, pështetur, nxituar, përtuar, hapur, shkoqur, prerë, fshehur, shtruar, rrëmbyer, shtrirë, shtrënguar, shëmtuar*, (seç jam goditur *shëmtuar*: populli), *mbathur, zbathur, veshur, xhveshur, zgjuar, ndenjtur* (u ul ndenjtur), *rënë, menduar* etj.

Janë ndajfoljézuar më rrallë edhe format e pashtjella mohore të tipit: *pa + pjesore*. Mund të sillnim këtu si shembuj: *papritur, papandehur, papushuar, padashur* etj. Është interesant fakti që të tilla folje të përdorura si ndajfolje, gjenden shpesh të shkruara së bashku: *padashur, papritur, papandehur*, gjë që tregon se ato po ndjehen gjithnjë e më tepër si ndajfolje. Përveç kësaj disa prej tyre mund të marrin sidomos nëpër dialekte edhe prapashtesa që janë karakteristike për ndajfoljet si: *papritmas, papandehurazi, padashurazi*. Përdoren në funksion ndajfoljor edhe pjesoret e vjetra që mbaronin dikur me *-të*, si: *ftohtë, ngrohtë, ratë, nxehtë*, etj.

### Ndajfolje të prejardhura e njetet e formimit të tyre.

Struktura morfologjike e ndajfoljeve tregon se ato janë pasuruar e po pasurohen vazhdimisht nga pjesë të tjera të ligjeratës me mënyra të ndryshme. Në këtë mes, ne besojmë se vendin kryesor e zë mënyra

65) A. Xhuvani, *vep., cit.*

66) K. Cipo, *vep., cit.*, f. 181.

67) Sh. Demiraj, *vep., cit.*, f. 267.

e formimit me prapashtesë. Prapashtesat që shërbejnë për të formuar ndajfolje nuk janë të shumta në numër, por kanë formuar përkundrazi mjaft ndajfolje, duke qenë shumë të afta për t'iu ngjitur temave të pjesëve nga më të ndryshmet të ligjeratës.

Në mënyrën e sufiksimit vihet re një dallim i rëndësishëm në mes të ndajfoljeve cilësore dhe rrethanore. Ndërsa tek ndajfoljet cilësore formimi me prapashtesa ka një përhapje relativisht të gjerë, ai mund të thuhet se mungon tek ndajfoljet e rrethanës, të cilat formohen ndër të tjera, kryesisht me ndajfoljëzimin e formave të ndryshme të fjalëve; po kjo mënyrë formimi nuk mungon edhe tek ndajfoljet e cilësisë.

Prapashtesat që formojnë ndajfolje duke iu prapangjitur temave të ndryshme janë: *-(i)sht*, *-as(-az, -azë, -azi, -aza)*, *-thi*, *e-çë* duke u dalluar këtu si më produktive *-(i)sht*, *-as/ -azi*, *e-thi*.

Prapashtesa *-(i)sht* formon ndajfolje duke iu prapangjitur temave emërore, të cilat mund të jenë fjalë të prejardhura me prapashtesa të ndryshme ose edhe fjalë të para. Ajo u ngjitet gjithashtu dhe temave mbiemërore. Prapashtesa *-(i)sht*, me sa duket, nuk ka qenë shumë produktive në gjuhën shqipe. Produktiviteti i saj ka ardhur gjithnjë duke u rritur, për vetë faktin se e gjejmë atë edhe në tema të tilla që nuk ekzistojnë të shkëputura nga prapashtesa. Denduria e përdorimit të modelit është aq e madhe sa bën që ajo të bashkohet edhe me tema të tilla. Kështu prapashtesa *-(i)sht* formon ndajfolje. 1 — Nga emrat femërorë që janë formuar me prapashtesat *-i*, *-(ë)ni*, *-(ë)ri*, ose që kanë si zanore fundore tingullin *-i*, duke dalë kështu prapashtesa në trajtën e saj origjinale *-sht*<sup>68</sup>. Të tilla janë ndajfoljet: *njerëzisht*, *mrekullisht*, *sigurisht*, *lirisht*, *dhembshurisht*, *dashunisht*, *vllaznisht*, *burrnisht* e *burrërisht*, *trimërisht*, *vorfënisht* e *varfërisht*, *besnikërisht*. Fjala që është bërë ndajfolje duke marrë këtë prapashtesë mund të jetë edhe një kompozitë ose një formim me prapashtesë si: *zemërmadhërisht*, *pagji-dhëshmërisht* etj. 2 — Nga emrat që janë formuar me prapashtesën *-(ë)si*: *hollësisht*, *thellësisht*, *miqësisht*, *ngushtësisht*, *lartësisht*, *qetësisht*. 3 — Nga tema mbiemërore si: *likisht*, *mbrapsht*, *mesatarisht*, *mjerisht*, *ideologjikisht*, *politikisht*, *vullnetarisht*, *verbërisht*, *zyrtarisht*, *atdhetarisht*, *seriozisht*, *instiktivisht*, *historikisht*, *ritmikisht*, *personalisht*, *horizontalisht*, *vertikalisht*, *ushtarakisht* etj. 4 — Nga emrat që janë formuar me prapashtesën *-im*: *vazhdimisht*, *shkurtimisht*, *shkëlqimisht*, *përfundimisht*, *gabimisht* etj. 5 — Nga temat e thjeshta emërore si: *zakonisht*, *(eksperimentalisht)*, *rregullisht*, *natyrisht* etj.

Në bazë të këtyre modeleve dhe si rezultat i fuqisë tërheqëse të tyre janë krijuar e po krijohen një numër i konsiderueshëm ndajfoljesh me këtë prapashtesë duke u nisur nga tema të tilla që, të shkëputura nga prapashtesa nuk ekzistojnë më vete. Prapashtesat *-(ë)si*, *-(ë)ri* janë treguar mjaft aktive në këtë drejtim. Janë formuar kështu një sërë ndajfoljesh që, megjithëse të ndërtuara mbi një temë, e cila nuk ekziston, përdoren mjaft sidomos në gjuhën e shkruar e më rrallë në gjuhën e folur. Të tilla janë: *plotësisht*, *rrënjësisht*, *përkohësisht*, *(gjithmbarësisht)*, *përjetësisht*, hyn këtu edhe *njëkohësisht* (nga *njëkohësi*), *bashka-*

68) Shih A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, T. 1962, f. 59.

risht, shpirtërisht, çuditërisht, shkencërisht, veçanërisht, botërisht, pikërisht etj.<sup>69</sup>

Kemi ndonjëherë edhe ndajfolje që janë formuar me prapashtesë kur ekziston në të njëjtën kohë edhe forma e thjeshtë. Në këto raste formimet me prapashtesë marrin shpesh vlerë stilistikore, gjë që bën të dallohen në përdorim me format e thjeshta. Të tilla janë: *shkurt* dhe *shkurtimisht*, *krejt* dhe *krejtësisht*, *nxehtë* dhe *nxehtësisht*, *rreptë* dhe *rreptësisht*, *thjesht* dhe *thjeshtësisht*, *urtë* dhe *urtësisht* etj., të cilat shpeshherë nuk mund t'i përdorësh njëzën për tjetrën në të njëjtin kontekst pa prishur deri në një farë mase kuptimin e frazës.

Një prapashtesë tjetër që formon ndajfolje është dhe prapashtesa *-as* që del edhe në variantet: *-az*, *-azë*, *-azi*, *-aza*. Prapashtesa *as* si dhe variantja e saj *-azi* u është ngjitur a) temave të thjeshta emërore: *barkas* e *barkazi*, *brinjazi*, *burras*, *fytas*, *gojas*, *cinglazi*, *dokrazi*, *gomarazi*, *gjërpazi* (nga *gjarpër*), *gjunjazi* e *gjunjas*, *ijas*, *kalas*, *kambas*, *kryqas*, *petas*, *pillakas*, *qafas*, *rradhaz* e *rradhazi*, *rrethas*, *shortas*, *grykas* etj. b) temave emërore jo të thjeshta: *rrokullimas*, *qëllimas*, *ngrykas* etj. c) temave mbiemërore të thjeshta ose jo: *afërmas*, *ëmbblas*, *anasjelltas*, *fshehtas* e *fshehtazi*, *çiltas*, *gjatas* e *gjatazi*, *gjërazi*, *haptas*, *lashtazi*, *mëngjeras*, *majtas*, *djathtas*, *përciptas*, *plogshas*, *qorras*, *zhdrejtazi* etj., ç) temave ndajfoljore: *keqas*, *kjartas*, *lartazi*, *lehtazi*, *miras*, *qetas*, *rallas*, *shkurtas* e *shkurtazi*, (*brendazi*), *drejtas*, *largas* e *largazi*, *përkundrazi*, *përparazi*, (*poshtazi*), (*prapazi*), *praptazi*, *prerazi*; *sheshazi*; *tërthorazi*, *veças*, *zvaras* e *zvarazi* etj. Në vështrim të parë të jepet përshtypja sikur prapashtesa në të tilla raste u është ngjitur temave të ndryshme mbiemërore, po ne mendojmë se këto ndajfolje e kanë marrë këtë prapashtesë pikërisht kur ato përdoren në funksion ndajfoljor. Ajo është bashkuar gjithashtu edhe me mbiemra asnjanes të substantivuar të përdorur si ndajfolje në formën e rasës rrjedhore si: *së fshehtazi* e *së fshehurazi*, *së qetazi* etj., d) disa tema foljore gjithashtu kanë marrë këtë prapashtesë. Kemi kështu ndajfoljet: *vjedhurazi*, *fshehurazi*, *damas*, *befas*, *deshtazi*, *deshtas*, *rrëshqitazi*, *heshtazi*, *padashas*, *papritmas*.

69) Në mes ndajfoljeve të këtij tipi gjenden edhe ndajfolje të krijuara nga autorë të veçantë në vite të ndryshme si: *prerërisht* (I.M. Qafëzezi, Histori, 10.), *korpënisht* (K. K. Kolosianët II, 9 Konst. 1872), *grabitsisht* (N. Nikaj, Histori, f. 33, Sh. 1917), *vetiasisht* (Lipi, Qytetnim, f. 42), *tokërisht* (Lipi, Fatbardhi, f. 99), *rregullarisht* (L. Gurakuqi, Vepra, f. 441), *politikërisht* (F. Noli, Histori, f. 8), *unjërisht*, F. Noli, Përkth. i Hamletit, f. 25), *përgjithërisht* (Po ai, po aty, f. 3), *paqërisht* (Po ai po aty, f. 191), *apsollutërisht* (Po ai po aty, f. 9), *plotërisht* (Po ai po aty, f. 5), *përfundërisht* (F. Noli, Histori, f. 10), *indirektërisht* (Ligjëron Fan Noli, mbl. L. Dilo, f. 70, v. 1944), *solemnërisht* (L. Poradeci), *lëndërisht*, *mëndërisht*, *trupërisht* (S. Luarasi, Fjala), të cilat mbeten krijime të veguara të gjuhës së shkrimit pa arritur të shtrihen gjerësisht në përdorim. Ndërtime të tilla nuk janë pa koresponduese në shqipen e sotme. Atyre u përgjigjen goftë formimet me prapashtesë të tjera ose pa të tilla goftë një tog fia ësh që merr kuptimin e ndajfoljes, kështu për *prerërisht* kemi *prerazi*, për *paqërisht*: në mënyrë paqësore. Janë përdorur ndonjëherë edhe dublete nga të cilët vetëm njëri ka mundur të gjejë përdorim duke mënjanuar tjetrin. Kështu *plotërisht* dhe *plotësisht*, *përfundërisht* dhe *përfundimisht*, *apsollutërisht* e *apsolutisht*, *solemnërisht* dhe *solemnisht* etj. Por togje të tilla fjalësh që u përgjigjen ndajfoljeve me *-(i)sht* përdoren në shqipe edhe për formime të ndërtuara në mënyrë të rregullit. Krahaso të tilla raste si: *miqësisht* dhe *në mënyrë miqësore*, *heroikisht* dhe *në mënyrë heroike*, *historikisht* dhe *nga pikëpamja historike* ose *nga ana historike* etj. Megjithatë ato mund të mos zëvendësojnë njëra-tjetrën në çdo kontekst. Shpesh herë ndajfoljet me formantin *-(i)sht* kanë marrë një vlerë pak a shumë të ndryshme nga togjet e fjalëve që u përgjigjen atyre. Krahaso p.sh. *rregullisht* dhe *në mënyrë të rregullt* etj.

*ngjitas, falas, shkaras, rrokas* etj. Në këtë kategori është grupuar edhe ndajfolja *rëshqanas*<sup>70</sup>. Prapashtesa *-as* këtu i është ngjitur pikërisht temës ndajfoljore e jo temës foljore. Krahaso: e tërhoqi *rëshqanë*, dh) Së fundi, këtë prapashtesë e kanë marrë edhe disa fjalë të përbëra ose të përngjitura, ku prapashtesa shtohet në të njëjtën kohë me përngjitjen: *symbyllazi* e *symbyllurazi*, *këmbadoras, doradoras, vithambrapas, ballaballas, anëmbraptas, rasandodhas, çartakandas, prishaqefas, çartaqefas, kalaveshas, këputaqefas, kokëngjylmazi, kukaçefas, lakadredhas, pajambajtas* etj.

Prapashtesa *-a* e zgjeruar pastaj në variantin *-aj* gjellon gjithashtu në sistemin fjalëformues të ndajfoljeve. Këtu vjen në konsideratë mendimi i shprehur nga A. Xhuvani — E. Çabej<sup>71</sup>. «Me këtë prapashtesë janë formuar pak ndajfolje, duke u kthyer në *-a -ë-ja* fundore e pjesores së disa foljeve.» Për këtë dëshmon edhe fakti që e gjejmë atë kryesisht tek pjesoret e tek forma e pashtjellë mohore si: *fshehura, shtruara, fshehuraj, ndenjura, papandehuraj, padashuraj*. Shtrirja e saj analogjike ka përfshirë jo vetëm ndajfoljet e thjeshta të tipit *brenda, jashta* por edhe formime të tjera ndajfoljore si *më hundëzaj, më krahëzaj, ndënëdhezaj* etj. Në këtë mes nuk përjashtohet mundësia që në të tilla raste të kemi të bëjmë me një përzierje dy prapashtesash. Përsë i përket burimit të prapashtesës *as* ne miratojmë mendimin që ajo nuk është e njëjtë me prapashtesën *-as* që formon emra të prejardhjes dhe etnika me të cilën ajo e ndajfoljeve përputhet fonetikisht<sup>72</sup>.

Ndër prapashtesat produktive ndajfoljore është për t'u shënuar dhe prapashtesa *-thi* që në gjuhën e folur e gjejmë edhe të zgjeruar në variantet *-thin, -thinaj*. Kjo prapashtesë bashkohet me: a) tema të thjeshta emërore për të shënuar lodra e mënyra të lëvizuri a të qëndruari: *arithi, cingëlthi, çapthi, fillthi, mullarthi, mullithi, shukthi, shulthi, trupthi, qirithi, lopthi, lingthi, vrapthi, sanxhakthi* etj. b) tema emërore të formuara me prapashtesën *-im*: *fluturimthi, kapërdimthi, kapërcimthi, peshimthi, qëllimthi, rrëmbimthi, rrotullimthi, sorollimthi, durimthi, nxitimthi, vetëtimthi, kalimthi, qërtimthi, lëndimthi* etj.. c) disa forma mbiemërore të substantivuara të rrjedhore që gjenden sot në funksion ndajfoljor: *së prapthi, së mbarthi, së qetthi* etj.. d) disa tema ndajfoljore, duke u krijuar kështu dublete që shpeshherë dallohen në mes tyre edhe stilistikisht si: *tanithi, kaluarthi, rrëshqanthi, vrinkthi, pupthi, zdrankthi* e *zdrënkthi, qëkurthi, qëparthi, dëllëngthi, djethi, shakthi* dh) dhe së fundi me disa fjalë të përbëra si: *kokangulthi, guraçokthi, symbyllthi, maramenth, këmbkryqthi, topagropthi, brezahypthi, hapashalthi, kryengulthi, kukumalthi, picimajthi, picingulthi, pulaqorthi, rrokapjekthi, topkalorthi* etj. Kjo prapashtesë është e lidhur me kuptime të caktuara. Ndajfoljet e ndërtuara me të shprehin përgjithësisht një mënyrë të qëndruari, një mënyrë të ecuri.

Si shihet, funksionet e saj puqen me ato të prapashtesës *-as*<sup>73</sup> gjë që shprehet edhe në praninë e çifteve ndajfoljore: *hapashalthi e hapashalthi, shulas e shulthi, pulaqoras e pulaqorthi* etj.. duke u përdorur kështu shpeshherë njera për tjetrën.

70) Shih, A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. cit.*, f. 21.

71) A. Xhuvani — E. Çabej, *vep. cit.*, f. 6.

72) Po ata, *po aty*, f. 21.

73) Po ata, *po aty*, f. 36.

Prapashtesa *-thi*, sikundër është vënë re edhe para nesh<sup>74</sup>, nuk duhet përzierë me të njëjtën prapashtesë, që përdoret kryesisht në sistemin emëror e veçanërisht për të shprehur aty një nuancë zvogëlimi a përkëdhelie, gjë që nuk shfaqet tek ndajfoljet. Megjithatë edhe tek ndajfoljet nuk mungon ndonjëherë përdorja e saj në funksion përkëdhelie por me vlerë stilistikore. Mjafton të sjellim këtu për ilustrim frazën: «Shtroi gunën... dhe vendosi mbi të, *lehtë e lëndimthi*, trupin e njomë e të shuar të të birit.» (J. Xoxa, Lumi, II, f. 99).

Së fundi, prapashtesa *-çe* e burimit turk ka mundur të formojë disa ndajfolje prej temash emërore. Këto krijime janë më së fort karakteristike për gjuhën e folur, po ato kanë mundur të depërtojnë edhe në gjuhën letrare. Të tilla janë ndajfoljet: *çobançe, fshaçe, hajduçe, derrçe, inatçe, turçe, budallallëkçe, tregtarçe, trashamançe, halldupçe, qençe, vendçe* etj. Duhet shtuar këtu që prapashtesa është bashkuar ndonjëherë edhe me tema emërore që kanë një kuptim pejorativ, kështuqë e gjejmë atë shpesh në ato situata që shërbejnë si tipizim i ambjentit e personazhit. Përndryshe vendin e saj e kanë zënë ndajfoljet me prapashtesa të tjera produktive. Në vend të tyre mund të përdoren edhe togje fjalësh po me atë kuptim që jep një ndajfolje e tillë. Kështu për të shënuar gjuhën e një populli prapashtesa *-çe* pothuajse nuk përdoret më.

Gegërishtja ndryshe nga toskërishtja ka dhe një radhë fjalësh që kryejnë funksionin e ndajfoljeve dhe që përmbajnë prapashtesën *-shëm*, të cilat përputhen me mbiemrat me ndryshimin që këta të fundit janë të pajisur edhe me nyje. Shiq shihet, këtu kemi të bëjmë me ndajfolje që vijnë nga mbiemrat përkatës, të cilët përdoren edhe si ndajfolje por pa nyje, në analogji me ndajfoljet e thjeshta, mbiemra në origjinë. Këto ndajfolje janë relativisht të përhapura si në gegërishten e shkruar ashtu dhe në gegërishten e folur. Të tilla janë: *mendueshëm, kumbueshëm, qetshëm, kuptueshëm, rrëmbyeshëm, mërziçëm* (nga mërzitshëm), *mallëngjyeshëm, gëzueshëm, idhshëm, mallshëm, gazmendshëm, habitshëm, drithshëm, inatshëm* etj. Në këtë grup ka edhe ndajfolje që nuk kanë mbiemra korespondues. Ato janë ndërtaur në analogji me tipet që i kanë mbiemrat përkatës. Hyjnë këtu: *mallshëm, gazmendshëm, inatshëm* etj. «Një gji gruaje dilte nga një rreckë e tillë, sikur ta kishte grisur *inatshëm* me thimthin e vet.» (Dh. Shuteriqi, Kënga, f. 294). «Kuç si gjaku flamurët po fshtillen / rrahin flatrat sot me krenari / mbi shpi t're *gazmendshëm* po valojnë.» (M. Gurakuqi, Gjeto, f. 48). «Zoqtë ndër pemë *gëzueshëm* cicërojnë / e e ndjellin *mallshëm* shoqi-shojnë / her' fluturo e her'ndalu ndër gema» (Po ai, po aty, f. 48).

Të folmet e toskërishtes popullore nuk i njohin të tilla ndajfolje; ato përdorin si ndajfolje, që kanë të njëjtin kuptim me këto të të folmeve të gegërishtes, pjesoret e thjeshta. Ndërkaq, ndajfolje të tilla kanë filluar të shtrihen në gjuhën letrare. Kështu gjejmë *arsyeshëm, mendueshëm, kuptueshëm* tek F. Gjata; «Cimi, ajo vajza e vetme e Xhemal Lkundës, që kish dalë partizane për të mos u martuar me plakun Karafil Agua rrinte *mendueshëm* te pragu i portës.» (F. Gjata, Përmbysja, 343) *përzishëm*, te V. Kokona; *rrëmbyeshëm, urrishëm* te L. Qafëzezi; «Me er' e me shira Nëndori kish hyrë / E pylli kish mbetur i shkretë, / *Rrëmbyeshëm* Tetori nga do kishte fryrë / E pemve me s'dukeshin fletë» (L. Qafëzezi, Proletarët, 11); *dhëmbëshëm* tek V. Sejko etj.

74) A. Xhuvani, *vep. cit.*, f. 196.

Si tip fjalëformues më vete prefiksimi në përgjithësi nuk është karakteristik për ndajfoljen. Megjithatë edhe këtu dallojmë ndonjë parashtesë që ka formuar ndajfolje kryesisht nga tema ndajfoljore, po shpesh pa i dhënë ndajfoljes një vlerë të re kuptimore të ndryshme nga ajo e para. Rrallëherë mund të vihet re ndonjë formim me parashtesë që i jep ndajfoljes kuptim intensiv. Ndajfoljet: *mbas, mbasnesër, moskurrë, mosnjëherë, moskund, ngrykë, pardje, parvjet, parnatë, pasdreke, pasdite, pasdarke, pasnesër, përball, përbrinjë, përditë, përnatë, përdhe*, janë fjalë të përngjitura e jo formime me parashtesë. Këtu parafjala, duke u përdorur shpesh pranë emrave u ngjiz me to dhe formoi një njësi të re leksikore.

Si formime të qarta parashtesore duket të jenë rastet *përrjashta, përmbropa, përpara, përposh, përsipër, përkundrejt, përkarshi* etj. Sikundër shihet, parashtesa që është treguar më produktive në formimin e disa ndajfoljeve dhe që ndërkaq shërben për të formuar edhe pjesë të tjera të ligjëratës është parashtesa *për*—, po, si e thamë, shpesh duke mos zhvilluar ndonjë kuptim të ri.

#### *Ndajfolje të përngjitura e të përbëra dhe lokucione ndajfoljore*

Fjalë prej rrënjësh jo të njëjta, si rezultat i dendurisë së përdorimit pranë njëra-tjetrës, arrijnë me kohë të shkrihen e të formojnë një fjalë të vetme, kuptimi i së cilës si tërësi mund të humbasë me kohë kuptimet e elementeve që e përbëjnë. Me anë të përngjitjes janë formuar edhe ndajfolje që në fazat më të hershme të zhvillimit të gjuhës shqipe e deri në ditët tona.

*Së pari*, në formimet e këtij tipi dallohen ato që kanë si element të parë, njërin nga përemrat *ai, ky*, në rasat rrjedhore e kallëzore dhe si element të dytë një emër. Kështu kemi: *asohere, asodore, ksodore e ksodore, ksifarësh, kësilloji, kësisoj*; por edhe *atbotë, atëherë*. «Kësifarësh Hankua zotonte ndë Kaza të Tepelenës që përbëhej prej katër katundesh të Hormovës, . . .» (I. M. Qafëzezi Histori. 9). *Atëkohë*, hapet dera e kafes dhe hyjnë dy vetë. . . një burrë e një grua». (Dh. Shuteriqi, Kënga. 303).

*Së dyti*, dallohen formimet ku elementi i parë i përngjitjes është përemri *gjithë*, ndërsa si element i dytë mund të jetë një emër, një ndajfolje përemërore a një pjesë tjetër. Hyjnë këtu: *gjithëmonë* (nga gjithmotnë), *gjithëherë, gjithënduersh, gjithkund, gjithkah, gjithqysh, gjithaq, gjithësejt, gjithnjë, gjithsesi*.

*Së treti*, dallojmë përngjitjet ku si element i dytë është ndajfolja përemërore ku në formën *kund e kundë* ndërsa si element i parë mund të jetë një përemër a një ndajfolje përemërore si: *gjëkund e gjëkundi, kurkund e kurkundi, asgjëkund e asgjëkundi*.

*Së katërti*, përngjitjet ku si komponent i dytë dallohet elementi foljor *do* ndërsa si komponent i parë është një ndajfolje përemërore: *kur, ku, si, qysh, sa, tek*. Kështu kemi: *kudo, kurdo, sido, sado, ngado, tekdo*. Ndërkaq, shënojmë që më kuptimin e të përngjiturës *kurdo* haset dhe *kurdoherë*, duke na dalë kështu si një shkrirje tri elementesh; me këtë të fundit shkon edhe *ngandonjëherë*. Si ndajfolje të përngjitura janë dhe *ndokund, e ndokah, ndokurr* në të cilat vihet re një rend i përmbysur gjymtyrësh duke dalë elementi foljor *do* si komponent i parë i përngji-

tjes. Po në këtë grup hyjnë edhe përngjitjet që kanë si komponent të parë elementin foljor *dì*, si: *diku, dikur, dikund, dikutek, dikah* e *diqysh*. Ky tip ndërtimi është i përhapur edhe në gjuhët romane, kështu që në këtë pikë vihet re një afëri në mes të këtyre gjuhëve, sidomos në mes shqipes dhe rumanishtes. Sikundër shënon K. Sandfeld<sup>75</sup> dhe më vonë A. Lombard<sup>76</sup>, formime të tilla si *kudo* etj., duke shkuar me këto edhe përemrat *kushdo* etj. arumanishtja i ka kalkuar nga shqipja ose ka ruajtur elementin e dytë foljor të pandryshuar. Krahaso format e arumanishtes *iuve, iutsido, cindotsido*. Po prof. Çabej<sup>77</sup> e çon më tej mendimin e dijetarëve të lartpërmendur kur shkruan: «Është për t'u vënë re që format e shqipes me të njëjtët elementë, por të formuara me rend të përmbysur gjymtyrësh mbulohen në kuptim me të porsaparashtruarat e rumanishtes: në vend të *kushdo* —(n) *dokush*, pastaj (n)*doku*, (n)*dokund*, (n)*dokur*. . .»

Së pesti, dallojmë një tip ndajfoljesh të përngjitura ku si element i fundit i tyre është fjala *herë*. Të tilla janë: *nganjëherë, ngadonjëherë, menjëherë, asnjëherë, ngaherë*. Edhe tek asnjëherë K. Sandfeldi<sup>78</sup> sheh një analogji formimi të shqipes me rumanishten *niciodata* (asnjëherë).

Së fundi, vijmë formimet e tipit: *matanë, mënjane, e mëktanë*. «Leksi, *matanë*, kishte shkuar arave, për të caktuar nga do të fillonte punën të nesërmen: Piloja, *mëktëanë*, po rregullonte dorakët prej druri të parmendave». (J. Xoxa, Lumi, II, f. 207). Duhet shënuar se *matanë* e *mëktanë* janë ende të pastabilizuara lidhur me shkrimin.

Ndryshe nga pjesët e tjera të ligjëratës, sidomos nga emrat e mbiemrat, kompozimi nuk është shumë produktiv në formimin e ndajfoljeve. Vihet re që shpesh si ndajfolje përdoren mbiemrat e përbërë të tipit: *symbyllë, ballhapët, duarthatë* etj. Përdoren gjithashtu si të tilla fjalë të përbëra që marrin edhe ndonjë prapashtesë karakteristike ndajfoljore, të cilat ne i kemi përmendur në pjesën përkatëse të punimit. Po, megjithkëtë ekzistojnë në shqipen edhe ndajfolje të përbëra të pashoqëruara me ndonjë prapashtesë dhe që nuk kanë format mbiemërore përkatëse. Dallojmë këtu dy tipe kryesore formimi:

1. Ndajfolje që kanë si komponente përbërëse dy emra: *këmbëkryq, krahaqafë, kryemuaji*. Kjo e fundit është një ngjizje e togut *krye muaji*. «*Kryemuaji* vinte beu e më sillte të ngrëna dy palë hejbe plot» (S. Andoni Maleve, f. 48).

2. Ndajfolje të përbëra, ku komponenti i parë është një emër, i dyti një ndajfolje: «*Bythrapë, kokëjashtë, vithambrapa, kambëturqisht* etj.

Për arsye se nuk formojnë ndonjë tip të veçantë në bazë të të cilat të zhvillohen edhe ndajfolje të tjera të përbëra, kemi lënë pa grupuar këtu ndajfoljet kompozita: *kryekëput, marramendësh, turravrap, mballafaqe, këmbëçalthi*.

Kalimi i pjesëve të tjera të ligjëratës në ndajfolje, sidomos i emrave,

75) K. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris 1930, f. 116 e 128.

76) A. Lombard: *Une Classe spéciale de termes indéfinie dans les langues romanes*. «N. Studia Neophilologica», Vol. XI. Nos. 1-3. f. 204. v.

77) E. Çabej, *Betrachtungen über die rumänisch-albanischen Sprachbeziehungen* në «Revue roumaine de linguistique». Tome X, 1965, Nos 1-3 (Përkth. shq. nga A. Dhrimo).

78) K. Sandfeld, *po aty*, f. 128.

është një proces i gjallë dhe aktiv. Kemi kështu sot një radhë lokucionesh ndajfoljore të formuara kryesisht nga emra me rrugë të ndryshme. Në këtë mes një vend qendror zë edhe përsëritja që mund të jetë e tipave të ndryshme.

Lindin kështu ndajfolje të formuara: 1) Nga përsëritja e drejtpërdrejtë e të njëjtit emër në formën e numrit shumësi si p.sh.: *vryma-vryma*, *njolla-njolla*, *pika-pika*, *rrathë-rrathë*, *fije-fije*, *litar-litar*, *duar-duar*, *grupe-grupe*, *togje-togje*, *fasha-fasha*, *copa-copa*, *mëngë-mëngë*, *rrëke-rrëke*, *dredha-dredha*, *çika-çika*, *unaza-unaza*, *gulfat-gulfat*, *rrypa-rrypa*, *sumbulla-sumbulla*, *tufa-tufa*, *bira-bira*, *varra-varra*, *copra-copra*, *hopehope*, *hove-hove* etj. «Vende-vende dukeshin livadhe e çeltira të gjelbërta» (M. Kallamata, Netë, 11). «Njerëzia *togje-togje* dilnin në rrugët jashtë qytetit që të shijonin ëmbëlsirën e një dite të pëlqyer dhe të ngrohtë në dimër.» (F. P. M. A. f. 197). «Nusja e re, moj nusja re / të shkojnë lotët *rrëke-rrëke*». (Këngë legjendare f. 176).

2. Nga përsëritja e të njëjtit emër në formën e njejësit si: *dallgë-dallgë*, *copë-copë*, *shkallë-shkallë*, *unazë-unazë*, *pjesë-pjesë*, *valle-valle*, *këmbë-këmbë*, *palë-palë*, *tufë-tufë*, *herë-herë*, *lugë-lugë*, *pikë-pikë*, *gotë-gotë* etj. «Të tre bashkë ... u mblodhën *kokë-kokë* dhe po e vështronin gazetën me dashuri.» (Z. Sako, Bereqeti, 84). «Kështu që edhe tanithi këmbët rodhë *valle-valle* njëra pas tjetrës.» (M. Kuteli Netë, 45) «e prap zorrët nga uja i bahen *palë-palë*.» (Migjeni, Vargjet, Tiranë, 1936, f. 68).

3. Nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet lidhëzës këpujore e. Kështu kemi: *varg e varg*, *vrab e vrab*, *rreth e rreth*, *mal e mal*, *rend e rend*, si në shembujt: «Aty muermë n'qafë një skjap / edhe e nismë rruqës turr vrab / varg e varg porsi kurila / shkuenë e ranë ke Nue Hila.» (Mbledhës, III, 477). «Iku gjysa gjeli *vrab e vrab*, e rruqës i pshtoi një pare, e shkoi tu plaku e i tha:» (Proza, I, 93). «Shiroku i ngrinte *dallgët mal e mal* që prapa e t'i përplaste mbi qiç, që thoshe se do ta futi anijen një qind pash tëposhtë...» (Dh. Shuteriqi, Rruga, 30).

4. Nga përsëritja e të njëjtit emër të gjinisë femërore në trajtën e emërore së shquar *rradha-rradha*, *koha-koha*, *reja-reja*, *kamba-kamba*, *dora-dora*, *goja-goja*, *luga-luga*, e për analogji me këto dhe *kraha-kraha*. Ndoshta këtu mund të kemi edhe formime me —as e pastaj me renjë të s. Këto formime i gjejmë pothuajse vetëm tek autorët gegë dhe kryesisht vetëm në poezi, mesa duket, për arësye të rimës. Formime të tilla kanë kaluar pastaj edhe në prozë. «U s'u ftoha, as s'u helmova, / por u muermë *dora-dora*: e u puthme goja-goja. (Mbledhës III, 481), «Ecë Bajrami *kama-kama* / shkojnë me pvetë të Brahim Rama:» (Po aty, f / 345).

5. Lokucione ndajfoljore të formuara a) nga lidhja e dy emrave me kuptim pak a shumë të afërt nëpërmjet lidhëzës këpujore e: *copë e çikë*: *copë e thërime*, *lesh e li*, *rrush e kumbulla*, *rreth e qark*, *rreth e rrotull*, *anë e kand*, *fund e kënd*, *çikë e thërime* etj. «Në fshat kemi nevojë për njerëz të zot, se e di si po na venë punët? Ja, kështu, *lesh e li*, s'e merr vesh qeni të zonë.» (F. Gjata, Ujët, 30). «Më duket sikur të nëma / të nëma, të nëma shumë, / copë-copë e bëfsh gjunë / moj e bëfsh *copë e thërime* / të kesh mall për besën time.» (Mbledhës, III, 121). «U hap fjala *fund e kënd* gjersa i ra në vesh e një plaku të uruar nga Çermanik' e Madhe.» (M. Kuteli, Netë, 154). «Ballabani, me gjak i Shqyptar, po me ndiesi të poshtëme e tradhtare i kje zotnue Sulltanit me shkelë *anë e kand* Shqypnin.» (N. Nikaj, Bërbuqja, f. 6).

Këtu hyjnë edhe: *mëngjez e mbrëmje*, *ditë e natë*, *natë e ditë*, *verë e dimër*, *dimër e verë*, *vite e shekuj*, *ditë e javë*, *ditë e mot*, *orë e çast*.

*pranverë e vjeshtë, fill e flakë, krahë e qafë, kokë e këmbë, këmbë e krah,* disa prej të cilave formojnë çifte antonimike. Të tilla formime në mohim lidhen me lidhëzën bashkërenditëse shtesore as... as... si: *as ditë as natë, as natë as ditë, as verë as vjeshtë* etj. «O Shqypni gjimote i shkreti, / Male mbush me gjuetarë plot; / Kësollë e bardhë, ku porsi mbreti / Shkon barija dit e mot.» (N. Mjeda, Vjersha, 161) «Se ata, *pranverë e vjeshtë* s'bëjnë punë tjetër veç pyesin si e duan këto tokat e Myzeqesë.» (J. Xoxa, Lumi, II, 229). «Po me atë bindje ai futej nën urën e madhe duke biseduar me gurët e lëmuar të këmbëve të saj, *ditë e natë, vite e sheku.*» (A. Abdihoxha, Vjeshtë, 291)

b — nga bashkimi i dy foljeve që afrojnë në kuptim nëpërmjet lidhëzës e si: *shkel e shko, çel e mbyll, veshë e ngjeshë, qesh e ngjesh* etj. «Raa n't'shtrueme *veshë e njeshë* e kuer Mrija i'u afrue brii shtratit...» (N. Nikaj, Berbuqja, 37). «... populli ka një filozofië të tij e cila filozofië asht përfundimi i disa vrejtimeve të gjata prej shekujsh dhe prandaj nuk lypset përbuzë *shkel e shko.*» (Lipi, Fatbardhi 85). «Ashtu them unë... hapi gojën këtë herë për të folur *çelembyll* kryeplaku i Trokthit.» (J. Xoxa, Lumi, II, 247).

c — nga lidhja e pandërmjetme e dy emrave me kuptim të afërt si *natë ditë, ditë natë, dimër verë, verë dimër.* «Po me të mbaruar provimet, roka përsëri mandolinën dhe nuk qe një punë që ta lëshoj nga dora, *natë ditë.*» (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 156). «Në qafë fryka erë *dimër verë.*...» (N. Prifti, Çezma f. 174).

6. a — nga përsëritja e të njëjtit emër, gjymtyra e parë e së cilës është në rasën emërore të shquar, ndërsa gjymtyra e dytë në rasën rrjedhore të shquar. Të tilla janë: *darka darkës, dita ditës, hera herës, dora-dorës, këmba-këmbës, nata-natës* etj. «... po m'i prure *darka darkës* tamam, le që çupën do (të) ta jap për grua po do të fal edhe mbretërinë time» (Proza, I, 422). «Të thënë e të bërët: i ramë *këmba-këmbës* nga vreshtat, nëpër gështenjët, mi Qafë të Pëndarit e që aty në gropat e qoftë largut.» (M. Kutemi, Netë, 67). «Kërkon ta largojë nga Shqipëria me shpresë se do të mundet me e largue dhe nga brengjet e pikëllimet e pa rreshtuna që e mësyjnë *dita-ditës.*» (H. Stërmilli, Sikur, 109). «Dhe kokë për kokë, me ngadalë, afrojnë filxhanet e kafesë së zbrazur ku *hera herës* pëpiqen cigarët e mbajtura mbi disa pipa kokalli.» (P. Marko, Rrugë, 197)). Përsëritje të tilla çojnë shpesh në përngjitje.

b — nga përsëritja e të njëjtit emër, gjymtyra e parë e së cilës është në emërore të shquar ndërsa e dyta në rasën kallëzore të shquar: *dita ditën, hera herën, nata natën* etj. «Kur marrëdhënjet midis Rusisë dhe Turqisë po ashpërsoheshin *dita ditën* Ali Pasha përfitoi rasjen e kohës dhe lypi ndë Stamboll t'i çedohen atij këto pronja...» (I. M. Qafëzezi, Histori, 84).

Formën e përsëritjes me gjymtyrën e dytë në rasën gjindore ka dhe lokucioni ndajfoljor *kurrën e kurrës*. Këtu kemi të bëjmë me një shtrirje analogjike të lakimit edhe në pjesët e palakueshme të ligjeratës, gjë që vihet re jo rrallë në të folmet popullore sidomos të gegërishtes. «Qemali ish dashruar me gjithë mend me Emira Velon, por *kurrën e kurrës* jo në atë kuptim të shëmtuar që i jepte zeshkani kësaj dashurie...» (Sh. Musaraj, Para, I, 41).

Përsëritja bëhet në këtë rast edhe me një nuancë të veçantë kuptimore e pikërisht për t'i dhënë më shumë fuqi mohimit, për të shprehur kështu një mohim kategorik.

7. Nga bashkimi i dy ndajfoljeve me kuptim antonimik të lidhura

ose jo me lidhëzën këpujore e. Të tilla janë lokucionet: *andej këndeje, tutje tëhu, tutje e tëhu, aty këtu, lart e poshtë, poshtë e lartë*, si në shembujt: «*Aty-këtu* në grupe të vegjël xheku ndihej një melodi e çkëputur...», (S. Spasse, Ata, 57). «Dhe këto nuk i thonë hapët, zyrtarisht, në ato fletushkat e tyre, po *tut'je tëhu*, qosheve të erta, ...» (Sh. Musaraj, Para, I, 106).

Të lidhura me një kuptim të veçantë janë lokucionet ndajfoljore: *nesër-pasnesër, sot nesër* etj., të cilat shprehin një kohë të pasigurtë të kryerjes së veprimit. Krahaso shembujt: «Në e ka vënë firmën me dëshirën e saj Marina, në i ka thënë me tërë dëlirësi ato që tha Miti. kjo do të mirret vesh *nesër-pasnesër*.» (S. Spasse, Buzë, 292). «*Sot nesër* ardhka në Pishas një grup shokësh për këtë punë.» (Po ai, po aty, f. 50).

8. Lokucione të formuara a) nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet parafjalës *për*; gjymtyra e dytë e përsëritjes është në rasën kallëzore. Të tilla janë: *ballë për ballë, vend për vend, gjoks për gjoks, pëllëmbë për pëllëmbë, gjunjë për gjunjë, dorë për dorë, derë për derë, mot për mot, vit për vit, mëngjez për mëngjez, ditë për ditë, çast për çast, muaj për muaj, javë për javë, natë për natë, mbrëmje për mbrëmje, drekë për drekë, darkë për darkë, shpatë për shpatë, krye për krye, flakë për flakë, fyt për fyt, deng për deng, kokë për kokë, kraharor për kraharor, hap për hap, faqe për faqe, dhëmb për dhëmb, zjarr për zjarr, çap për çap, gushë për gushë, gojë për gojë, fjalë për fjalë, grykë për grykë, brinjë për brinjë* etj. Sikundër shihet përsëritja nëpërmjet parafjalës *për* është realizuar në trajtën e pashquar të emrave: «Qëndrimi më i drejtë ndaj gabimeve të një shoku, qëndrimi më dashamirës e parimor ndaj tij, është që të qortohet dhe të kritikohet *ballë për ballë*, të shtyrë nga kujdesi që kemi për të...» (E. Hoxha Raport në Kongr. V. 101). «Brigada IV vazhdon presionin *natë për natë* në sektorin e saj duke e gozhduar armikun nëpër llogore.» (M. Shehu, Lufta, 38). «Ku e le ai: *vit për vit* e ka marrë e simvjet s'do t'i shpëtojë. (S. Spasse, Ata, 157).

Në raste shumë të rralla haset ky tip përsëritjeje me gjymtyrën e dytë në rasën rrjedhore: *dorë për dore, mes për mezi, krah për krahu*, etj. Në shumicën dërmuese të rasteve të njëjtë autorë këto përsëritje gjenden me gjymtyrën e dytë në kallëzore.

Përsëritjet e këtij tipi kuptimisht shprehin marrëdhënje kohore e vendore; tregojnë gjithashtu edhe cilësi të veprimit.

b — nga përsëritja kryesisht e një ndajfoljeje nëpërmjet parafjalës *për* si: *aty për aty, sot për sot, tashti për tashti, tej për tej, vetëm për vetëm, drejt për drejt, ndryshe për ndryshe; hë për hë* etj., si dhe nga përsëritja e një numërori a përemri: *një për një e tjetër për tjetër*. «Dhe ashtu më këmbë e gatitu, sikur të ishte në mësim, zu t'i tregojë *një për një* se si gatuhet «zogu i lumit». (J. Xoxa, Lumi, I. 212). «Kishte ardhur me shpresa të tjera dhe tashti i doli *tjetër për tjetër*.» (F. Gjata, Kënetë, 399).

9. Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet parafjalës *më*, duke u vendosur kështu gjymtyra e dytë në rasën kallëzore sipas natyrës drejtuese të parafjalës. Kemi kështu: *bark më bark, gju më gju, bythë më bythë, kokë më kokë, bryl më bryl, nofull më nofull, brisk më brisk, kurris më kurris, trup më trup, pash më pash, buzë më buzë, flakë më flakë, vesh më vesh, dorë më dorë, gojë më gojë, sy më sy, bri më bri, krah më krah, prua më prua, shpat më shpat, skaj më skaj, rrugë më rrugë, shteg më shteg, gurë më gurë, zallë*

më zallë, derë më derë, kënd më kënd, pemë më pemë, kep më kep, hu më hu, odë më odë, qoshe më qoshe, breg më breg, brinjë më brinjë, burim më burim, vithe më vithe etj. Edhe në këtë tip emri përsëritet gjithnjë në trajtën e pashquar e gjithnjë në formën e njëjësit. Lokucione të tilla shprehin kryesisht marrëdhënje vendore ose një mënyrë të vepruari e më rrallë marrëdhënje kohore. Rraporte kohore shprehin përsëritjet e tipit: *kokë më kokë, çast më çast, ditë më ditë* etj.; kjo lidhet dhe me vetë kuptimin që ka emri i përsëritur i cili në vetë-vete përmban nocionin kohë. Në përsëritjet e këtij tipi, megjithëse rrallë, gjejmë para parafjalës lidhëzën *e*, me sa duket, për të shtuar një rrokje.

10. Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet parafjalës *me*. Këtu dallojmë, së pari, përsëritjen ku të dy gjymtyrët janë në trajtën e pashquar si: *sy me sy, trup me trup, flakë me flakë, gojë me gojë, çast me çast, mot me mot* etj.; së dyti përsëritjen ku gjymtyra e parë është në trajtën e shquar të emërores ndër-sa e dyta në të pashquarën e kallëzores si: *dita me ditë, nata me natë* etj. dhe, së fundi, përsëritjen ku të dy gjymtyrët janë në trajtën e shquar, e para në emërore e dyta në kallëzore si: *dita me ditën, nata me natën*. Po sjellim nga një shembull: «Punët i ndroheshin përpara *çast me çast*.» (N. Nikaj, Bërbuqja, f. 143). «Por punët i vijshin *dita me ditë* tue u shtue e tue u grumbullue (M. Logoreci, Histori, 188). «... Thash e themet e shtonin numrin e ushtrisë turke *dita me ditën*, aq sa edhe ushtarët nisë të tregonin shenja frike?» (N. Noli, Historia 37 (1962).

Kuptimisht, ndërtime të tilla shprehin zakonisht kohë, sidomos dy rastet e fundit, si dhe një mënyrë të vepruari. Konstruktet që shprehin marrëdhënje kohore, tregojnë veçanërisht vazhdimësi në kohë, në këtë drejtim ato afrohen me përsëritjen e ndërtuar me parafjalën *për*. Po përsëritjet e ndërtuara me parafjalën *me* në mvarësi nga situata e konteksti mund të marrin edhe kuptime të tjera, sikundër shihet në shembullin këtu poshtë, ku shprehet një marrëdhënje kohore e pacaktuar a e pasigur-të dhe e afërt: «...po Skënderbeu dhe Shqiptarët e prisnin me qetësi furtunën që afrohej, se ishin të sigurt që ushtritë kryqësore nënë komandën e Papës do të vinin në Ballkan *dita me ditën*.» (F. Noli, Historia, 105 (1962).

I ndërtuar në këtë mënyrë është dhe lokucioni *sot me sot*, gjymtyrët e të cilit i përbën ndajfolja *sot*. «*Sod me sod* s'ka ç'më duhet kulla.» (Mbledhës, III, 300).

11. Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër me parafjalën *pas* a *mbas*, gjymtyra e parë e së cilës është në emëro-re, ndërsa e dyta në rrjedhore të pashquar. Të tilla janë lokucionet: *brez pas brezi, çap pas çapi, ditë pas dite, dorë pas dore, fjalë pas fjale, gjysh pas gjyshi, herë pas here, hap pas hapi, jetë pas jete, këmbë pas këmbe, kënd pas këndi, kohë pas kohe, orë pas ore, rend mbas rendi, rradhë pas rradhe* etj. «Dhe unë njeriu i brengosur i kryeqytetit që pata njomur kaq herë pendën e shkrimit në vrere, ndenja edhe dëgjova *orë pas ore*, fantazinë e gishtërinjve të bardhë të zojshës F.» (M. Kuteli, Ago Jakupi, 136). «Epoka që jetojmë është epoka e triumfit të socializmit, është epoka e ideologjisë së lavdishme të shoqërisë së re, marksizëm-leninizmit, i cili vuri në vend vlerat e krijuara nga njerzit *brez-pas brezi*, dhe i armatosi njerzit e epokës së saj me një armë të fuqishme dhe të pagabuar...» (E. Hoxha, Fjala me inteligjencën 33). «Markua kish qenë di-sa kohë mësues, po tani punonte si murator, mjeshtri kjo që podgozha-nasit e ushtrojnë *gjysh pas gjyshi*.» (Dh. Shuteriqi, Gurnecka, 18).

12. Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet parafjalës *nga*, gjymtyrët e së cilës janë që të dyja në rasën emërore të pashquar; para parafjalës *nga* mund të dalë edhe lidhëza këpujore *e*, për arsye të numrit të rrokjeve. P.sh. *ditë nga ditë, mot nga mot, e mot e nga mot* etj. «Kësaj plakës pula i pillte *ditë nga ditë nga një koqe ve*» (Mbledhës, I, 272). «Fatmirosh *mot e nga mot / grur'e misër të kem plot / të kem raki, të kem verë / të ëmbëlë si shilqerë.*» (Çajupi, Vepra, f. 75).

Më rrallë gjënden përsëritje të tilla ku gjymtyra e parë është në formën e emërores së shquar si *dita nga ditë*: «Kyj kish ndezur me një ari që i vinte *dita nga ditë* dhe i merrte nga pesë, nga gjashtë dhën.» (Mbledhës, I, 261).

Përsëritje të tilla, të ndërtuara me emra, kuptimisht shprehin vetëm kohë. Po një mënyrë e tillë ndërtimi është karakteristike edhe për lokucionet ndajfoljore që formohen nga numërorët. Të tilla janë: *një nga një, dy nga dy, tre nga tre, katër nga katër, pesë nga pesë*, etj. «Dilnin pastaj *dy nga dy, tre nga tre e pesë nga pesë* e vriteshin shoqi me shoqnë, si alla-alla: (M. Kuteli, Netë, 26).

Edhe lokucionet me përsëritje numërorësh mund të marrin para parafjalës *nga* lidhëzën *e*. «Afër të gdhiri, kur mbledhja mbaroi, shokët duallën *një e nga një*. (Sh. Musaraj, Para, I, 198).

Po në këtë mënyrë janë formuar edhe lokucionet: *pak nga pak, ca nga ca, dalë nga dalë*. Ky i fundit pothuajse është shkrirë në një fjalë të vetme, duke marrë kështu formën e një fjale të përngjitur. «*Dalëngadalë*, sheshin e namazgjasë e pllakosi një heshtje e rëndë». (A. Abdihoxa, Vjeshtë, 12).

13. Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet parafjalës *në a ndër*, me gjymtyrën e parë në emërore të pashquar, të dytën në kallëzore të pashquar. Të tilla janë lokucionet: *breg në breg, curr në curr, faqe në faqe, kep në kep, lis në lis, sy në sy e sy ndër sy, shkrep në shkrep* etj. Përsëritjet e ndërtuara nëpërmjet kësaj parafjale shprehin kryesisht raporte vendore, më rrallë përcaktojnë veprimin në cilësi, ndërsa marrëdhënjet kohore nuk janë të rregullta për këtë tip. «Kjo mënyrë luftë, pa u ndeshun askund n'armikun, por tue u endun *kep në kep, curr në curr*, filloi me iu mërztun ushtrisë romake:» (M. Logoreci, Histori, 92).

14. Lokucione ndajfoljore të formuara nga përsëritja e të njëjtit emër nëpërmjet parafjalës *mbi*; gjymtyra e parë është në emërore-kallëzore të pashquar e dyta në kallëzore të pashquar si *det mbi det, gurë mbi gurë, gemb mbi gemb, këmbë mbi këmbë* etj. «Kapidani folë me mretin: / — Gjejm' ushtrinë që ma ke tretun / — S'un t'i gjalli çaf kan dekun. / *Det mbi det* s'i la pa i gjetun — (Mbledhës, III, 349).

Rrallë përdoren të tilla përsëritje me gjymtyrën e parë në trajtën e shquar të emërores, si: *këmba mbi këmbë*. «Majori Smit ai oficeri leshkokoridhko me fytyrën të kuqe si domate, ishte ulur *këmba mbi këmbë mbi një divan të drunjte...*» (F. Gjata, Përmbysja, 382 v.):

Kuptimisht ndërtime të tilla shprehin marrëdhënje vendore e më rrallë përcaktojnë veprimin në cilësi.

15. Një tip të veçantë në lokucionet e formuara nga përsëritja e të njëjtit emër përbëjnë përsëritjet: parafjala *nga* + emri në rasën emërore të shquar + parafjala *në* + emri në rasën kallëzore të pashquar. Këto ndërtime shprehin kryesisht marrëdhënje kohore, gjë që lidhet me kuptimin e vetë emrave që përbëjnë përsëritjen; kemi kështu: *nga çasti*

në çast, nga dita në ditë, nga koha në kohë, nga minuta në minutë, nga ora në orë, nga viti në vit etj. «Ne, parti e popull, do ta ruajmë këtë unitet të shenjtë si dritën e syrit dhe do ta forcojmë atë pa rreshtur nga dita në ditë. (E. Hoxha, Fjalim në 20 vjetorin e themelimit të PPSH f. 28). «Nga blerja e kullës, ku mungon emri i Stanishit, duket që ky, edhe jo Gjergji, dërgohej nga koha në kohë mie ushtri shqiptare si aliat i Sulltanit e i Kralit.» (F. Noli, Histori, 16.).

Ndërtimet e këtij tipi përcaktojnë veprime që vazhdojnë, që përsëriten ose që pritet të realizohen së shpejti si në shembullin: «Po ç'ka të duhet barka, bre burrë? Na presim me kullu kneta nga çasi në ças.» (J. Xoxa, Lumi, II, 137).

Format e ndryshme rasore të emrave të ndërtuara me parafjalë të ndryshme janë gjithashtu një burim për zgjerimin e kategorisë së ndajfoljeve. Kemi kështu në gjuhën shqipe shumë ndërtime të tilla ku, duke u dobësuar lidhja e tyre kuptimore (parafjalë + emër), duke u përdorur emri në një kuptim mjaft të përgjithshëm, realizohen kalimet e shpeshta të tyre në klasën e ndajfoljeve. Është e rëndësishme të shënohet këtu se kalimi i këtyre ndërtimeve në ndajfolje kushtëzohet dhe nga vetë emrat që i nënshtrohen një lidhjeje të tillë. Duke qenë të një kuptimi mjaft të përgjithshëm dhe duke pasur një kuptim kryesisht abstrakt që tregon kohë ose gjendje shpirtërore ata i humbasin më shpejt këto veçori kuptimore, e ngushtojnë mjaft këtë sferë dhe arrijnë kështu më lehtësisht të kalojnë në klasën e ndajfoljeve për të shërbyer si përcaktuese të veprimit foljor.

Të tilla lokucione ndërtohen me parafjalë të ndryshme. Dallojmë së pari ndërtimet me parafjalën me: *me egërsi, me gëzim, me kohë, me natë, me ngashërim, me nxit, me nxitim, me orë, me padurim, me qesëndi, me radhë, me seriozitet, me sinqeritet, me shpejtësi, me vrap, me vendosmëri, me zor, me zjarr* etj. «Po me që moti ndron me orë, pallton nuk e kishte nxjerrë asnjëri» (Z. Sako, Ditë, 8). «... të gjitha shllëpiat do të na i bajë shkolla — tha im atë me qesëndi. (H. Stërmilli, Sikur, 62). «Lumtës, me gjithë armiqtësinë e madhe që kishte ndaj Nazmiut, i erdhi shumë shumë keq, aq më tepër kur u bind se ai fliste me sinqeritet. (A. Abdihoxa, Vjeshtë, 148). «Disa nga shokët qeshën, por ja që Rifati na e mori punën me zjarr.» (Po aty, f. 102).

Gjithashtu mbiemrat e substantivuar në formën e gjinisë asnjëse të bashkuar me po këtë parafjalë kanë zgjeruar mjaft rrethin e lokucioneve të tilla ndajfoljore. Kështu kemi: (i flas, e qortoj, ia kthej, pyes, bie, sillem) *me të butë, (i flas) me të egër, (e këshilloj, i them, i flas, ia ha zemrën, e marr, kandis) me të mirë, me të keq, (e marr punën) me të ngutur, (ia kam) me të pabesë, (i flas, ia kthej) me të qeshur, me të tallur, me të urtë, me të vështirë* etj.

Së dyti, lokucionet e ndërtuara nga parafjala për + një emër në rasën kallëzore të shoqëruar ose jo nga nyja joshquese një: *për një çast, për ditë, për një hop, për një herë, për ibret, për jetë, për një kohë, për mot, për natë, për orë, për turp, për vit* etj.

Duhet shënuar këtu se, përsa i përket paraqitjes së tyre shkrimore lokucionet: parafjala për + një emër, shkruhen shpeshherë edhe së bashku duke u paraqitur kështu si një fjalë e vetme dhe duke marrë parafjala vlerën e një parashtese. Gjejmë kështu herë *përditë, përnatë* etj. e herë *për ditë, për natë*, edhe tek i njëjti autor brenda të njëjtit tekst. Ky fakt tregon afrinë e tyre gjithnjë e më të madhe me ndaj-

foljet dhe kalimin e tyre në një tip të ri formimi. Krahaso p.sh.: «Dërguanë dhe mbretëritë / të parëtë me të parë / papo vinin për ditë / e shihninë shqyptarë.» (N. Frashëri, Histori, 314). «Ditët ikin dhe ikin vitet o bir, Jeta mbruhet përditë e përvit me helm e me mjaltë.» (Dh. Shuteriqi, Kënga, 28).

Të kësaj natyre janë lokucionet: parafjala për + një mbiemër i gjinisë asnjansë të rasës rrjedhore. Ndërtime të tilla janë të shpeshta, me to shkojnë edhe ato që formohen nga numërorët. Po përmendim këtu: *për së afërmi, për së largu, për së gjati, për së gjëri, për së gjalli, për së mbari, për së mbrapshti, për së prapi, për së përprjeti, për së dyti, për së treti, për së pari* etj.

*Së treti*, dallojmë lokucionet: parafjala nga + një emër në rasën emërore në trajtën e pashquar. Të tilla janë: *nga ditë, nga herë, nga mot*. Sikundër vihet re, ndërtimet e këtij tipi kuptimisht shprehin marrëdhënje të ndryshme kohore, gjë që lidhet dhe me kuptimin e emrave që i nënshtrohen një lidhjeje të tillë. «Lumi s'bie kërcunj nga herë.» (Mbledhës, III, 205). «Kur ky inat dhe ky dëshpërim pëlciste, gjithëcka nxihej, gjithëcka bëhej e kotë, e pamundur, duke nisur që nga ajo luftë «komitçe» kundër Italisë edhe pse *ngaditë* vinin lajme të reja për fitimet e partizanëve...» (Dh. Shuteriqi, Kënga, 129).

Përveç grupeve të përmendura që kanë një përhapje relativisht të gjerë dhe me një farë produktiviteti, gjenden sot në përdorim në shqipe dhe mjaft ndërtime të tjera rasore-parafjalore të cilat, duke humbur tiparet e tyre morfologjike, duke u përdorur me një kuptim që largohet mjaft nga kuptimi i tyre i parë konkret, duke u përdorur pranë foljeve dhe duke përcaktuar veprimet që shprehin ato, kalojnë shpesh në klasën e ndajfoljeve. Të tilla janë: *prej kohe e prej kohësh, në këmbë a më këmbë, në çast, në minutë, në tym* etj. Mund të gjenden në gjuhë, sidomos në letërsinë artistike raste të shpeshta të tilla që përdoren herë si ndajfolje e herë si rase përkatëse e emrit me parafjalë, pa arritur kjo e fundit të humbasë gjithë vlerën e saj emërore me parafjalë.

### Konkluzion

Nga gjithshka u tha këtu rreth ndajfoljevet mund të nxirren disa përfundime:

1. Ndajfoljet si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës karakterizohen gjithandaj në strukturën e tyre formale nga shenja negative. Kjo lidhet me faktin se ato, në fund të fundit, përcaktojnë një objekt në cilësi a në raporte rrethanore jo në mënyrë të drejtpërdrejtë (siç e realizon këtë funksion mbiemri ndaj emrit) po në mënyrë të tërthortë.

2. Ndajfoljet kanë mjaft pika afrimi me mbiemrat. Në mënyrë të veçantë afrohen me mbiemrat ndajfoljet e cilësisë, sidomos në kuptim. Kategoria e shkallës dhe mënyra e shprehjes së saj është ajo që i afron shumë këto dy pjesë të ligjëratës, afëri që arrin deri në hollësi.

3. Brenda ndajfoljeve të sasisë duhet bërë një dallim esencial, sipas nesh, që ka të bëjë me karakterin e përdorimit të tyre. Këtu duhen dalluar, nga njëra anë, ndajfoljet që shprehin intensitetin e veprimit dhe, nga ana tjetër, ndajfoljet si mjet gramatikor për shprehjen e kategorisë së shkallës. Brenda këtij grupi dallohen ato që shërbejnë kryesisht si shprehëse të shkallës, sikundër janë *më* (geg. ma), *fare* dhe ato

që gjenden në të dy funksionet e lartpërmendura. Në funksionin si shprehëse të shkallës ato do të quhen fjalë shërbyese a fjalë të shkallës.<sup>79</sup>

4. Ndajfoljet kanë shërbyer e shërbejnë si gjendje e ndërmjetme për kalimin e pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës në pjesë të tjera të pandryshueshme. Mund të përmendim këtu disa parafjalë me origjinë emërore (*rreth, rrotull, anës, qark* etj.) të cilat përdoren sot edhe si ndajfolje edhe si parafjalë; po kështu edhe disa lidhëza.

5. Bashkohemi me mendimin që ndajfoljet e thjeshta, të cilat pugen me trupin e mbiemrave përkatës, rrjedhin nga këto të fundit dhe jo përkundrazi mbiemrat nga ndajfoljet.

6. Në fushën e formimit të ndajfoljeve vihen re ndërtime me strukturë të ndryshme.

a — Përbërja e tyre morfologjike dëshmon për ndajfoljëzimin sidomos të emrave;

b — Mënyra fjalëformuese e kompozimit nuk është aq produktive tek kategoria e ndajfoljeve në krahasim me pjesët e tjera të ligjëratës, sidomos me mbiemrat dhe emrat.

c — Gjithashtu mund të thuhet se parashtesëzimi nuk është karakteristik për gjuhën e sotme në sistemin ndajfoljor.

ç — Megjithëse prapashtesat që formojnë ndajfolje janë relativisht të pakta në numër, prapashtesëzimi është shumë produktiv në kategorinë e ndajfoljeve, ku dallohen si më produktive prapashtesa *-(i)sht*, po dhe *-as (-azi)* e *-thi*.

d — Formohen ndajfolje të reja me këtë tip fjalëformimi kryesisht nga temat emërore dhe mbiemërore. Kur ekzistojnë format paralele emër: mbiemër të tipit *histori: historik*, ndajfoljet formohen nga temat mbiemërore, me fjalë të tjera, kemi: *historikisht* e jo *historisht*.

Formimi i ndajfoljeve nga emrat nëpërmjet prapashtesëzimit është gjithashtu produktiv. Ky produktivitet kap nga një herë edhe tema që s'ekzistojnë të shkëputura nga prapashtesa ndajfoljore.

dh. Vihet re një farë ngjashmërie në vlerë midis prapashtesave *-(i)sht* dhe *-as(-azi)* gjë që shprehet edhe në krijimin e dubleteve.

e. Prapashtesëzimi është karakteristik për ndajfoljet e cilësisë ndërkaq mund të thuhet se, me përjashtime të rralla, ai nuk shfaqet tek ndajfoljet e rrethanës.

ë. Përsëritja qoftë e drejtëpërdrejtë qoftë e ndërmjetme me parafjalë të ndryshme, është një mjet tjetër që ka krijuar e po krijon në shqipen një numër të konsiderueshëm lokucionesh ndajfoljore.

«Fjalori i gjuhës shqipe», botim i Institutit të Shkencave numëron afërsisht rreth 1200 fjalë të shënuara si ndajfolje, duke përfshirë në këtë numër deri variantet dialektore, që pasqyrohen në atë fjalor, si dhe një numër të konsiderueshëm pjesëzash. Po gjendja reale s'është e tillë. Në të vërtetë ekziston një numër shumë më i madh fjalësh që kryejnë funksionin e ndajfoljeve. Sikundër u pa këtu rrugët për zgjerimin e kësaj kategorie janë të ndryshme dhe procesi i zgjerimit të tyre me mjete të ndryshme është një proces i gjallë dhe mjaft aktiv.

79) Shih për këtë edhe A. Reformatskij, *Vvedeniye v jazykoznaniya*, Moskva, 1967, 302.

**LETËRSIA ARTISTIKE E SHFRYTËZUAR DHE CITIMET  
E PËRDORURA.**

- A. ABDIHOXHA — Vjeshtë, Një vjeshtë me stuhi, Tiranë, 1959.
- A. VARFI — Në tingujt, Në tingujt e revolucionit, Tiranë, 1951.
- ÇAJUPI — Vepra, Tiranë, 1957.
- D. SHAPLLO — Përtëritje, Tiranë, 1960.
- DH. SHUTERIQI — Rruga, Rruga e rinisë, Tiranë, 1953.
- » » — Gurnecka, Tiranë 1957.
- » » — Kënga, Kënga dhe pushka, Tiranë 1963.
- E. HOXHA — Raport në kong. V, Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qëndror të PPSH, Tiranë, 1966.
- E. HOXHA — Raport në kong. IV, Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qëndror të PPSH, Tiranë, 1961.
- » » — Fjalim në 20-vjetorin e themelimit të PPSH. Tiranë 1961.
- » » — Fjala me inteligencien, Fjala e mbajtur në takimin me përfaqësuesit e inteligencies së kryeqytetit. Tiranë, 1962.
- » » — Fjala në 15-vjetorin e çlirimit, Fjala në mbledhjen solemne të 15-vjetorit të çlirimit.
- F. NOLI — Historia, 1962, Historia e Skënderbeut, Tiranë 1962.
- F. NOLI — Introdunkte e Hamletit.
- F. GJATA — Këneta, Tiranë, 1959.
- F. GJATA — Në pragun, Në pragun e jetës, Tiranë, 1960.
- » » — Përmbysja, Tiranë, 1954.
- » » — Tana, Tiranë, 1958.
- » » — Ujët, Ujët fle, hasmi s'fle.
- H. STËRMILLI — Sikur, Sikur t'isha djalë, Tiranë, 1959.
- I. M. QAFËZEZI — Histori, Histori e Ali Pashë Tepelenës.
- I. KADARE — Gjenerali, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1963.
- J. VRETO — Mirëvetija, Bukuresht. 1886.
- J. XOXA — Lumi, I, II, III, Lumi i vdekur, v. I, II, III, Tiranë 1965.
- » » — Novela, 1958.
- K. JAKOVA — Garda, Garda krutane, Tiranë, 1968.
- KËNGË HISTORIKE — Instituti i shkencave. Këngë popullore historike, Tiranë, 1956.
- » LIRIKE — Instituti i shkencave. Këngë popullore lirike, Tiranë, 1956.
- » LEGJENDARE — Instituti i shkencave. Këngë popullore legjendare, Tiranë 1956.
- KALENDARI — Kalendari Kombiar, Kolesianët Konstantinopol, 1872.
- L. QAFËZEZI — Proletarët, Tiranë, 1960.
- LIPI — Fatbardhi.
- » — Qytetnim.
- » — Mbledhës, I, II, III, IV, Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, vol. I, II, III, IV, Tiranë, 1961.
- L. DILO — Ligjëron F. Noli.
- M. LOGORECI — Histori, Histori e përgjithshme.
- M. SHEHU — Lufta, Lufta për çlirimin e Tiranës, Tiranë, 1959.
- MIGJENI — Vargjet, Vargjet e lirë, Tiranë, 1936.
- M. GURAKUQI — Gjeto, Gjeto Plaku, Tiranë, 1955.

- M. KALLAMATA — Netë, Netë gjahtarësh, Tiranë, 1959.  
M. KUTELI — Ago Jakupi, Tiranë, 1943.  
M. KUTELI — Netë, Netë shqiptare, Tiranë, 1944.  
\* \* — Në një cep të Ilirisë së poshtme, Nëndori, 6, 1965.  
\* \* — Kapllan Aga, Kapllan Aga i Shaban Shpatës.  
N. FRASHËRI — Bagëti, Bagëti e bujqësia, Bukuresht, 1886.  
\* \* — Dituritë. Bukuresht.  
\* \* — Lulet, Lulet e verësë, Tiranë, 1950.  
N. FRASHËRI — Histori. Histori e Skënderbeut, Tiranë, 1953.  
N. PRIFTI — Çezma, Çezma e floririt, Tiranë 1960.  
N. PRIFTI — Tregime, Tregime të fshatit, Tiranë, 1956.  
N. NIKAJ — Bërbuqja, Shkodër  
N. NIKAJ — Histori, Histori e Shqipërisë, Shkodër, 1917.  
N. JORGJAQI — Dashuria, Dashuria e Mimozës, Tiranë, 1960.  
N. MJEDA — Vjersha, Vjersha dhe poema, Tiranë, 1953.  
N. BULKA — Legjenda, Legjenda e një fisi, Tiranë 1966.  
\* \* — Skica.  
P. MARKO — Rrugë, Rrugë pa rrugë, Tiranë, 1964.  
PRRALLA — Prralla kombëtare, I, II.  
PROZA — Proza, I, II, III, IV, Instituti i Folklorit, Proza popullore.  
R. BRAHIMI — Katër, Katër vajza, Tiranë, 1962.  
R. NEPRAVISHTA — Fusha, Fusha po zgjohet, Tiranë, 1955.  
S. LUARASI — Fjala, Fjala shqipe, Tiranë, 1961.  
S. LUARASI — Shiler, Drama, përkth. shqip.  
S. ANDONI — Maleve, Maleve në Shpbebdren Tiranë, 1958.  
S. ÇOMORA — Nga fshati, Nga fshati i gruas, Tiranë, 1957.  
\* \* — Syleshi, Tiranë, 1958.  
S. SPASSE — Ata, Ata nuk ishin vetëm, Tiranë, 1952.  
\* \* — Buzë, Buzë liqenit, Tiranë 1965.  
S. GODO — Plaku, Plaku i Butkës, Tiranë.  
J. STALIN — Vepra II. përkth. shqip.  
Sh. MUSARAJ — Para, I, II, Para agimit, vol. I, II, Tiranë 1965.  
\* \* — Të shkuara, Të shkuara të paharruara, Tiranë, 1957.  
T. LAÇO — Rruga, Rruga e bardhë — Tiranë, 1967.  
TH. KACORI — Për mëmëdhenë, I, II.  
V. KOKONA — Me valët, I, II, Me valët e jetës, vol. I, II, Tiranë, 1961, 1965.  
V. VINÇANI — Të rinjtë, Tiranë, 1958.  
Z. SAKO — Ditë, Ditë të gëzuara, Tiranë.  
\* \* — Nga jeta, Nga jeta në luftë, Tiranë, 1948.  
\* \* — Bereqeti, Tiranë.  
XH. BILALI — Maska, Maska dhe fytyra, Tiranë 1960.

## Résumé

## L'ADVERBE EN ALBANAIS DE NOS JOURS

Le traitement des questions que soulève l'adverbe en albanais est du plus haut intérêt. Cela est fait en vue de faire avancer et approfondir de plus en plus les études sur cette catégorie. L'adverbe a fait l'objet d'études dans toute grammaire scolaire et extra-scolaire de l'albanais, et aussi dans quelque article particulier qui traite des origines et de la formation de ce mot invariable.

L'auteur a eu soin à examiner les questions résultant de l'étude de ce sujet, non point séparément, mais en visant aussi les catégories avec lesquelles l'adverbe a des affinités.

Dans un aperçu critique sur les traitements antérieurs des adverbes dans les grammaires, l'auteur a fait ressortir qu'y ont été abordées généralement les principales questions de l'adverbe (leur définition sémantique, leur classification et leur formation), quoique fort souvent cela n'ait été fait que superficiellement. Cela est pourtant parfaitement explicable, si l'on tient compte des buts et des visées de ces auteurs. Néanmoins, l'examen de ces problèmes sous un autre angle de vue et sur un plan plus vaste donne lieu à la nécessité d'une étude plus profonde et plus ample, de sorte qu'aussi les questions abordées trouvent une solution plus satisfaisante, et que les questions restées complètement en dehors de cet angle de vue deviennent l'objet d'un traitement circonstancié.

Dans le chapitre «Le classement des adverbes», l'auteur, tenant compte de l'aspect fonctionnel en même temps que de celui sémantique, divise les adverbes en deux groupes fondamentaux: 1. Adverbes qualitatifs, qui marquent une qualité de l'action ou bien le degré de son intensité; 2. Adverbes circonstantiels, qui indiquent les circonstances dans lesquelles a lieu l'action.

L'auteur distingue, à l'intérieur du groupe des adverbes qualitatifs, des: a) adverbes de manière et b) adverbes de quantité; et, à l'intérieur du groupe des adverbes circonstantiels: a) adverbes de lieu, b) adverbes de temps, c) adverbes de cause. L'auteur a fait ressortir, dans ce chapitre, aussi les distinctions de caractère sémantique et grammatical qu'on observe entre les deux grands groupes des adverbes.

Plus loin l'auteur s'est occupé de l'analyse sémantique des adverbes de manière, de quantité, de temps, de lieu et de cause, où il a distingué pour chacun des sousgroupes plusieurs acceptions fondamentales. Les groupes d'adverbes sont accompagnés, d'après le sens, d'observations sur l'usage à côté des mots qu'ils définissent. Ils définissent, d'ordinaire, les verbes, les adjectifs verbaux ainsi que les noms verbaux avec ou sans suffixes. Pour les adverbes de quantité, l'auteur a fait ressortir que leur usage à côté des adjectifs est en fonction des mots accessoires, comme une sorte de moyen grammatical à exprimer la catégorie grammaticale du degré tant des adjectifs que des adverbes. Le fait même que de tels adverbes n'associent pas les adjectifs et les adverbes qui n'ont pas la catégorie du degré, porte l'auteur à opiner qu'ils sont employés dans de tels cas uniquement comme un moyen grammatical à montrer que l'un ou l'autre des adjectifs, que l'un ou l'autre des adverbes a été usité à un de ces degrés.

Un chapitre à part réserve l'auteur aux degrés des adverbes, où il a fait ressortir leur affinité avec les adjectifs dans cette catégorie grammaticale, affinité qui rejoint parfois même les détails. L'auteur a fait ressortir que l'albanais, à différence de plusieurs autres langues, ne connaît que le mode analytique de la formation du degré tant pour les adverbes que pour les adjectifs.

Plus loin, l'auteur a fait noter que non tout adverbe pourrait être usité aux différents degrés. Sont usités au comparatif et au superlatif les adverbes qualitatifs qui se rapprochent comme le sens aux adjectifs. Mais, n'excluent point cette catégorie aussi quelques adverbes circonstantiels. On constate, actuellement, l'usage au comparatif et au superlatif, aussi de plusieurs formations du type préposition + nom (*me gëzim*), ce qui indique qu'ils se prennent de plus en plus une valeur adverbiale.

Quoique la modification structurelle des adverbes ne jouât point un rôle important dans leur usage à différents degrés, l'auteur, pour faciliter les choses, a divisé les adverbes usités aux degrés du comparatif, d'après leur construction. Sont

usités ainsi à différents degrés: 1. les adverbes qui coïncident avec certains adjectifs (abstraction faite de l'article) (*ashpër, bukur, ëmbël*); 2. les adverbes dérivant des participes des verbes (*dendur, hapur, shtruar*); 3. les adverbes formés à l'aide du suffixe *-(i)sht* (*fuqimisht, hollësisht, lirisht*); 4. la plupart des adverbes qui coïncident avec les adjectifs en *-shëm* (abstraction faite de l'article) (*mendueshëm, gëzueshëm, kuptueshëm*); 5. les adverbes qui à l'origine sont des ablatifs d'adjectifs neutres avec ou sans préposition (*së mbari, për së afërmi, së thelli*); 6. les adverbes de quantité (*shumë, pak, tepër, fort*); 7. les adverbes de lieu (*andëj, afër, djathtas*); 8. les locutions du type préposition + nom, usités souvent en fonction adverbiale, (*me gëzim, me vrap, me të butë*); 9. quelques adverbes de temps (*para, heret, vonë*).

Les moyens à former les degrés sont les mêmes que ceux des adjectifs: à cet effet servent les mots: *më, aq, kaq, shumë, fare, tepër, fort, mjaft*. Toute comme on répète l'adjectif, on répète aussi l'adverbe. Cette répétition a une valeur affective remarquable, qui manque au superlatif formé à l'aide de l'adverbe *shumë*. Les répétitions *butë-butë, lehtë-lehtë*, etc. sont difficilement égalisables avec les superlatifs formés à l'aide de *shumë, mjaft, tepër*. En albanais, pourtant, on a aussi les répétitions du type *dendur e më dendur, lart e më lart, mirë e më mirë*, qui indiquent une croissance progressive, par degrés, de la qualité d'une action ou d'une circonstance locative. Les répétitions de ce genre ne trouvent point leurs correspondants dans les adjectifs.

Un autre chapitre traite du passage des adverbes à d'autres parties du discours. Il y sont faits ressortir les rapports des adverbes avec les prépositions, les conjonctions et les particules. Le rapport sémantique et leur affinité, en tant que mots invariables, a entraîné souvent le passage des adverbes en prépositions, conjonctions et particules. Il va sans dire que le passage des adverbes à d'autres parties du discours est associé aussi à des modifications sémantiques, du fait qu'ils passent d'un mot dénominatif du discours à un terme de rapport.

L'auteur a fait ressortir, d'autre part, que l'adverbe sert également comme degré intermédiaire pour le passage des autres parties variables du discours en prépositions, d'après le schéma suivant: nom → adverbe → préposition. Il va sans dire qu'actuellement on peut avoir aussi des passages directs des noms en prépositions.

Un des principaux chapitres a été consacré par l'auteur à la formation des adverbes. Il y fait noter que les voies et les moyens de la formation des adverbes, au même titre que celles de toutes les autres parties du discours, ont été différentes. Au commencement de ce chapitre l'auteur s'est occupé des adverbes simples, en distinguant à cet égard: 1. les adverbes pronominaux qu'il a répartis d'après le sens et la fonction en a) adverbes pronominaux indicatifs, b) adverbes pronominaux interrogatifs, c) adverbes pronominaux quantitatifs. Ces adverbes ont été examinés également aussi comme structure; 2. les adverbes des différents cas des noms. L'auteur fait ressortir à ce sujet que les principaux cas qui ont servi de base pour l'adverbialisation des noms sont le nominatif, l'accusatif et l'ablatif. Plus productifs sont l'accusatif et l'ablatif. Les noms adverbialisés à partir de l'accusatif n'indiquent que des rapports de temps; les noms adverbialisés de l'ablatif indiquent la qualité de l'action verbale; 3. adverbes dérivant des adjectifs. L'auteur soutient l'opinion exprimée antérieurement que les adverbes du type *mirë, keq*, sont dérivés des adjectifs, et non point par voie contraire; 4. adverbes dérivés des verbes. Dans cet alinéa l'auteur a examiné les adverbes dérivés de participes des verbes: *hapur, shkoqur, shtruar*, ainsi que la forme impersonnelle négative du type *papritur, padashur*.

Une place importante a été consacrée aux adverbes dérivés et aux moyens de leur formation. L'auteur fait noter à cet effet que le type le plus répandu de

la formation des adverbes, est le type suffixal. Les suffixes adverbiaux les plus productifs de l'albanais sont *-(i)sh*, *-as/-azi*, et *-thi*. Ces suffixes ont formé un grand nombre d'adverbes, en s'unissant aux thèmes des parties les plus différentes du discours. L'auteur fait noter, également, que tandis que chez les adverbes qualitatifs la formation suffixale connaît une diffusion relativement vaste, elle n'est point caractéristique pour les adverbes circonstantiels. Ces derniers sont formés, entre autres, au moyen de l'adverbialisation des différentes formes des mots. D'autre part, l'auteur a souligné le fait que la préfixation n'est point le propre de l'adverbe.

Plus loin, l'auteur a examiné les adverbes agglutinés et composés ainsi que les locutions adverbiales. Après avoir examiné les différents cas de l'agglutination et de la composition, l'auteur aboutit à la conclusion que la composition n'est pas proprement caractéristique pour les adverbes.

Plus loin l'auteur s'occupe du traitement des locutions adverbiales formées par les noms, surtout à l'aide des répétitions de différents types. L'auteur y a traité non seulement le type structurel des répétitions, mais également la sémantique de ces répétitions.

En conclusion, l'auteur a fait ressortir que les adverbes sont une ample catégorie de mots qui sont enrichis et qui continuent à s'enrichir. Les voies à élargir cette catégorie sont différentes, et le processus de cet élargissement est un processus assez actif, même vivace.